

# **ASPEKTE TË VLERËSIMIT, PRIVATIZIMIT DHE MENAXHIMIT TË SHITJES SË PASURISË PUBLIKE NË SEKTORIN E HIDROKARBUREVE NË SHQIPËRI**

Petrit Perhati

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të programit të Doktoraturës, në Shkencat Ekonomike,  
Profili Menaxhim, për marrjen e gradës Shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor Prof. Dr. Magdalena Bregasi

Nr. i fjalëve 51,420

Tiranë, shtator 2017

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull: ASPEKTE TE VLERËSIMIT, PRIVATIZIMIT DHE MENAXHIMIT TË SHITJES SË PASURISË PUBLIKE NË SEKTORIN E HIDROKARBUREVE NË SHQIPËRI, është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Petrit Perhati

-----

Tiranë

shtator 2017

## ABSTRAKT

Në procesin e tranzicionit ekonomik shqiptar pas viteve 90-të, ndryshimi i menaxhimit të pasurisë publike nga dora shtetërore në duar private ka evidentuar rolin e një numri faktorësh si ai i vlerësimit të pasurisë publike dhe metodave të përdorura për këtë qëllim. Studimi im fokusohet në impaktin që ka privatizimi në performancën makroekonomike dhe marrëdhënien mes metodës së vlerësimit dhe faktorëve influencues në kontekstin e hidrokarbureve në Shqipëri. Sa i përket procesit të privatizimit në Shqipëri ai është realizuar nëpërmes dy metodave: a) përmes privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore, dhe b) përmes krijimit dhe zgjerimit të ndërmarrjeve të reja nga kapitali vendas dhe i huaj.

Hidrokarburet janë një nga burimet më të rëndësishme energjitike të tokës. Aktualisht janë burimi kryesor në bote i energjisë elektrike dhe ngrohjes. Sektori i hidrokarbureve në Shqipëri është një sektor me rëndësi strategjike në ekonominë e vendit, me një ndikim të konsiderueshem në performancën e treguesve makroekonomike si të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PPB), rritjes ekonomike, punësimit, investimeve etj. Nisur nga rëndësia shumë e madhe që ka në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare, studimi i menaxhimit të hidrokarbureve si një nga pasuritë më të mëdha të kombit dhe vënia e kësaj pasurie në shërbim të qytetarëve shqiptarë, merr një rëndësi të jashtëzakoshme. Prandaj vlerësimi dhe privatizimi i këtij sektori është një nga proceset më të mëdha të transformimit ekonomik të kohëve tona.

**Fjalët kyçe:** privatizim, menaxhim, pasuri publike, tranzicion, Shqipëri.

## **ABSTRACT**

*In the process of economic transition after the 90-Albanian to change the management of public property from state to private hands hand has identified the role of a number of factors such as the evaluation of public property and methods used for this purpose. My study focuses on the impact that privatization has on macroeconomic performance and relationship between the method of evaluation and influencing factors in the context of oil in Albania. While the privatization process in Albania is conducted through two methods: a) through the privatization of state enterprises, and b) through the creation and expansion of new enterprises from domestic and foreign capital. Hydrocarbons are one of the most important energy resources of the earth. Currently the world's main source of electricity and heat. The hydrocarbon sector in Albania is a strategically important sector in the economy of the country, with a considerable impact on the performance of macroeconomic indicators as gross domestic product (GDP) growth, employment, investment, etc. Given the very great importance of having sustainable development of the Albanian economy, the study of hydrocarbon management as one of the greatest assets of the nation and the imposition of that property in the service of Albanian citizens, it is important the essential. There for assessment and privatization of this sector is one of the major processes of economic transformation of our times.*

**Key word:** privatization, management, public property, transition, Albania.

## **FALENDERIME**

Është e kuptueshme që puna për disertacionin kërkon një angazhim dhe përkushtim shumë të madh duke të privuar nga shumë gjëra të tjera të bukura në jetë, por përkrahja pa rezerva, këshillat, vërejtjet, sugjerimet e të gjithë atyre që kisha afër ma bënë më të lehtë këtë sfidë, prandaj meritojnë një vend posaçëm për falenderim.

Do doja fillimisht me sinjeritetin më të madh të falenderoj udhëheqësen time Prof. Dr. Magdalena BREGASI e cila, qoftë në fazat e para të grumbullimit të literaturës, por edhe në aspektin shkencor shprehu gadishmërinë e saj maksimale që në çdo moment të më përgjigjet dhe këshillojë.

Familja ishte ajo e cila më qëndroi afër në çdo fazë të punës në disertacion, prandaj edhe meritojnë respekt dhe falenderim të veçantë për durimin dhe përkrahjen e vazhdueshme.

Respekt dhe falenderim padyshim me këtë rast meritojnë edhe kompanitë e sektorit të hidrokarbureve që nuk hezituan të më ofrojnë ndihmesën e tyre në grumbullimin e të dhënave, duke u bërë me këtë rast pjesë shumë e rëndësishme e këtij disertacioni.

Mbi të gjitha falenderoj Zotin që më dha shëndet si dhe më mundësoi të arrij deri aty ku disa vite më parë i kisha vënë kusht vetes.

***Petrit Perhati***

---

*Tiranë, 2017*

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

|                                                 |              |
|-------------------------------------------------|--------------|
| <b>DEKLARATA E AUTORËSISË .....</b>             | <b>II</b>    |
| <b>ABSTRAKT.....</b>                            | <b>III</b>   |
| Fjalët kyçe .....                               | III          |
| ABSTRACT .....                                  | IV           |
| Key word .....                                  | IV           |
| <b>FALENDERIME.....</b>                         | <b>V</b>     |
| <b>LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT .....</b> | <b>X</b>     |
| <b>LISTA E TABELAVE .....</b>                   | <b>XI-XV</b> |
| <b>LISTA E GRAFIQEVE.....</b>                   | <b>XV</b>    |
| <b>LISTA E FIGURAVE.....</b>                    | <b>XVI</b>   |
| <b>KAPITULLI I: .....</b>                       | <b>1</b>     |
| <b>HYRJE .....</b>                              | <b>1</b>     |
| Shtrimi i problemit .....                       | 3            |
| Qëllimi i studimit .....                        | 6            |
| Hipoteza / hipotezat e punimit .....            | 6            |
| Pyetjet kërkimore të punimit .....              | 12           |
| Metodat dhe metodologjia e kërkimit .....       | 12           |
| Mundësitë dhe kufizimet.....                    | 13           |
| Rëndësia e studimit .....                       | 14           |
| Rezultatet e pritshme .....                     | 15           |

|                                                                                                                       |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>KAPITULLI II:</b>                                                                                                  | <b>16</b> |
| <b>VËSHTRIM MBI LITERATURËN</b>                                                                                       | <b>16</b> |
| 2.1. Konsiderata teorike mbi tranzicionin                                                                             | 17        |
| 2.1.1. Aktet Ligjore dhe nënligjore të Sektorit të Privatizimit të Aseteve                                            | 34        |
| 2.1.2. Privatizimi në Sektorin Strategjik. Strategjia e privatizimit dhe implikimet e saj                             | 39        |
| 2.1.3. Pjesëmarrja e punëtoreve në vendimmarrje përkitazi mbi procesin e privatizimit                                 | 43        |
| 2.1.4. Proceset e koncentrimit centralizimit dhe internacionalizimit të kapitalit si metodë e ndërmjetme privatizimi. | 55        |
| 2.2. Ideologjia e privatizimit në Evropën Qendrore ( <i>që nga vitit 1989</i> )                                       | 64        |
| 2.3. Alternativat e politikës për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit të ndërmarrjeve publike                    | 69        |
| A) Përcaktimi i objektivave të qarta për NP-të                                                                        | 70        |
| B) Reduktimi i ndërhyrjes politike                                                                                    | 71        |
| C) Më shumë transparencë mbi performancën e NP-ve                                                                     | 77        |
| 2.4. Tranzicioni ekonomik ne rajon                                                                                    | 79        |
| 2.4.1. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Kroaci                                    | 79        |
| 2.4.2. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Malin e Zi                                | 80        |
| 2.4.3. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Slloveni                                  | 82        |

|                                                                                                                               |            |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| 2.4.4. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Maqedoni .....                                    | 82         |
| 2.4.5. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Republikën Çeke.....                              | 83         |
| 2.4.6. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Kosovë .....                                      | 84         |
| 2.5. Vlerësimi i Pasurive Publike: Çfarë e bën të rëndësishëm këtë fenomen? .....                                             | 87         |
| 2.5.1. Metodatat e vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe vlerësimi i pronave në procesin e privatizimit në Shqipëri. .... | 89         |
| 2.5.2. Mjedisi i jashtëm dhe implikimet në procesin e vlerësimit për privatizim....                                           | 91         |
| 2.5.3. Shkollat & Teoritë e Metodës së Vlerësimit: Çfarë i dallon nga njëra-tjetra? .....                                     | 104        |
| <b>KAPITULLI III: .....</b>                                                                                                   | <b>108</b> |
| <b>SEKTORI I HIDROKARBUREVE DHE NDIKIMI I PRIVATIZIMIT NË</b>                                                                 |            |
| <b>PERFORMANCËN MAKROEKONOMIKE .....</b>                                                                                      | <b>108</b> |
| 3.1. Globalizimi si koncept dhe si realitet i pashmangshëm në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare.....                          | 108        |
| 3.1.1. Relacioni në mes IJD-së dhe privatizimit në aspektin global.....                                                       | 114        |
| 3.2. Ndikimi i privatizimit në performancën makroekonomike të Shqipërisë .....                                                | 115        |
| 3.3. Historiku i privatizimit të shoqërisë ARMO sha.....                                                                      | 123        |
| 3.4. Organizimi i Sektorit të Naftës dhe Gazit në Shqipëri.....                                                               | 126        |
| 3.4.1. Sektori Hidrokarbur, nafta e gazi natyror .....                                                                        | 130        |
| 3.4.2. Shoqëria e naftës e zotëruar nga shteti – Albpetrol Sh.A.....                                                          | 139        |



|                                                                                                               |            |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| 3.4.3. Rezervat e naftës dhe gazit natyror.....                                                               | 142        |
| 3.4.4. Parashikimi i nevojave për hidrokarbure dhe produkteve të tyre sipas skenarit pasiv.....               | 148        |
| 3.4.5. Parashikimi i prodhimit të naftës deri në vitin 2020 .....                                             | 151        |
| <b>KAPITULLI IV: .....</b>                                                                                    | <b>154</b> |
| <b>METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....</b>                                                                         | <b>154</b> |
| 4.1. Metodologjia e hulumtimit.....                                                                           | 154        |
| <b>KAPITULLI V .....</b>                                                                                      | <b>158</b> |
| <b>REZULTATE DHE DISKUTIME .....</b>                                                                          | <b>158</b> |
| 5.1. Pjesa e përgjithshme.....                                                                                | 158        |
| 5.2. Pyetësorë për drejtuesit e ndërmarrjeve nga sektori i hidrokarbureve dhe punonjësit në këtë sektor ..... | 167        |
| 5.3. Analizime .....                                                                                          | 172        |
| <b>KAPITULLI VI.....</b>                                                                                      | <b>197</b> |
| <b>PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....</b>                                                                        | <b>197</b> |
| Përfundime.....                                                                                               | 199        |
| Rekomandime.....                                                                                              | 203        |
| <b>LITERATURA.....</b>                                                                                        | <b>204</b> |
| Literatura bazë.....                                                                                          | 204        |
| Literatura dytësore.....                                                                                      | 210        |
| Literatura ndihmëse.....                                                                                      | 214        |

## **LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT**

|        |                                                |
|--------|------------------------------------------------|
| NVM –  | Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme               |
| FMN –  | Fondi Monetar Ndërkombëtar                     |
| BQSh – | Banka Qendrore e Shqipërisë                    |
| EBRD - | Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim       |
| IJD -  | Investimet e Jashtme Direkte                   |
| IHD –  | Investimet e huaja direkte                     |
| TIMS - | Trade Information Management System            |
| DTI-   | Direct Trade Input                             |
| MVFJ - | Matrica e Vlerësimit të Faktorëve të Jashtëm   |
| MVFB - | Matrica e Vlerësimit të Faktorëve të Brendshëm |
| TIK -  | Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit    |
| SS -   | Sektorët Strategjikë                           |
| NS -   | Ndërmarrjet Strategjike                        |
| BP -   | Bono Privatizimi                               |
| AKBN - | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore         |
| SKE -  | Strategjia Kombëtare e Energjisë               |
| MH -   | Marrëveshje Hidrokarbure                       |
| PPM -  | Programi i Privatizimit Masiv                  |
| PPB -  | Prodhimit të Përgjithshëm Bruto                |

## LISTA E TABELAVE

|                                                                                                                                                                                                              |     |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Tabela 1. Situata për bonot e privatizimit të emetuara është: .....                                                                                                                                          | 41  |
| Tabela 2. Datat e shkëputjes nga sistemi post-komunist .....                                                                                                                                                 | 65  |
| Tabela 3. Të dhëna mbi rëndësinë e Np-ve në ekonominë kombëtare .....                                                                                                                                        | 67  |
| Tabela 4. Struktura fillestare e pronës në korporatë .....                                                                                                                                                   | 81  |
| Tabela 5. Ndikimi i krizës globale në disa nga vendet e Evropës Jug-lindore .....                                                                                                                            | 109 |
| Tabela 6. Disa nga treguesit kryesorë makroekonomik të gjendjes së tanishme pas dhe gjatë fazës së tranzicionit ekonomik në Shqipëri.....                                                                    | 110 |
| Tabela 7. Ndikimi i privatizimit në rritjen e investimeve të jashtme direkte në disa nga vendet të Evropës qendrore, lindore dhe Jug-lindore (vlerat janë të shprehura në milionë dollarë amerikanë \$)..... | 114 |
| Tabela 8. Treguesit kryesorë financiarë në milion lekë .....                                                                                                                                                 | 125 |
| Tabela 9. Fushat e naftës dhe gazit në Shqipëri.....                                                                                                                                                         | 134 |
| Tabela 10. Marrëveshjet e hidrokarbureve, si më poshtë, ishin në fazën e prodhimit gjatë vitit 2012: .....                                                                                                   | 135 |
| Tabela 11. Prodhimi i naftës nga Albpetrol dhe sektori privat në vitet 1992-2013 Në mijë tonë.....                                                                                                           | 137 |
| Tabela 12. Nafta e prodhuar në vitin 2012 nga të licencuarit.....                                                                                                                                            | 137 |
| Tabela 13. Lista e blloqeve të kërkimit.....                                                                                                                                                                 | 138 |
| Tabela 14. Parashikimi i prodhimit të naftës nga shoqëria ALBPETROL dhe MH.....                                                                                                                              | 152 |
| Tabela 15. Privatizimi përmes shitjes direkte si dhe ankande /tendera e shprehur në milion lekë .....                                                                                                        | 158 |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Tabela 16. Rezultatet e arritura përmes: Programi i Privatizimit Masiv i shprehur në milion lekë .....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 159 |
| Tabela 17. Rritja e GDP sipas viteve .....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 159 |
| Tabela 18. Përmbledhje Për Pesë Paketat .....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 159 |
| Tabela 19. Rritja e GDP .....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 160 |
| Tabela 20. Numri i aseteve apo objekteve sipas formave të shitjes.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 160 |
| Tabela 21. Ju si qytetar, a jeni të kënaqur me institucionet e privatizimin/ vlerësimit të ndërmarrjeve publike?.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 161 |
| Tabela 22. Tests of Betwen-Subjects Effects Dependent Variable: Sa rëndësi ka për ju si qytetar promovimi i aktiviteteve në privatizimin/ vlerësimit të ndërmarrjeve publike në luftimin e informalitetit dhe zhvillimin ekonomik të vendit? .....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | 161 |
| Tabela 23. Normal P-P Plot e Nga sasia e përgjithshme të akitiviteteve privatizuese, ç’përqindje zë grupi i aktiviteteve me nevojë bashkëpunimin ndërkombëtar në funksion të zhvillimit ekonomik? .....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 162 |
| Tabela 24. Crosstabulation i kërkesave na jep shumë të qartë ndërlidhjen ndërmjet këtyre kërkesave: Privatizimi / vlerësimi i ndërmarrjeve publike që ti i shikon si aktivitete a kanë ndonjë ndërlidhje me aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar? * Sa rëndësi ka për ty si qytetar promovimi i aktiviteteve të Privatizimi / vlerësimi i ndërmarrjeve publike në zhvillimin ekonomik të vendit? * Në sasinë e përgjithshme të aktiviteteve privatizuese ç’përqindje zë grupi i aktiviteteve me nevojë bashkëpunimin ndërkombëtar në funksion të zhvillimit ekonomik? ..... | 163 |
| Tabela 25. Cross tabel e Nëse zhvillohen aktivitete në privatizimin e ndërmarrjeve nga sektori i hidrokarbureve si mendoni sipas njohurisë suaj, ç’peshë zë në aktivitete e                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |     |

|                                                                                                                                                                                                                        |     |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| përgjithshme keqmenaxhimi i këtij procesi?* Nëse zhvillohen aktivitetet e privatizimit si duhet bërë ky proces që të jetë sa më rezultativ? .....                                                                      | 165 |
| Tabela 26. Vini “notën” e vlerësimit për faktorët që ndikojnë në përhapjen e keqpërdorimeve me procesin e privatizimit/ vlerësimit të pronës publike. ....                                                             | 166 |
| Tabela 27. Ç’farë niveli-pozite përfaqësoni në sektorin/ departamentin tuaj? .....                                                                                                                                     | 167 |
| Tabela 28. A flisni ndonjë gjuhë të huaj dhe a zhvilloni komunikim profesional ndërkombëtar?.....                                                                                                                      | 167 |
| Tabela 29. Përvoja juaj e punës në sektorin e hidrokarbureve?.....                                                                                                                                                     | 167 |
| Tabela 30. Në cilën periudhë kohore punoni (keni punuar) në këtë sektor (ju lutemi shënoni vitin prej kur keni filluar) .....                                                                                          | 168 |
| Tabela 31. A keni vijuar ndonjë trajnim jashtë vendit përkitazi me zhvillimin e aftësive punuese/menaxhuese në sektorin e hidrokarbureve? .....                                                                        | 168 |
| Tabela 32. A keni marrë pjesë në vlerësimit e përgjithshme të pronës në ndërmarrjen tuaj, dhe si ka qenë ndikimi juaj?.....                                                                                            | 168 |
| Tabela 33. Cili është niveli i komunikimit në mes të zyrtarëve vendas brenda ndërmarrjes me të tjerët që janë pjesë e institucioneve që merren me privatizimin e ndërmarrjeve publike në Republikën e Shqipërisë?..... | 169 |
| Tabela 34. Sa ju ka ndihmuar procesi i privatizimit në sektorin e hidrokarbureve në punën tuaj? .....                                                                                                                  | 169 |
| Tabela 35. Cili është roli i drejtuesve të ndërmarrjeve publike nga sektori i hidrokarbureve në procesin e privatizimit dhe vlerësimit të pronës publike? .....                                                        | 169 |
| Tabela 36. A keni pasur shkëmbim të informatave dhe zyrtarëve me agjencitë shtetërore në privatizim?.....                                                                                                              | 170 |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Tabela 37. A është vërejtur trend i zvogëlimit të keq menaxhimit me pasurinë publike si rezultat i privatizimit? .....                                                                                                                                                                                          | 170 |
| Tabela 38. Me kalimin e kohës a ka shënuar ngritje besimi në performacën e ndërmarrjeve publike në sektorin e hidrokarbureve?.....                                                                                                                                                                              | 170 |
| Tabela 39. Clusteri në lidhje me pyetjen: Në volumin e përgjithshëm të aktiviteteve të aspekteve të vlerësimit, privatizimit së pasurisë publike, ç’përqindje zënë aktivitetet menaxhimit të shitjes së pronës publike dhe në ndërmarrjet e privatizuara a ka pasur tejkalime të investimeve të parapara? ..... | 172 |
| Tabela 40. Buxheti i ndarë për/ nga privatizimi.....                                                                                                                                                                                                                                                            | 175 |
| Tabela 41. Format e aplikimit të vlerësimit, privatizimit dhe menaxhimit të shitjes së pasurisë publike në sektorin e hidrokarbureve në Shqipëri. ....                                                                                                                                                          | 177 |
| Tabela 42. Punësimi përballë privatizimit. ....                                                                                                                                                                                                                                                                 | 183 |
| Tabela 43. Normalja determinuese P-P Plot, Sa rëndësi i duhet kushtuar punësimit afat mesëm gjatë projektit të privatizimit?.....                                                                                                                                                                               | 184 |
| Tabela 44. Rëndësia që i jepet promovimit të lëngjeve dhe Aplikimi i Promocionit Miks në aspektin e rritjes së shitjeve të lëngjeve. ....                                                                                                                                                                       | 184 |
| Tabela 45. T-Testi / Paired Samples Test. ....                                                                                                                                                                                                                                                                  | 186 |
| Tabela 46. Analiza e regresionit të shumfishtë në matjen e përgjithshme të përfitimeve nga privatizimi, si dhe parashikimet e ndërlidhura me rritjen e GDP. ....                                                                                                                                                | 187 |
| Tabela 47. Koeficientët .....                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 188 |
| Tabela 48. Independent sample T- Test i elementeve të promovimit / variablave varura dhe rëndësisë së tyre tek konsumatorët.....                                                                                                                                                                                | 189 |
| Tabela 49. Promovimi i hidrokarbureve në kombinim nga dy elemente të promocionit miks.....                                                                                                                                                                                                                      | 192 |

|                                                                                              |     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Tabela 50. Testi Fisher sipas renditjes në kombinim nga dy elemente të promocionit miks..... | 193 |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----|

## LISTA E GRAFIQEVE

|                                                                                                                |     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Grafiku 1. Prodhimi i naftës bruto në Shqipëri v.1990-2013 (ton ) :.....                                       | 117 |
| Grafiku 2. Prodhimi i naftës sipas kompanive v.2013 (ton) : .....                                              | 118 |
| Grafiku 3. Qarkullimi vjetor i Bankers Petroleum (miliard lekë) : .....                                        | 120 |
| Grafiku 4. Qarkullimi vjetor i STREAM OIL & GAS LTD ( miliard lekë) : .....                                    | 122 |
| Grafiku 5: Të ardhurat, shpenzimet dhe rezultati v.2000-2006 (milion lekë.....                                 | 125 |
| Grafiku 6: Prodhimi i naftës bruto ne v. 2011. ....                                                            | 133 |
| Grafiku 7. Tendenca në vite e ndërmarrjeve për gamën e shitjeve.....                                           | 174 |
| Grafiku 8. Tendenca e tregut në përqindje të zotëruara nga ndërmarrjet prodhuese në Shqipëri 2003-2013.....    | 174 |
| Grafiku 9: Pasqyra mbi rritjen e të hyrave publike si rezultat i privatizimeve.....                            | 185 |
| Grafiku 10. Grafiku i homoskedacitetit mbi metodat dhe modelet e privatizimit dhe rëndësia e privatizimit..... | 191 |

## LISTA E FIGURAVE

|                                                                                |     |
|--------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Figura 1. Fushat e gazit dhe naftës në Shqipëri.....                           | 136 |
| Figura 2. Prodhimi i naftës në Shqipëri.....                                   | 139 |
| Figura 3. Humbjet fizike naftë ALBPETROL sha.....                              | 141 |
| Figura 4. Faturimet e 9-mujorit 2014 ALBAPETROL sha.....                       | 142 |
| Figura 5. Ecuria e kërkesës për produktet hidrokarbure.....                    | 149 |
| Figura 6. Raporti i hidrokarbureve me lëndët e tjera energjitike (në %).....   | 149 |
| Figura 7. Parashikimi i kërkesës për n/produkte të naftës sipas sektorëve..... | 151 |
| Figura 8. Ecuria e raporteve sipas sektorëve.....                              | 151 |



## KAPITULLI I:

### HYRJE

Që në fillim të nisjes së këtij punimi kam patur bindjen se përpjekjet e mia për të hulumtuar në fushën e menaxhimit të pronës publike në Shqipëri, falë përvojës shumëvjeçare si dhe njohurive që kam fituar do të shënonin një kontribut jo të vogël me së paku në fushën e nxitjes së debatit profesional, shkencor dhe akademik se çfarë është bërë mirë, çfarë është bërë keq dhe se çfarë duhet të bëjmë më mirë në të ardhmen.

Po pse jam fokusuar në sektorin hidrokarbur? Sepse hidrokarburet janë një nga burimet më të rëndësishme energjitike të tokës. Aktualisht janë burimi kryesor në botë i energjisë elektrike dhe ngrohjes. Shqipëria ka vendburime natyrore me potenciale zhvillimi të mëdha dhe me një rëndësi jetike për të ardhmen e ekonomisë dhe mirëqënies sonë.

Spektori i hidrokarbureve në Shqipëri është një sektor me rëndësi strategjike në ekonominë e vendit, me një ndikim të konsiderueshëm në performancën e treguesve makroekonomikë si të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PPB), rritjes ekonomike, punësimit, investimeve etj.

Nisur nga rëndësia shumë e madhe që ka në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare, studimi i menaxhimit të hidrokarbureve si një nga pasuritë më të mëdha të kombit dhe vënia e kësaj pasurie në shërbim të qytetarëve shqiptarë, merr një rëndësi të jashtëzakonshme. Prandaj vlerësimi dhe privatizimi i këtij sektori është një nga sfidat dhe proceset më të mëdha të transformimit ekonomik të kohëve tona.

Kemi të bëjmë me një proces i cili jep mundësi që potencialet e hidrokarbureve të shndërrohen në vlera për xhepat e qytetarëve, në vlera për projektet e mëdha infrastrukturore, në potenciale energjie me qëllimin që të maksimizojë vlerën e tyre në

dobi të përmirësimit të jetesës së qytetarëve shqiptarë.

Privatizim do të thotë më shumë se shitje e ndërmarrjeve joeficiente. “Privatizimi, në një kuptim më të gjerë mund të përcaktohet si një transferim apo shitje ndërmarrjeje, apo aktiviteti nga sektori publik tek sektori privat.

Privatizimi është më tepër se një ngjarje, privatizimi është një proces nëpërmjet të cilit bëhet i mundur transferimi i pasurive publike në private. Procesi i privatizimit kalon në 3 faza: përgatitja për privatizim, privatizimi si dhe postprivatizimi.

Në fazën e parë bëhet e mundur selektimi i ndërmarrjeve apo aktiveve shtetërore të cilat plotësojnë kushtet për t’u privatizuar.

Në fazën e dytë, qeveria ndërmerr studime të nevojshme për të vlerësuar mundësitë e privatizimit të ndërmarrjeve dhe aktiviteteve që parashikohen për t’u privatizuar si dhe përcaktimin e mekanizmave të nevojshme për arritjen e këtij objekti. Kjo fazë është e rëndësishme pasi në varësi të rezultateve të dalta nga studimet e bëra mund të gjykohej nëse është e domosdoshme që kjo ndërmarrje të ristrukturohet para se të privatizohet në mënyrë që t’i rritet vlera e saj, apo të kalojë direkt në procesin e privatizimit.

Faza e tretë. Postprivatizimi, ka të bëjë me dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të pasurisë publike dhe në vijim të strategjisë së tij të biznesit, subjekti marrës, ndërton apori konstrukton pasurinë e privatizuar. Në këtë proces roli i shtetit konsiston në zbatimin e marrëveshjes së privatizimit, e cila varet nga forma e privatizimit të kryer.

Askush nga aktorët që marrin pjesë në procesin e privatizimit të pronës publike nuk mund "të kalibrojnë" paraprakisht me ligj ose me rregulla të tjera se si mund të shpërndahet pasuria publike.

**Qëllimi i këtij studimi** është shqyrtimi në mënyrë empirike i ndikimit të

privatizimit (në aspektin e të ardhurave), në variablat makroekonomike dhe ata fiskale si dhe njohja dhe studimi i metodave të vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe të vlerësimit të pronave publike për efekt privatizimi. Për saktësim, nisur edhe nga tema e përcaktuar me sipër, në trajtimin dhe zhvillimin e çështjeve në këtë studim, përdorimi i termit “privatizim” ose “të ardhura e privatizimit” do të nënkuptojë respektivisht “privatizimin nga sektori hidrokarbureve” ose “të ardhurat përmes privatizimit të sektorit të hidrokarbureve”

### **Shtrimi i problemit**

Nisur nga se njëri prej qëllimeve të këtij punimi, është shqyrtimi i ndikimit të privatizimit të sektorit hidrokarbur, në variablat makroekonomike dhe fiskale si dhe ndikimet buxhetore të të ardhurave të privatizimit të këtij sektori, del se ka dy çështje kryesore për tu studiuar:

1. Cili është ndikimi i njëkohshëm i privatizimit në buxhet? Me fjalë të tjera, të ardhurat që janë transferuar nga shitja e titujve qeveritare në buxhet, janë kursyer apo janë shpenzuar?

2. Cila është dinamika ose ndikimi i ndryshimit të strukturës së ekonomisë në performancën (ecurinë) makroekonomike dhe fiskale? Matja e ndryshimit strukturor të privatizimit do të bëhet me anë të ndërtimit të regresionit për të kontrolluar natyrën me strukturore të marrëdhënieve ndërmjet privatizimit dhe variablave fiskale dhe makroekonomike në përgjithësi.

Këto janë 2 pyetje të ndryshme, për të cilat duhet përdorur një përkufizim i ndryshëm i privatizimit për t’ju adresuar secilës prej tyre.

**E para** përdor të ardhurat e privatizimit aktualisht të transferuara në buxhet si përkufizim i privatizimit meqënëse çështja është se si buxheti i përdor të ardhurat, ku

**variabli i parë është:** të ardhurat e privatizimit aktualisht të transferuara në buxhet, ndërsa **variabli i dytë është** “shuma totale të ardhurave përmes procesit të privatizimit të paguara nga blerësi”.

**Së dyti** përdoret një përkufizim i jashtëm për privatizimin që i korrespondon shumës totale të të ardhurave nga privatizimi të paguara nga blerësit, **qëllimi përsëri është:** të studiojë se si ndryshimi në strukturën e ekonomisë prek performancën makroekonomike dhe fiskale duke qenë se tendenca e këtij ndryshimi strukturor është drejt pronësisë private dhe me larg pronësisë publike.

Gjithashtu ndër objektivat kryesore të këtij studimi do të veçonim:

**Zgjidhjen e problemeve të kontabilizimit dhe të vlerësimit,** nëpërmjet një analize të metodave të vlerësimit, e cila është një domosdoshmëri për një program të suksesshëm privatizimi. Është fakt që progresi në privatizim është ngadalësuar nga niveli i ulët i informacionit financiar, mungesa e krahasueshmërisë së vlerës reale në treg, etj të cilat kanë penguar si nëpunësit e administratës publike, ashtu edhe investitorët për të vlerësuar ndërmarrjet e caktuara për privatizim.

Përcaktimi i vlerës të aktiveve dhe i perspektivave të biznesit në të ardhmen edhe në një ekonomi të zhvilluar tregu është larg të qenurit një procedurë rutinë, por sigurisht që është shumë e vështirë të përpiqesh ta bësh këtë në një mjedis ku të dhënat historike hyrëse dhe dalëse reflektojnë më shumë vendimet e planifikuesve, sesa burimeve relative dhe ku natyra tranzitore e ekonomisë i bën parashikimet e zhvillimeve në të ardhmen thuajse të pamundur, duke parashtruar nevojën e aplikimit të teknikave dhe metodave të një rendi tjetër. Në vazhdim të këtij punimi do merren parasysh për analizë teknikat dhe metodat e përdorura për vlerësimin e aktiveve publike për efekt privatizimi me përmirësimet legjislative që janë bërë në këtë drejtim. Në vazhdim të kësaj

gjithashtu do të shqyrtohet teknika e vlerësimit të kompanisë ALPETROL sha, e cila është në proces vlerësimi dhe privatizimi.

**Përgjatë këtij synimi,** përveç kuptimit dhe përshtatjes së praktikave të ndryshme në fushën e administrimit, vlerësimit dhe shitjes (privatizimit) të pronës publike, do të përdoren edhe forma të ndryshme ndërveprimi dhe mënyra zgjidhjeje që zbatojnë këto institucione publike, në kuadër të realizimit të strategjisë së privatizimit të shoqërive publike në tërësi dhe atyre që veprojnë në fushën e hidrokarbureve në veçanti.

**Përveç kësaj** do të reflektohen qëndrimet tona ndaj këtyre formave të zbatuara dhe të ndikimeve dhe rezultateve që ato kanë patur në procesin e vlerësimit dhe privatizimit të pasurisë publike në vendin tonë.

Në zhvillimin e këtij kërkimi doktoral ndihmë e çmuar ishte edhe përvoja ime e gjatë mëse 10-vjeçare në fushën e administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik dhe pozicioni aktual si drejtues i Departamentit Ekonomik në një nga shoqëritë publike (PETROL ALBA sha), shoqëri anonime me kapital 100 % shtetëror, që aktualisht është në proces shitje (privatizimi). Shoqëria “PETROLALBA” sh.a, Tiranë, është krijuar me urdhërin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr.296, datë 29.04.2008 “Për krijimin e shoqërisë “PETROL ALBA” sh.a, Tiranë, me kapital të nënshkruar 1.166.768.000 lekë, aksione me vlerë nominale 1.000 lekë, e cila krijohet me transferim kontributi nga aktivi nëpërmjet zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë “ARMO” sh.a, Tiranë. Me Ekstratin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, datë 03.06.2008, është regjistruar shoqëria “PETROL ALBA” sh.a, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (data e regjistrimit 06.05.2008), me kapital themeltar 1.166.768.000 lekë, me objekt veprimtarie: “Magazinimi, tregtia me shumicë e pakicë e karburanteve dhe nënprodukteve të tjera të tyre, ”.

## **Qëllimi i studimit**

Në një këndvështrim nga pikëpamja kërkimore, një nga sfidat e mëdha menaxheriale dhe qëllimet e politikave strategjike publike është programimi dhe zbatimi i një politike ekonomike strategjike sa më efikase, për të sjellë zhvillim dhe rritje të aseteve të dobishme, maksimizim të potencialeve në dobi të popullatës dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare. Vështirësia që karakterizon këtë çështje qëndron në kompleksitetin që paraqet ajo, në aspekt të ndërmarrjeve, apo veprimeve të ndryshme menaxheriale që duhet të kryhen për arritjen e efektivitetit të menaxherëve publike dhe aftësive të tyre, të traditave kulturore dhe veçantive të mjedisit shqiptar etj. Përmirësimi i procesit të planifikimit, programimit, monitorimit, vlerësimit dhe privatizimit të aktiveve publike në përgjithësi dhe të sektorit të hidrokarbureve në veçanti, si një ndër sektorët më strategjike të ekonomisë shqiptare është një sfidë shumë e madhe aktualisht edhe në të ardhmen. Gjithashtu, të rëndësishme janë dhe trajtimet që do t'i bëhen në punim procesit të vlerësimit, privatizimit dhe shitjes së aktiveve publike të cilat janë të ndërruar nga njëri-tjetri.

## **Hipoteza / hipotezat e punimit**

**Lidhur me impaktin e njëkohshëm të të ardhurave nga privatizimi të transferuara në buxhet**, ka argumenta të besueshëm ekonomiko-politik që mbështesin hipotezat e shpenzimeve dhe të kursimeve. Duke parë privatizimin si një vendim portofoli sugjerohet që nuk është e preferueshme të kesh një impakt direkt në deficit ose në variablat e tjerë fiskale. Të ardhurat nga privatizimi të transferuara në buxhet thjesht mund të konvertohen në një vlerë tjetër financiare dhe të sigurojnë që vlera neto e

qeverisë është e pandryshueshme, si rrjedhin nuk do të ketë asnjë ndryshim në bilancin e përgjithshëm. Elementet pragmatike sugjerojnë gjithashtu që të ardhurat mund të kursehen, p.sh, nëse koha ose madhësia është e parëndësishme ose e panjohur, të ardhurat mund të kursehen derisa buxheti në vazhdim mund t'i alokojë ato.

**Lidhur me hipotezat e shpenzimeve**, një qeveri me likuiditete të sforcuara mund të gjejë si një mundësi optimale përdorimin e privatizimit si një mundësi për të financuar një deficit shumë të madh. Megjithatë, konsideratat ekonomike-politike sugjerojnë që një qeveri mund të jetë e gatshme të shpenzojë të ardhurat, para së gjithash duke parë privatizimin siç mund të jetë çdo burim tjetër të ardhurash.

Duke ju kthyer pyetjeve më të strukturuar, të ardhurat e privatizimit mund të kenë një impakt direkt në strukturat e financimeve qeveritare. Shpenzimet totale dhe huaja neto mund të ndryshojë për arsye të ndryshme, duke përfshirë ulje në transferta dhe zëvendësime të ndërmarrjeve që janë privatizuar (megjithëse këto para mund të shpenzohen kudo); një ndryshim në pagesat e interesave duke u ndjekur gjithashtu nga ulja ose rritja e borxhit; marrja pothuajse e çdo aktiviteti fiskal më parë të kryer nga ndërmarrjet e privatizuara; ose marrëveshjet institucionale që përcaktojnë termat për të shpenzuar të ardhurat (megjithëse shpenzime të tilla nuk mund të terhiqen për llogari të buxhetit). Për sa i përket të ardhurave, firmat që janë privatizuar mund të jenë subjekt i një politike takse të ndryshme dhe potencialisht i një niveli të ndryshëm shqyrtimi administrativ, që për më tepër mund të prodhojë një ndryshim të përkohshëm në të ardhurat prej taksave. Meqenëse të ardhurat prej taksave maten si një pjesë e GDP-së në ushtrimet empirike, mund të jetë më i vështirë për tu zbuluar fitim më i madh nga prona private meqenëse si të ardhurat nga taksat (hyrjet fiskale) ashtu dhe GDP-ja mund të rriten. Të ardhurat nga taksat mund të rriten gjithashtu përkohësisht nëse privatizimi

përfshin shlyerjen e taksave të detyrimeve të papaguara. Së fundi, të ardhurat që nuk vijnë nga taksat mund të bien nëse firma e privatizuar ka transferuar me parë fitimet në buxhet. Bilanci i përgjithshëm mund të lëvizë përkohësisht ose për një kohë të gjatë për shkak të ndryshimeve shoqëruese në anën e të ardhurave ose të shpenzimeve të buxhetit. Gjithashtu ai mund të ndryshojë nëse procesi i privatizimit udhëhiqet më tepër nga rritja ose ulja e pasurisë së qeverisë. p.sh një privatizim që drejtohet drejt rritjes së pasurisë së qeverisë mund t'i lejojë qeverisë që të rrisë përkohësisht deficitin.( **Barnett S. 2000**).IMF Working Paper: July 2000 “Evidence on the Fiscal and Macroeconomic Impact of Privatization”

Është studiuar (investiguar) nga (Barnett S. 2000), efekti real i privatizimit si një proces ekonomik në rritjen e GDP-se, zbutjen e papunesisë dhe rritjen e investimeve. Arsyet përse duhet të presësh ndryshim në këto variabla janë të dukshme, gjithashtu me interes është natyra dinamike e impaktit. Megjithatë është e nevojshme të dallojmë efektet ndërmjet të përkohshmes (një periudhe) dhe të qëndrueshmes (disa periudha). Megjithatë ky efekt mund të llogaritet eficient në kohë dhe me fitim me të lartë për ndërmarrjet e privatizuara të cilat sapo kanë filluar të gjenerojnë pune. Veç kësaj, ndryshimet e jashtme strukturore në ekonomi të detyruara nga privatizimi mund që të hapin vende pune menjëherë ose pas periudhës afat mesme (**Kikeri 1998**).

Hipotezat që të ardhurat e privatizimit janë shpenzuar ose që janë kursyer janë shqyrtuar secila prej tyre në mënyrë të drejtpërsëdrejtë. Kjo, jo vetëm që siguron një kontroll (të fortë) rigoroz, por merr parasysh gjithashtu që për mundësi të dallueshme asnjë hipotezë nuk mund të mbështetet tek të dhënat. Veç kësaj, fortësia (rigoroziteti) do të matet: (1) duke përdorur (variabla) tregues të ndryshëm të varur (2) duke përfshirë sistematikisht disa tregues shtesë shpjegues dhe (3) duke përdorur modele të ndryshme.



Ekuacion i përdorur për të vlerësuar një impakt të përkohshëm është:

$$\Delta y_{i,t} = \mu_i + \delta \Delta p_{i,t} + \beta \Delta x_{i,t} + u_{i,t} \quad (1)$$

Ku  $\Delta$  është operatori i parë i ndryshuar,  $y_{i,t}$ ,  $p_{i,t}$ ,  $x_{i,t}$ ,  $u_{i,t}$  janë respektivisht variablat e ndryshueshëm, të ardhurat e privatizimit, variabli shtesë sqarues (nëse përfshihet) dhe mbetja; gërmat i referohen vlerës për vende  $i$  dhe periudhe  $t$ . Parametrat që vlerësohen janë  $\mu_i$ ,  $t$ -i cili është vendi - specific ose  $\delta$  dhe  $\beta$  - efekti i fiksuar. Pas disa llogaritjeve algjebrike ekuacioni transformohet si më poshtë:

$$y_{i,t} = \mu_i + \delta p_{i,t} + \beta x_{i,t} + \sum_{j=0}^t u_{i,t-j} + (y_{i,0} - \delta p_{i,0} - \beta x_{i,0}) \quad (2)$$

që tregon variablat e varur si një funksion i katër faktoreve të përgjithshëm duke lëvizur nga e majta në të djathtë: vlera e njëkohshme e privatizimit dhe e çdo variabli sqarues; historia e dëmeve dhe kushtet fillestare (termat në kllapa) që për qëllimet e tanishme mund të supozohen të merren zero. Si pasojë ekuacioni (2) nënvizon që  $\delta$  tërheq impaktin e përkohshëm të privatizimit në një variabël të varur dhe për më tepër që vlera e njëkohshme nuk ka impakt në vlerën  $y$  të së ardhmes.

Të gjitha regresionet do të administrohen në diferencat e para, atje ku diferencat janë në lidhje me variablat e përcaktuar si një kuotë e GDP-së. Ndërkohë që këto specifikime kanë disa disavantazhe të dallueshme mbi alternativa të kuptueshme, kjo është e rëndësishme për t'u theksuar që është më e përshtatshme në shembujt më të shkurtër (si rasti i mëposhtëm). P.sh gjatë një periudhe të rregullimit fiskal parashikimi për një ulje konstante në deficit është mbase vlerësimi i përafërt. Megjithatë për

shembujt aftagjatë sistemi le të kuptohet që deficitin priret të shkojë drejt plus ose minus infinitit.

Hipotezat që të ardhurat e privatizimit janë shpenzuar janë testuar duke krijuar një regresion me bilancin e përgjithshëm si **një variabël i varur** dhe për të ardhurat e privatizimit nga buxheti si një **variabël sqarues**. Një vlerësim negativ në kuptimin statistikor mund të tregojë që të ardhurat nga privatizimi janë përdorur për të ulur bilancin e përgjithshëm (p.sh për të rritur deficitin). Veç kësaj, janë provuar që hipoteza të ngjashme për të ardhurat nga privatizimi janë përdorur për të rritur shpenzimet ose për të ulur të ardhurat. Siç është përmendur me sipër të ardhurat nga privatizimi janë regjistruar si një çështje financiare si rrjedhim privatizimi nuk ka efekt të drejtpërdrejtë të të dhënat e mësipërme.

Për të testuar hipotezat që të ardhurat nga privatizimi **janë kursyer**, regresionet janë kryer duke përdorur financimet e brendshme, financimet e huaja dhe borxhin si një **variabël i ndryshuar**. Ndërkohë, borxhi mund të duket si një nga kandidatët më të mirë – të ardhurat nga privatizimi janë përdorur për të tërhequr borxhin - zhurma në këto radhe (përcaktuar si një kuotë e GDP-se) sugjeron që teorikisht një nga variablat financiare mund të jetë më i mirë. Në këtë rast hipotezat janë aktualisht më specifike: **të ardhurat nga privatizimit janë përdorur si zëvendësuese për financimet e brendshme dhe financimet e huaja**.

Eksperimenti me përkufizime të ndryshme për variablat e varur ka si qëllim të lehtësojë impaktin e zhurmave të mëdha për çdo variabël të dhënë dhe të lejojë mundësinë që impakti të jetë më i saktë dhe si rrjedhim i hapur statistikisht për variablat fiskalë të veçantë. Variablat e ndryshëm sqarues i janë shtuar sistematikisht çdo

ekuacioni regresiv për të kontrolluar fortësinë e sistemit të vlerësimit në privatizim, duke vlerësuar edhe nëse vlerat e përgjithshme janë të ndjeshme dhe zvogëlohen kundër problemeve specifike për shkak të variableve të harruar. Së fundi siç u diskutua me sipër këto ekuacione do të zhvillohen duke përdorur modele të ndryshme për të cilat *inter-alia* siguron një kontroll tjetër rigoroz. (Barnett S.(2000).IMF Working Paper: July 2000 “Evidence on the Fiscal and Macroeconomic Impact of Privatization”).

Rrjedhimisht hipotezat mbi të cilat ndërtohet punimi janë:

***H0: Privatizimi i sektorit hidrokarbur në Shqipëri, është i lidhur pozitivisht me rritjen reale të GDP-së.***

***H1: Menaxhimi efikas i privatizimit në sektorin e hidrokarbureve në Shqipëri, si nje portofol me ndikim real në GDP, paraqet një mundësi të madhe financiare dhe ekonomike për vendin.***

***H2: Privatizimi i sektorit hidrokarbur në Shqipëri mund të shihet si një mundësi për rritjen e investimeve strategjike dhe për hapjen e vende të punës menjëherë ose pas periudhës afat mesme.***

### **Pyetjet kryesore kërkimore të punimit:**

- Në çfarë lidhje janë privatizimi i sektorit hidrokarbur dhe GDP-ja ?
- Çfarë mundësish të mëdha financiare dhe ekonomike parashtrojnë një menaxhim eficient i sektorit hidrokarbur në Shqipëri ?
- A mund të shihet privatizimi si një mundësi për të financuar një rritje të konsiderueshme të investimeve në sektorët strategjikë.
- A mund të shihet privatizimi si mundësi për të hapur vende të reja pune menjëherë apo pas një periudhe afatmesme postprivatizimi?

### **Pyetje të tjera kërkimore ndihmëse:**

- Çfarë është vlerësimi i pasurisë publike dhe çfarë e bën të rëndësishëm këtë fenomen?
- Cilat janë metodat e vlerësimit të pasurisë të paluejtshme dhe si bëhet vlerësimi i pasurisë publike në Shqipëri?
- Cilat janë parimet dhe elementet e privatizimit në Shqipëri?

### **Metodat dhe metodologjia e kërkimit**

Gjatë këtij hulumtimi dhe kërkimi shkencor kam përcaktuar metodat e punës shkencore të cilat më mundësuan për të ardhur tek të dhënat e nevojshme dhe njëherësh në një shkallë të duhur të racionalitetit, ekonomizimit .

Metodat të cilat kam përdorur janë:

- Shfrytëzimi i dokumentacioneve zyrtare, dokumente të cilat i kam qasur nga institucionet shtetërore në nivelin qendror dhe lokal, ku operojnë ndërmarrjet me aktivitet biznesor në sektorin hidrokarbur, si dhe bartësit e institucioneve shtetërore kompetente për të bërë vlerësimin e pronës dhe privatizimin e ndërmarrjeve publike.
- Metoda e intervistimit; ku përmes kësaj metode kam ndërtuar intervista me qytetarët dhe bartësit e ndërmarrjeve të sektorit të hidrokarbureve.
- Metoda e bashkëbisedimit, ku përmes kësaj metode kam zhvilluar bisedime periodike në nivel konsultativ me ekspertë të fushës, për të më dhënë më shumë qartësi në nivel ekspertize sa i takon materies.
- Metoda statistikore e përpunimit të rezultateve, ku përmes kësaj metode kam bërë analizimin e të hyrave primare dhe sekondare. (Për më shumë shih në kapitullin e pestë)

### **Mundësitë dhe kufizimet**

Në aspektin e trajtimit të “kufizimeve” të këtij punimi do të mund të përmendej ndoshta një ballafaqim më i madh në raste të tjera të mundshme punimesh të aplikimeve të ndryshme, në mënyrë që çështjet të ishin sa më të krahasueshme me analiza dhe rezultate të ngjashme, duke konkluduar në këtë mënyrë në “outpute” sa më realiste në fund të këtij punimi. Në kornizë të përkufizimit, trajtimi i “çështjes” në këtë studim është bërë duke marrë për bazë të gjitha “nën çështjet”, të cilat mbulojnë thuajse tërësisht gamën e funksioneve që influencojnë në aspektin e analizës së vlerësimit, privatizimit dhe shitjes së aktiveve publike në sektorin e hidrokarbureve në Shqipëri. Në vijim të punës së këtij studimi mund të ketë patur vështirësi në lidhje me sigurimin e

informatave të ndryshme që kanë të bëjnë me temën e këtij punimi nga institucione të ndryshme publike ose nga sipërmarrjet private në Shqipëri, që janë krijuar pas privatizimit të aktiveve publike për shkak të problemeve të ndryshme me karakter objektiv apo subjektiv.

### **Rëndësia e studimit**

Si çdo punim tjetër, në stadin aktual preliminar, mbetet të ketë patjetër një pritshmëri lidhur me përmirësime të mundshme që do të vijnë gjatë procesit të zhvillimit të tij. Një element thelbësor në këtë rast mbetet organizimi lidhur me metodat që do të aplikohen, në mënyrë që ato të jenë sa më cilësore, duke marrë në këtë mënyrë “inpute” sa më realiste të plota, që do të bëjnë të mundur edhe përmirësime të mundshme relevante. Gjithashtu pritshmëri ka lidhur me njohuri të fushës ekzistuese, të cilat do të vijnë duke u përpunuar. Të gjitha së bashku do të kenë impaktin e tyre në punim.

Ky punim do të kishte veçanërisht një ndikim në praktikën e vlerësimit dhe privatizimit të pronës publike në Shqipëri, duke paraqitur përpara tyre në formë të inovacioneve të gjithë “të rejtat” që do të nxjerrë ky punim. Rezultatet e punimit mund t’i ndihmojnë ato të kuptojnë me mirë kornizën teorike apo metodikën praktike për të bërë një analizë dhe vlerësim shkencor të procesit të vlerësimit për efekt privatizimi dhe shitjes së aseteve publike në Shqipëri.

## **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim, studimi do të jetë një mbështetje metodologjike dhe praktike në vlerësimin për efekt privatizimi dhe menaxhimin e shitjes së pasurisë publike. Në lidhje me menaxhimin e privatizimit të sektorit publik për hidrokarburet në Shqipëri, synohet që nëpërmjet këtij punimi të identifikohen faktorë të tjerë të rinj që ndikojnë në këtë proces, rrjedhimisht edhe në treguesit makroekonomik të vendit. Si një proces tepër i rëndësishëm do synohet që në këtë punim të evidentohet se efikasiteti i procesit të privatizimit duhet të konceptohet ndër të tjera si tregues kyç i krijimit ose mos krijimit të tregjeve të mallrave, të kapitalit financiar dhe punës, konturimit dhe konsolidimin e tyre në kuadër të zbatimit të një reforme të përgjithshme politike dhe socialo-ekonomike. Privatizimi apo edhe ristrukturimi si proces, i zbatuar si të kombinuar apo vetëm sipas fazave të implementimit, angazhojnë si shtetin si pronar të tyre ashtu edhe pronarët e rinj që të synojnë maksimizimin e vlerave dhe potencialeve të këtij sektori në dobi të popullatës shqiptare. Më tej do mund të shikohen edhe rezultatet e periudhës së postprivatizimeve strategjike, në aspektin e dinamikës së ndikimit të tyre në performancën e ekonomisë shqiptare.

Gjithashtu studimi do mund të arrijë të përmirësojë sadopak procedurat e përdorura në programimin, planifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave strategjike ekonomike të privatizimit të pronës publike, në funksion të përmirësimit të performancës së ekonomisë shqiptare.

## KAPITULLI II:

### VËSHTRIM MBI LITERATURËN

Qysh nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik (në fund të viteve '89), shumë vende kanë filluar ri-konstrukturimin e ekonomive të tyre, e në veçanti privatizimet e firmave më të mëdha ose që kanë pasur ndikim më të madh në ekonominë e vendeve të tyre (*të ardhura, punësim, etj*). (Bjørnskov, Christian; Potrafke, Niklas, 2010). Por, vendet e Evropës qendrore, në të shumtën herë, kanë adaptuar strategji të ndryshme, ku disa në mënyrë graduale e kanë bërë adoptimin në tranzicion ekonomik, përderisa disa të tjera e patën aplikuar “*Ling Rang*<sup>1</sup>”- metodën, meqë disa vende që janë ende në proces të tranzicionit në Evropën juglindore, kanë ende punë për të bërë për të ri-struktuar disa segmente ekonomike të centralizuara, kështu që disa po veprojnë dhe po adaptohen më shpejtë, ndërsa të tjerat më ngadalë. Përderisa nëpërmes “*gradualizmit*”, vendet të cilat kanë kaluar dhe që po kalojnë nëpër fazën e tranzicionit, kanë për qëllim që të mbajnë nën kontroll sa më të lartë zbatimin e reformave ekonomike, përfshirë; *stabilitetin e çmimeve, politikën monetare-kreditore, konkurrencën, nivelin e papunësisë, etj*. Sipas Galbraith-it, “*shok terapia*”, mendon se ju konvenon vetëm atyre që nuk mendojnë përpara se të ndërmarrin ndonjë veprim, me fjalë të tjera, më shumë ju besojnë formulave sesa fakteve. Galbraith-i, gjithsesi e parapëlqen kthimin në konkurrencën e lirë të tregut, sidomos për produktet e konsumit, ndërsa për mallra të tjera<sup>2</sup> këtë kthim e parapëlqen në fazat më të vonshme të periudhës së tranzicionit (Galbraith K., 1996). Me fjalë të tjera, nga shumë autorë, teoricienë dhe ekonomistë, është menduar për një

---

<sup>1</sup>E njohur ndryshe edhe si “*terapia shok*”, e cila në mënyrën e njëkohshme ndikon që shumë shpejtë të bëhet implementimi i çdo reforme tranzicionale

<sup>2</sup>Autori me siguri e ka pasur fjalën për mallrat e luksit dhe mallrat prestigjiozë.



sistem të ri ekonomik, i cili themelet i mbështeste në rrënjët e kapitalizmit, d.m.th ashtu siç aplikohet në disa nga vendet më të zhvilluara të botës, si p.sh. ShBA, Japonia, Kanadaja, etj.

Qëllimi kryesor ishte që tregjet, përfshirë bizneset, konsumatorët, furnitorët, etj, të veprojnë në mënyrë më të lehtë dhe më fleksibile, gjithmonë duke e synuar objektivin kryesor e që ishte përzgjedhja, çmimi, cilësia, lloj-llojshmëria e produkteve dhe e shërbimeve në treg, stabiliteti financiar qendror, rritja e punësimit, etj. Pasi që koncepti i tranzicionit ekonomik përfshin në vetvete shumë problematika dhe çështje, si p.sh. *transformimin e pronës – privatizimin, investimet e jashtme direkte (në tekstin në vijim IJD), pjesëmarrjen e shfrytëzuesve të Internetit nga ana e shoqërisë dhe në veçanti ndikimi i teknologjisë informatike në rritjen dhe zhvillimin e aktiviteteve afariste, globalizimin dhe krizën e fundit financiare, liberalizimin dhe sistemin monetar, si dhe shumë faktorë të ndryshëm, të cilët në këtë punim do t'i trajtojmë, analizojmë dhe observojmë me shumë kujdes.*

## **2.1. Konsiderata teorike mbi tranzicionin**

Procesi i privatizimit në Shqipëri është realizuar nëpërmes dy metodave: a) *përmes privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore*, dhe b) *përmes krijimit dhe zgjerimit të ndërmarrjeve të reja nga kapitali vendas dhe i huaj* (Selmanaj, 2006). Si model kryesor i procesit të privatizimit, ishte privatizimi nëpërmes triskave të privatizimit (TP). TP-të ishin të këmbyeshem dhe ka mbizotëruar mundësia e këmbimit të drejtpërdrejtë me ç'rast fletë-aksionet e ndërmarrjeve këmbeshin me TP. Procesin masiv të privatizimit

përmes TP e ka shoqëruar grumbullimi i këtyre triskave nga kompani të ndryshme ku një pjesë e këtyre triskave ndodhet në duart e kampistëve të tregut ( (Selmanaj, 2006).

*Së pari*, ato janë letra me vlerë të emetuara nga qeveria shqiptare dhe si të tilla duhet të përbëjnë një detyrim për çdo qeveri shqiptare, që është ose do të vijë në fuqi. Këtu nuk kemi hapësirë të japim detaje pasi ato do të trajtohen më gjerësisht në n/kapitullin përkatës për privatizimet në sektorët strategjike, por duhet të theksojmë se ekzistojnë të gjitha mundësitë për përdorimin e tyre tërësor (por jo me vlerën nominale) gjë që do të rriste reputacionin e qeverisë.

*Së dyti*, a ka pasur dhe a ka programi i privatizimit në Shqipëri një element sado të vogël social? Mendojmë se në mënyrën e trajtimit të bonove të privatizimit ky element mungon.

*Së treti*, mendoni një situatë kur shteti mund të emetojë letra me vlerë për publikun. A mund të imagjinohet se qytetarët shqiptarë do të besojnë më tek letrat me vlerë?

**Format e privatizimit në Shqipëri;** Në realizimin e procesit të privatizimit shoqëritë me kapitale shtetërore ishin të lira të transferonin tërësisht ose pjesërisht tek sektori privat të dy llojet e të drejtave: të drejtën e pronësisë dhe të drejtën e përdorimit e të zhvillimit. Në zgjedhjen e metodës së privatizimit ndikojnë faktorë të ndryshëm, përfshirë këtu madhësinë e ndërmarrjes që do të privatizohet, sikurse dhe karakteristikat e blerësve/ investitorëve të mundshëm. Në Shqipëri, ligji lejon përdorimin e të gjitha llojeve të metodave të privatizimit. Të gjitha këto metoda, janë bazuar në objektet që do të privatizohen.

Format e privatizimit në Shqipëri mund të ndahen në dy grupe (Moisiu", 2012):

**Format "zhveshëse" nga pronësia** - duke aplikuar metodat "zhveshëse" shteti e transferon pronësinë tek pronari i ri privat, pa e mbajtur aspak rrishtun financiar. Përkundër, papunësia e gjeneruar nga privatizimi është një risk social që shteti duhet ta marrë në konsideratë dhe duhet ta përballojë. Kështu, një përfshirje indirekte financiare e shtetit është e pashmangshme. Metodatat e përmendura më poshtë karakterizohen nga mënyra e transferimit të së drejtës së pronësisë.

**Shitja direkte** përmes kësaj forme "zhveshëse", shteti si pronar i shet në mënyrë të drejtpërdrejt ndërmarrjet (ose një pjesë të aksioneve të saj) tek blerësi privat. Shitja direkte si formë mund të realizohet përmes dy mënyrave:

- shitje direkte nëpërmjet ankandit/tenderit
- shitje tek një blerës i paracaktuar.

Forma e dytë është e përdorur në Shqipëri. Objektet e privatizuara përmes kësaj metode ishin në përgjithësi shtëpitë banuese, restorantet, dyqanet, pjesë ndërmarrjeve, etj. (ky është i ashtuquajtur i privatizim i vogël).

**Shitja drejtueseve ose punonjësve** – e përbashkëta për këto skema privatizimi, është se e drejta e pronësisë i transferohen një grupi të caktuar, të cilët mund të jenë drejtues ose punonjës të po asaj ndërmarrjeje. Në Shqipëri, kjo formë është përdorur për t'i privatizuar kryesisht ndërmarrjet që janë të formës nën-njësi.

**Ankandi publik** - me këtë formë është përdorur privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (ose një pjesë e tyre), nëpërmes një konkurrimi të hapur publik.

**Likuidimi** – likuidimi është mbyllja e një kompanie dhe shitja e aktiveve të saj, përderisa ajo ka ndërprerë aktivitetin e saj për shkak të falimentimit.

**Privatizimi masiv** – forma e privatizimit masiv bazohet në shpërndarjen pa pagesë të letrave me vlerë për popullsinë. Kjo metodë synon privatizimin e shpejtë të

ndërmarrjeve, të transformuara paraprakisht në shoqëri tregtare, nga një numër i madh letrash, mbajtës të letrave me vlerë.

### **Format “jo-zhveshëse” të privatizimit**

*Transformimi* – përshin transformimin e një ndërmarrje publike në një shoqëri tregtare private, përcaktuar me ligjet në fuqi.

*Ristrukturimi* – qëllimi i tij është që të rritet vlera e ndërmarrjeve publike në mënyrë që ato të jenë më të vlefshme në procesin e privatizimit.

*Dhënia me qira* – është një marrëveshje kontraktuese nëpërmes së cilës pronarishtet i një ndërmarrje i jep me qira aktivet e ndërmarrjes për një kohë të përcaktuar kohore, me qëllim të përfitimit të ndonjë pagese ose tarife.

*Shoqëritë me kapital të përbashkët* – përkufizohet si një partneritet ndërmjet shtetit dhe subjekteve juridike private, që zotërojnë së bashku shoqërinë dhe natyrisht edhe i ndajnë përfitimet nga aktiviteti afarist.

*Kontrata shërbimi* - nëpërmes kësaj forme shteti kontraktton ndonjë subjekt privat juridik, për të kryer disa shërbime të caktuara në interesin publik, p.sh., mbledhja e mbeturinave, etj.

*Kontratat konçensionare* – nëpërmes kësaj forme shteti i transferon të drejtat e shfrytëzimit dhe përdorimit ndaj një subjekti privat, p.sh. sektorin minerar, burimet e ndryshme natyrore, etj.

Në thelb, tranzicioni post-socialist përfaqëson një eksperiencë historike unike të ndryshimeve organizative, institucionale e sistemi, të ndodhura njëkohësisht në një grup

shumë të madh vendesh. Kjo përvojë krejt e veçantë në historinë moderne përbën një sfidë të madhe për ekonomistët, sociologët, politologët, etj, për të shpjeguar dhe për të analizuar "substancën" e këtij ndryshimi ekonomiko-social të jashtëzakonshëm e të paprecedent. Si i janë "përgjigjur" veçanërisht ekonomistët kësaj sfide post-socialiste? Periudha e fillimit të tranzicionit, në momentet e fillimit të transformimit të madh post-socialist, korrespondon me një kontekst të veçantë të zhvillimit të mendimit ekonomik. Në "perëndim" mbisundonte rryma ose shkolla neo-liberale dhe anti-intervencioniste, që në fillimet e viteve 1980-të, me Thetcer-ismin" dhe "Reagan-izmin" iu kundërvu hapur teorisë dhe praktikave dominuese Keynesianiste, të ndjekura gjerësisht nga mbarimi i Luftës II Botërore. Qëndrimet dhe mësimet e Hayek-ut dhe Friedman-it i s'postuan tërësisht neokeynes-nnistët, ndërkohë që në "lindje" shënohej dështimi i teorive reformiste të socializmit dhe po shfaqej në përmasa të frikshme kriza strukturore dhe sisteme e socializmit. Organizatat kryesore ndërkombëtare, roli i të cilave do të ishte thelbësor në orientimin politik të transformimit të madh", paraqisnin mishërimin esencial të neoliberalizmit të kohës. I tillë ishte rasti "special" "konsensusit të Washingtonit", i vendosur ndërmjet FMN-së dhe Bankës Botërore, ndërkohë që edhe BERZH, OCDE, BE dhe qeveritë e vendeve kryesore perëndimore, në thelb, ndanin të njëjtat parime neoliberale. Vetëm OKB dhe Komisioni Ekonomik për Evropën (ECOSOC), për shkak të lidhjeve të tyre tradicionale me "doktrinën keynesianiste", dukej se kishin një pozicion disi më të ndryshëm ndaj "frymës së reformave në lindjen post-socialiste". E tillë ishte konjuktura mbi të cilën u formua ajo që mund të quhet doktrina e tranzicionit", e cila iu imponua të gjitha vendeve të Evropës Qendrore e Lindore. Kjo doktrinë përfshinte brenda saj korrente e influenca të ndryshme të tilla si: koncepti monetarist, sipas të cilit "inflacioni është e keqja më e madhe"; se "papunësia

është një variabël i axhustimit strukturor që orientohet nga kushtet strukturore të ekonomisë"; se "anticipimi racional i agjentëve ekonomikë", sipas tezës neoklasike, minimizon në maksimum dëshirën dhe efektet e ndërhyrjeve shtetërore; se, sipas koncepteve të ekonomisë së ofertës, "kërkesa është sekondare përballë ofertës"; konceptit Hayek-ian sipas së cilit "tregu vetë rregullohet dhe nuk ka fare nevojë për ndërhyrjen e Shtetit", ose teorinë e "dorës së padukshme" të Adam Smithit; besimit se vendet e lindjes duhet të privilegjonin vetëm "Shtetin minimal"; filozofinë e "Konsensusit të Washingtonit " bazuar në " trinitetin e shenjtë - stabilizim, liberalizim, privatizim". Por, bazat e kësaj doktrine mbështeteshin pothuajse ekskluzivisht në "mainstream neo-Idasike", në racionalitetin individual, në paradigmen e ekuilibrit të përgjithshëm, në eficiencën dhe optimalitetin e një tregu transparent e konkurrues, në eficiencën e shpërndarjes së burimeve, etj. E gjithë kjo mënyrë arsyetimi, në fund të fundit, mbështetej në një këndvështrim normativ të një situatë ideale teorike ekuilibri e transparence. Pra, duke e zbatuar këtë skemë në kushtet e tranzicionit, arrijmë në arsyetimin se situata e ekuilibrit final, e njohur paraprakisht si "ekonomia e tregut", përcakton në mënyrë strikte rrugën më të shkurtër, më eficiente e më e drejtpërdrejtë në raport me pikën e nisjes që është ekonomia socialiste inefficiente dhe në krizë të plotë. Periudha e tranzicionit do të kishte në mënyrë të paevitueshme një karakter të çekuilibruar, të shoqëruar me shumë ulje-ngritje ose bllokime të natyrave të ndryshme. Për këtë arsye, ajo duhej të ishte sa më e shkurtër, duke bërë gjithçka që shpejtësia e reformave të ishte maksimale. Për sa i përket instrumenteve dhe mjeteve me të cilat ajo do të realizohej, ato duhet të ndërtoheshin me logjikën e mëposhtme: stabiliteti do të eliminonte efektet negative të inflacionit; privatizimet do të krijonin kushtet konkrete për të nxitur agjentët ekonomik drejt eficiencës; liberalizimi do të krijonte mjedis të

favorshëm për konkurrencën reale dhe do t'i hapte rrugën "shkatërrimit krijues" të industrive e degëve të ndryshme të ekonomisë së trashëguara nga sistemi i vjetër socialist. Në këtë kontekst, filloi të mbruhej ajo që u quajt "ekonomia e tranzicionit", që në fillimet e saj nuk ishte gjë tjetër, veçse "shtrirja ose zgjerimi i teorisë ekonomike neoklasike standarde në një sferë tjetër në vendet dhe ekonomitë ish-socialiste. Kjo ishte një formë e panjohur e teorisë së konvergjencës së sistemeve, aq më tepër që institucionet ndërkombëtare si aktorët më ndikues e përcaktues në procesin e tranzicionit, u përgatitën të zbatonin një "recetë unike" për të gjitha vendet në tranzicion. Strategjia e tranzicionit dhe planet e axhustimit strukturor ishin unike për të gjithë (Civici, 2014).

Në fillim të viteve 1990-të, proceset e reformave të tranzicionit ishin pothuajse tërësisht të zotëruara nga paradigma liberale e cila u zbatua gjerësisht në vendet në tranzicion por, mbas një periudhe të parë disavjeçare, ndaj saj u formuluan mjaft kritika, shpesh shumë të ashpra, sidomos "për nënvleftësimin e reformave institucionale". Kritika kryesore erdhi nga Banka Botërore, që nëpërmjet zërit të Joseph Stiglitz, në atë kohë kryekonomist dhe zëvendëspresident i Bankës Botërore, që formuloi publikisht "emergjencën e një konsensusi post-Washington që duhej të merrte më shumë në konsideratë specifikat e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore në tranzicion" (Stiglitz, 2002). Mbas krizës ruse të gushtit 1998 dhe zbulimit të mashtrimit me 3-4 miliardë ndihma nga FMN, drejtuesit e FMN-së i morën më seriozisht kritikën e Stiglitzit, duke vlerësuar se "për vendet në tranzicion ishte e nevojshme të avancohej me të ashtuquajturat reforma të gjeneratës së dytë" që e vinin theksin te zhvillimi i institucioneve. Në nëntor të vitit 1999, Michel Camdessus, drejtori i përgjithshëm i

FMN-së, deklaronte se "ndërtimi i institucioneve solide sociale, politike e ekonomike janë një kusht i domosdoshëm për vënien në jetë dhe zbatimin e suksesshëm të politikave makroekonomike". Ky moment, konsiderohet "triumfi i mendimit dhe teorisë institucionaliste" në si analizën dhe interpretimin e specifikave të tranzicionit nga plani tek tregu i lirë; (Problematika e ndërtimit të institucioneve dhe roli i tyre në fenomenet ekonomike e ka burimin në punimet e ekonomistit amerikan, T.Weblen, i cili është autori i parë që propozoi një skemë specifike analize për lidhjet ndërmjet ekonomisë dhe shoqërisë, skemë që nuk ekzistonte as në teorinë marksiste dhe as në atë neoklasike bashkëkohore). Përkufizimet për nocionin "institucion" e vënë theksin te përcaktimi i tyre si "aksion kolektiv që ushtron kontroll mbi aksionin individual (Commons, 1935), duke bërë që në qendër të analizës së tyre të jetë problemi i veprimit "kolektiv". Përcaktimi i D.North (1990) e përshkruan institucionin si një "tërësi rregullash loje që përcaktojnë" një strukturë stimuluese", të zbatuara në zgjedhjen e agjentëve individualë. Favereau (1998) e çon akoma më tej këtë shpjegim duke i përcaktuar institucionet si "një sistem koherent rregullash, të asociuara me një kolektive qartësisht e identifikueshme dhe përgjithësisht e kushtëzuar nga një apo disa të drejta". Këtu mund të gjendet dhe perspektiva e dyfishtë evolucioniste dhe institucionaliste e vendimmarrjes dhe e koordinimit të politikave ekonomike. Mbas Luftës së Dytë Botërore, institucionalizim u nda në dy korrente të veçanta: shkolla institucionaliste e mbështetur nga ekonomistë me reputacion ndërkombëtar si J.Commons, C.Ayres, W. Mitchell, J.M.Clark, etj, të cilët e vunë theksin tek influenca e institucioneve si entitete kolektive që ndikojnë në zgjedhjet ekonomike individuale; shkolla evolucioniste, që u zhvillua nga punimet e J.Shumpeter dhe F.Von Hayek, të cilët insistonin në "rolin e paqartësisë dhe disekuilibrave në evolucionin e proceseve ekonomike. Aktualisht, kjo



ndarje në dy korrente të institucionalizimit reflektohet, nga njëra anë në punimet' neoinstitucionaliste të North dhe Williamson, dhe nga ana tjetër në rrymën neoevolucioniste të përfaqësuar nga Nelson dhe Winter. Shkolla institucionaliste po bëhet pjesë e debateve dhe para IOM Veorid të "ekonomisë së konvencioneve" si dhe të "shkollës revulacioniste". Termi "ekonomi instituconale e ndryshimit" apo tranzicionit reflekton pikërisht këtë lidhje të dyfishtë të saj, duke i konsideruar kontributet e këtyre dy korrenteve si mënyrën më të përshtatshme për te bazuar transformimet sistemime të tranzicionit të ekonomive ish-socialiste). Tranzicioni nuk konsiston vetëm në çlirimin ose krijimin e hapësirave të tjera për iniciativën private dhe konkurrencën, por nënkupton dhe shkatërrimin e institucioneve të vjetra si dhe krijimin e të reja. Kjo ide veçanërisht mbas vitit 1999, është mjaft e përhapur në analizat dhe punimet e shumta mbi tranzicionin. Por, thjesht integrimi i fjalës dhe i nocionit institucion nuk mjafton për të analizuar si duhet tranzicionin. Për më tepër, "studimi i ndryshimeve institucionale nuk mjafton për të themeluar një ekonomi institucionale të ndryshimit radikal që përfaqëson tranzicioni" (Vercueil, 2000). Kjo mund të bëhet vetëm nëse mbështetet në shpjegimin e procesit interaktiv ndërmjet institucioneve (gjeneza, zhvillimi, zëvendësimi) dhe individëve të angazhuar në veprimet me karakter ekonomik. Nga këndvështrimi institucionalist, tranzicioni i vendeve ish-socialiste ofron një perspektivë unike, pasi kërkon vënien në dyshim të fortë të të gjitha institucioneve të trashëguara nga e kaluara socialiste, e shoqëruar me një ripërcaktim të të gjitha proceseve ekonomike dhe zgjedhjeve individuale që ndodhin gjatë tranzicionit. Në këtë kuptim, tranzicioni është vetë një model tipik ndryshimesh institucionale, në të cilin institucionet konceptohen si "një diapozitiv kolektiv prodhimi dhe interpretimi të rregullave" (Vercueil, 2000). Ky përkufizim krijon mundësi që të integrohet edhe

dimensioni kolektiv i institucioneve, që si për grupet, ashtu dhe për individët vepron nëpërmjet ndërmjetësimit të rregullave (Civici, 2014).

**Institucionet në tranzicion;** Aplikimi i konceptit të institucionit në sferën e tranzicionit në vendet ish-socialiste kërkon veç të tjerave dhe pranimin e faktit se asnjë ndryshim institucional i izoluar nuk garanton i vetëm koordinimin e politikave dhe ndryshimeve të domosdoshme të tranzicionit. Transformimi i plotë i ekonomive të planifikuara kërkon një tërësi komplekse ndryshimesh institucionale. Eficienca e këtyre ndryshimeve varet nga koherenca e tyre: është pikërisht mbështetja e përbashkët e institucioneve ajo që lejon stabilizimin e pritjeve (anticipimeve) dhe zgjedhjeve të mundshme për të orientuar ekonominë drejt një shtegu tjetër zhvillimi, drejt ekonomisë së tregut. Këndvështrimi regulacionist këmbëngul në faktin se çdo koordinim ose makroekonomik kërkon patjetër dhe një tërësi homogjene institucionesh. Këto institucione kanë për funksion: koordinimin e raporteve sociale në gjirin e ndërmarrjeve (raporti i pagave); raportet e konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve (regjimi i konkurrencës); raportet monetare (regjimi monetar); mënyrën e veprimit dhe të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi (natyrën e Shtetit) ; shkallën e integritit të ekonomisë kombëtare në ekonominë rajonale e botërore (regjimi ndërkombëtar). Në rastin e tranzicionit, kësaj liste i duhet shtuar dhe sistemi legal që ka të bëjë me të drejtat e pronësisë dhe transmetimin e tyre. Kufizimi ose ngushtimi i analizës vetëm në një apo disa pjesë të sistemit në tërësi, të çon detyrimisht në injorimin e informacioneve që agjentët ekonomikë kanë nevojë në veprimet e tyre të përditshme vendimmarrëse, pra t'i kufizosh ndjeshëm ata në sjelljen e tyre ekonomike. Për pasojë, cilado qoftë rëndësia e analizës që mund t'i jepet eficiencës së tregut në shpërndarjen e burimeve prodhuese gjatë procesit të tranzicionit të ekonomive ish-socialiste, nuk mund të pranohet që

procesi i tranzicionit të barazohet ose të identifikohet vetëm me tregun dhe me ndërtimin e tij. Problematika regulacioniste, ashtu si analizat institucionaliste dhe evolucioniste, nënvizon rreziqet që paraqet hartimi dhe zbatimi i një programi reformash që e vënë theksin vetëm te faktorët e liberalizmit të ekonomisë, në dëm të ndërtimit të institucioneve të nevojshme që rregullojnë konkurrencën dhe konsolidojnë kushtet e prodhimit dhe të inovacioneve (Boyer, 1993). Në procesin e tranzicionit roli i institucioneve është i dyfishtë: nga njëra anë, stabilizon rregullat e veprimit, sidomos atyre që ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e jetesës ; nga ana tjetër, krijon mundësinë e lindjes së rregullave të reja gjithnjë e më të përshtatshme me ekonominë e tregut. Nëse neglizhohet roli i parë i institucioneve, ato dështojnë në zvogëlimin e paqartësive që kanë agjentët ekonomikë, duke i detyruar ata që marrin vetëm vendime afatshkurtra dhe në nivele të ngushta lokale. Nëse neglizhohet roli i dytë, rritja ekonomike dhe zhvillimi i ekonomisë cënohen, se ndërmarrjet dhe individët nuk bëjnë investimet ose zgjerimin e kërkuar të aktivitetit ekonomik. E thënë në mënyrë të përgjithshme: reforma e institucioneve gjatë periudhës së tranzicionit nuk duhet të konsistojë vetëm në çlirimin e energjive të fjetura ose të fshehura", siç u mendua dhe veprua në jo pak raste në shumicën e vendeve ish-socialiste. Efikasiteti i ndryshimeve institucionale varet nga mënyra sesi ato ndërtohen dhe përshtaten me mjedisin konkret të çdo vendi, si dhe nga komplementariteti i tyre. Në rastin e tranzicionit, ndryshimet institucionale nuk mund të jenë spontane, siç mendonin partizanët e terapisë së shoc-ut, por ato duhet të jenë të ndërtuara me kujdes në kuadrin e përgjithshëm të reformave (Dewatripont, 1996) (Civici, 2014).

**Tranzicioni si ndryshim institucional: nevoja për institucione të pavarura dhe objektive ;** Analiza institucionaliste kërkon që të merren seriozisht në konsideratë dhe

kushtet që garantojnë eficiencën e institucioneve, mjedisin ku ato ndërtohen e veprojnë. Një këndvështrim i tillë normativ bazohet në idenë se institucionet mund ta luajnë si duhet rolin e tyre koordinues vetëm në rastet kur ato janë të pavarura dhe objektive në raport me agjentët ekonomikë. Veprimi normalizues dhe udhëheqës i institucioneve ekziston vetëm si pasojë e karakterit të tyre sa më sovran (Aglieta et al, 1982). Cilado qoftë efienca e rregullave të hartuara, ato nuk mund të kenë efektin e duhur në sjelljen dhe zgjedhjet ekonomike, nëse nuk ekziston besimi dhe bindja për statusin e pavarur të institucionit që i përmban ato. Kjo është e mundur vetëm në rastet kur në lidhjet ndërmjet institucioneve dhe agjentëve ekonomikë, është ndikimi i institucionit ai që mbisundon. Shembull tipik në këtë drejtim është funksionimi i tregjeve: ato funksionojnë normalisht vetëm nëse institucioni i tregut dhe rregullat e tij dominojnë mbi interesat personale të agjentëve ekonomikë që veprojnë në këtë treg, kur ky institucion shmang monopolet apo oligopolet, kur ai krijon transparencën e duhur, kur vepron me sanksione kundrejt atyre që kërkojnë të influencojnë në funksionet e tij apo kërkojnë ta vendosin atë në shërbimin e tyre personal. Institucioni i tregut ka rol destabilizues edhe kur lejon që të zhvillohen "fluska spekulative", të cilat më shumë se gjithçka shprehin dobësitë e sovranitetit të tregut si institucion, duke kërkuar njëkohësisht ndërhyrjen e institucioneve të tjera plotësuese që të mund të ndalohej mekanizmi i përvetësimit të sovranitetit të tregut nga agjentët ekonomikë që veprojnë në të. Megjithatë, nevoja për institucione të pavarura e objektive nuk përkthehet automatikisht si një shkëputje totale e tyre nga mjedisi ku ato veprojnë. Çdo institucion, cilado qoftë fusha e veprimit ose qëllimi për të cilin është ngritur, është në fund të fundit, fryt i aktivitetit njerëzor. Institucioni dhe aktiviteti i tij janë të ndjeshëm ndaj evolucionit të sjelljes së agjentëve ekonomikë. Pavarësia e tyre nënkupton më së shumti

një ndarje të interesave. Aktiviteti i institucionit justifikohet vetëm në karakterin kolektiv të marrëveshjes që e ka prodhuar atë, marrëveshje që ka në thelbin e saj "një qëllim kolektiv". Nëse, në praktikë ndodh, që shumica e vendimeve që prodhon ky institucion, janë vendime të marra nga një pakicë aktorësh ekonomikë, atëherë mund të thuhet se institucioni ka devijuar, ose dhe ka tradhtuar vullnetin kolektiv që e krijoi atë. Ky është rasti kur institucioni e humb karakterin e tij të pavarur: kur rezultatet që prodhohen nga veprimtaria e tij shfaqen të orientuara vetëm drejt interesave të një numri të vogël agentësh ekonomikë, duke anashkaluar pjesën më të madhe të tyre. Në këto momente, ky lloj institucioni është i kontestueshëm, i pabesueshëm dhe duhet ndryshuar (Salais et al, 1993). Por, në këtë arsyetim, është e nevojshme të nënvizohet se "eficiencia e institucioneve nuk duhet barazuar me paanshmërinë e tyre". Lufta e grupeve të interesit për të influencuar më shumë se të tjerët është një nga karakteristikat bazë të institucioneve, ndërkohë që edhe teoria e "ekonomisë së institucioneve" e studion veçanërisht këtë karakteristikë të tyre. "Paradoksi i Oslon-it" dëshmon se në rrethana të caktuara, marrëveshjet kolektive nuk transformohen në veprime efektive nëse në to nuk ka interesa individuale. Pra, paanshmëria e institucioneve nuk mjafton për të siguruar eficiencën e institucionit. Çështja shtrohet në një drejtim tjetër: cili është kufiri në të cilin influenca e interesave të veçanta në sjelljen e institucionit, mund ta dobësojë pavarësinë e tij, mund të minojë legjitimitetin e tij dhe ta bëjë atë joefektiv? Gjatë tranzicionit sistemik në vendet ish-socialiste ndodhën një seri ndryshimesh thelbësore institucionale, në ballë të cilave qëndrojnë ripërcaktimi i rolit të Shtetit dhe tregut. Duke zbatuar optikën e pavarësisë së institucioneve në fenomenin e tranzicionit, analiza institucionale e tranzicionit shtron për zgjidhje pikërisht çështjen e së ardhmes

së sovranitetit/paanshmërisë të shtetit dhe tregut në të gjitha vendet e Evropës Qendrore e Lindore në tranzicion (Civici, 2014).

Mancur Oslon konstatoi një paradoks në «logjikën e aksionit kolektiv»; Sipas tij, mobilizimi i individëve në favor të një kauze të përbashkët nuk është i njëjtë. Oslon konstatoi se: «edhe kur ekzistojnë situata nga të cilat individët mund të nxjerrin avantazhe të shumta duke u angazhuar kolektivisht, një pjesë e tyre përsëri nuk angazhohet». Si shpjegohet kjo mungesë mobilizimi? Oslon përdori hipotezën se aktorët ekonomikë janë racionalë (*homo economicus*) dhe tentojnë të llogarisin përfitimet individuale edhe në veprimet kolektive, sepse çdo veprim kolektiv ka koston e tij për çdo individ (angazhim, rrezik, kohë e harxhuar, para të investuara, etj.) si dhe avantazhet që përfitohen prej aksionit kolektiv (rritje rroge, punësim, mbrojtje sociale, etj.). Ekziston një tendencë e qartë tek anëtarët e një grupi që të përfitojnë nga veprimi kolektiv duke kërkuar njëkohësisht që të kenë kosto sa më të vogël nga ky veprim. Sa më i madh që të jetë grupi, aq më e madhe është dhe kjo tendencë. Kjo quhet fenomeni i «kalimtarit klandestin» ose i « kalorësit të vetëm », ose si « paradoksi Oslon grupet e mëdha mund të qëndrojnë të paorganizuara dhe mund të mos kalojnë kurrë në veprime konkrete, edhe pse ekziston një konsensus mbi objektivat e përbashkëta dhe mjetet për t'i realizuar ato (Civici, 2014).

Reduktimi i perimetrit të shtetit është absolutisht i domosdoshëm gjatë tranzicionit, pasi prania e tij nëpërmjet planifikimit të centralizuar duhet të zëvendësohet nga një ekonomi e decentralizuar në të cilën institucionet publike dhe iniciativa private bashkekzistojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën. Në këtë rast, shteti duhet të pësojë një proces tërheqjeje pjesore në raport me praninë e tij në mëparshme në fushën e rregullimit të ekonomisë, për t'ia lënë mekanizmave të tregut kujdesin për koordinimin e

aktiviteteve dhe shpërndarjen eficiente të burimeve prodhuese. Shteti duhet të jetë sa më objektiv dhe i pavarur në raport me interesat e individëve ose grupeve të ngushta të interesit. Punimet e shumë autorëve, që e kanë studiuar këtë fenomen në vendet në tranzicion dëshmojnë se, nëse procesi i parë, ai i zvogëlimit të përmasave dhe i rolit të shtetit në ekonomi (privatizime masive, ulje e peshës së shpenzimeve publike, liri ekonomike e zgjeruar në treg, etj.) është realizuar me sukses në shumicën e vendeve ish-socialiste, procesi i dytë, ai i paanshmërisë së shtetit (ndarja e qartë ndërmjet interesave publike dhe atyre private, shkalla e influencës në vendimet dhe politikat publike), konsiderohet si një dështim, ose më e pakta si një deziluzion në raport me shpresat në periudhën e parë të tranzicionit (Civici, 2014).

**Paradigma regulacioniste: ekuilibri i vështirë ndërmjet ndryshimeve ekonomike dhe ndryshimeve institucionale;** Në vitet 1993-95, si pasojë e efekteve shpesh të padëshirueshme të strategjisë së terapisë së shoc-ut në Rusi dhe në Poloni, por dhe ndryshimeve në orientimin e politikave ekonomike në SHBA dhe mjaft vende të OCDE-së, pozicioni ekstrem liberal sipas së cilit "vetëm tregu i lirë ka mundësi e kapacitet që të rregullojë ekonominë" filloi të rivlerësohej. Për pasojë, edhe një pjesë e mbrojtësve të zjarrtë të tregut të lirë filluan ta rishikojnë pozicionin e tyre dhe të konvertojnë drejt një qëndrimi më të ekuilibruar, sipas të cilit "ndryshimet ekonomike dhe ato institucionale duhet të ecin paralelisht". Regulacionistët insistonin në rolin përcaktues të formave institucionale, pasi ato kushtëzonin bashkëveprimin e agjentëve ekonomikë, kodifikonin sistemin e interesave nëpërmjet të cilave tregjet mund të manifestonin eficientësinë e tyre. Debatet mbi politikat ekonomike u përqendruan në fatalitetin e këndvështrimit "bardh e zi": nëse planifikimi i centralizuar ishte një dështim, atëherë duhej kaluar menjëherë tek tregu i lirë. Kjo ishte kryefjala e çdo

politike ekonomike në vendet ish-socialiste në vitet e para të tranzicionit. I njëjti besim, që ekzistonte për institucionet socialiste, u zëvendësua nga ai për tregjet, duke bërë që miti i marksizëm-leninizmit shpëtimtar të zëvendësohej nga miti i liberalizmit çudibërës. Në këtë kuadër, qeveritë e vendeve të lindjes, të këshilluara nga ekspertët dhe institucionet ndërkombëtare, u treguan të gatshme të ndryshonin radikalisht çdo lloj institucioni që konsiderohej si "trashëgimi e së kaluarës". Por, eksperiencia e mjaft vendeve, ka treguar se "tregjet, në lindje ose në perëndim, kanë patologjintë e tyre specifike... se tregjet nuk janë vetërregulluar spontanisht, por janë ndërtuar historikisht, kulturalisht e politikisht, në mënyrë që cilësitë e tyre vetërregulluese të garantohen akoma më shumë dhe të konkludojnë në elemente të tilla si lehtësirat e hyrjes në treg, cilësia e prodhimeve, konkurrenca transparente, procedurat e zbatimit të kontratave dhe falimentimet, etj." (Boyer, 1994). Në këtë sens, teoria regulacioniste këmbëngul në faktin se "tregu është një institucion si gjithë të tjerët" dhe jo një alternativë e një ekonomie pa institucione, pa sistem juridik, pa shtet që garanton pronën dhe të drejtën, pasi në këto kushte dhe vetë institucioni i tregut nuk funksionon në mënyrë eficiente, bile mund të shkaktojë dhe kriza e tronditje të mëdha ekonomike e sociale. Pikërisht, në fund të shek. XX kur ekonomistët dhe politikanët po bënin bilancin e kapitalizmit ultraliberal të "Thatcherizmit" në Britaninë e Madhe dhe "Reagan-izmit" në SHBA duke dëshmuar karakterin e limituar të fuqisë auto rregulluese të tregut, vendet ish-socialiste, të velura nga planifikimi i centralizuar dhe shteti kudo-i pranishëm, pikërisht te vetë rregullimi i tregut dhe largimi i shtetit dhe institucioneve të tjera, shikonin të vetmen shpresë e mundësi që të realizonin tranzicionin dhe të zhvilloheshin. Në argumentet dhe besimin e tyre tek tregu, vendet ish-socialiste u lidhën shumë mbas argumentit të suksesit të ekonomive kapitaliste perëndimore, sidomos në fazën e parë të



revolucioneve industriale, kur "tregu i lirë kapitalist" triumfoi ndaj çdo forme tjetër tradicionale prodhimi ose organizimi. Askush nuk dyshonte se vendet ish-socialiste të lindjes kishin provuar një situatë ekstreme burokratizimi dhe politizimi të ekonomisë, por kjo nuk mund të përktehej si një “dashuri me shikim të parë me tregun dhe vetëm tregun”. Natyrisht që penduli i historisë do të ndryshonte në sens të kundërt për këtë grup vendesh, por kjo zhvendosje e tij nuk duhej identifikuar 100% me ultraliberalizmin dhe tregun e gjithëfuqishëm. Kjo bëri që të neglizhoheshin tërësisht koncepte të tilla si "kufizimet dhe inefficienca e shtetit nuk duhet të të errësojnë sytë përballë devijimeve të tregut", "tregu në vetvete është para së gjithash një ngrehinë politike, historike e sociale përpara se të jetë ekonomike", etj. Modeli universal i "Homo economicus" - personazhi bazë i ekonomisë neoklasike, individi ose aktori ekonomik, i zhveshur nga e kaluara historike, nga traditat kulturore, nga opinionet politike ose marrëdhëniet sociale — arsyeton vetëm ekonomisht në një treg të lirë, pasi jashtë tregut, gjithçka duhet të jetë universale, e pandryshueshme, pa efekte në aktivitetin ekonomik (Bruron, 1985). Politikanët e vendeve të lindjes u dashuruan me teorinë neoklasike dhe me recetat e saj për zhvillimin ekonomik, duke u preokupuar gjatë gjithë kohës vetëm për rritjen ekonomike dhe shumë pak për transformimet sociale e institucionale (Barnes et al., 1992). Thjeshtësia dhe eleganca e modeleve neoklasike patën pasoja të dukshme në shumë vende të lindjes: moskuptim i mjaft fenomeneve e tendencave të tranzicionit, politika irrealiste, injorim i kërkesave sociale, etj. Në këtë optikë të shikimit të zhvillimeve në dekadën e parë të tranzicionit, është e vështirë të merret si e mirëqenë se strategjia e transformimeve të shpejta duke u mbështetur vetëm tek "efekti dhe roli i tregut" mund të sillte ato rezultate që shpresoheshin. Shumë autorë, që e kanë studiuar këtë proces, në vendet e lindjes (Boyer, 1995 ; Sapir, 1993 ; Wild, 1996) mendojnë se

duhet të merret seriozisht në konsideratë hipoteza sipas së cilës "sfida nuk qëndron te krijimi i tregut, por tek transformimi i një gjenerate të tërë njerëzish, qofshin këta në rolin e prodhuesit, menaxherit ose konsumatorit". Rritmi i ndryshimit të "zakoneve, sjelljeve, koncepteve dhe institucioneve është mjaft më i ngadaltë sesa mënyrat e prodhimit dhe të tregtimit, pasi inercia e vlerave dhe e institucioneve të vjetra është e gjatë". Në këto kushte, duket se transformimi i vërtetë nuk është çështje muajsh ose vitesh siç nënvizohej me bujë në fillim të tranzicionit, por çështje dekadash e gjeneratash të tëra. Shembujt e Rusisë, Bullgarisë, Rumanisë, Shqipërisë, Maqedonisë, Ukrainës, Moldavisë, Gjeorgjisë, Azerbajxhanit, etj, e dëshmojnë më së miri një konkluzion të tillë. Aq më tepër, që procesi i tranzicionit evidentoi dhe një faktor tjetër që nuk ishte marrë në konsideratë nga recetat unike liberale: startin e pabarabartë ose nivelin e ndryshëm të përgatitjes nuk e kishin vendet ish-socialiste "për të absorbuar periudhën e tranzicionit". Trashëgimia e strukturave të tyre prodhuese, e mekanizmave të marrjes së vendimeve, kultura e tyre politike dhe aftësia e saj për konsensus, mentaliteti ndaj ligjit dhe kontratave, marrëdhëniet e mëparshme historike me shoqërinë kapitaliste, etj, tregoi se "tranzicioni nuk varej vetëm nga faktori apo aktori treg, por edhe nga trashëgimia historike në kuptimin e gjerë të saj", duke bërë që çdo vend, pavarësisht universalitetit të tranzicionit si proces, të përballej e të ecte në rrugën e tij specifike drejt kapitalizmit (Civici, 2014)

#### *2.1.1. Aktet Ligjore dhe nënligjore të Sektorit të Privatizimit të Aseteve*

- Ligji nr. 9583, datë 17.07.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar;

- Ligji nr. 9967, datë 24.07.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 09.07.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare dhe tregtarët”;
- Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”;
- Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”;
- VKM nr. 428, datë 9.06.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”.
- VKM nr. 819, datë 29.11.2007 “Për privatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo të institucioneve shtetërore”;
- VKM NR. 408, DATË 31.08.1999 “Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore”;
- VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”;
- Udhëzim Nr. 1 datë 22.11.2010 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 428, datë 9.06.2010 “Për kriteret e Vlerësimit të Pronës Shtetërore që Privatizohet apo Transformohet dhe për procedurën e Shitjes”

**Sektori i Privatizimit të Shoqërive Tregtare dhe Likuidimit;** Procesi i privatizimit i Shoqërive Tregtare dhe Likuidimit është ndjekja e procedurave ligjore dhe nënligjore që lidhen me privatizimin, procesin e transferimit të së drejtës së pronësisë shtetërore të personit juridik, fizik ose privat.

Sektori i Privatizimit të Shoqërive Tregtare dhe Likuidimit vepron dhe punon në përputhje me dispozitat e:

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- Ligji Bazë Nr.8306, datë 14.03.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” të ndryshuar në zbatim të të cilit përgatitet kuadri ligjor përkatës për çdo shoqëri, përfshihen:
  - o Ligji Nr. 8459, datë 11.2.1999 “Për një ndryshim në ligjin nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë
  - o Ligji Nr.8582, datë 23.2.2000 “Për një shtesë në Ligjin Nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”
  - o VKM Nr.329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, i ndryshuar

Si procedurë, Komisioni për Vlerësimin e Ofertave të paraqitura nga investitorët e interesuar për blerjen e aksioneve, harton raportin e vlerësimit dhe e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave, i cili miraton edhe fituesin e tenderit. Me fituesin zhvillohen negociimet dhe lidhet kontrata e shitjes së aksioneve të shoqërisë.

Miratimi i kontratës së shitjes është aktiviteti përfundimtar i procesit të privatizimit dhe realizohet nga Këshilli i Ministrave dhe Parlamenti.

Për të konfirmuar garancitë e nevojshme për blerësin, kontrata për blerjen e aksioneve, kalon për ratifikim në Parlament.

***Ligje të tjera në fushën e privatizimit janë:***

- Ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, (i ndryshuar) si dhe të gjitha akteve nënligjore që lidhen me këto ligje bazë;

- Ligji Nr.7582, datë 13.07.10993 “Për ndërmarrjet shtetërore” (i ndryshuar)

- Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar)

- Ligji Nr.9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”

- VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 “Për Miratimin e Rregullave të ankandit publik”

- VKM Nr.418, datë 09.07.1998 “Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve të falimentuara në rrugë administrative”

- Udhëzimit Nr.5380, datë 20.07.2011 “Për procedurat e shitjes me ankand publik të aseteve të shoqërive anonime me kapital shtetëror në likuidim”

- Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

- Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”

- VKM për rastet e kalimit të ndërmarrjeve shtetërore në likuidim (specifike për çdo rast)

- Urdhrat e Ministrit për kalimin e shoqërive shtetërore në likuidim (specifike për çdo rast)

**Detyrat kryesore të sektorit të privatizimit të shoqërive tregtare dhe likuidimit;**

- Ndjekja e procedurave ligjore e nënligjore të privatizimit të paketës së aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët strategjikë, në përputhje me Strategjinë e Privatizimit

- Ndjekja e procedurës ligjore të likuidimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërive në likuidim në lidhje me aktivitetin ekonomiko-financiar dhe shitjen e aseteve të tyre me anë të procedurave të ankandit publik, duke bashkëpunuar me ndërmarrjet dhe shoqëritë në likuidim

- Kryerja e analizave të balanceve të Shoqërive Anonime dhe të Përbashkëta duke bërë miratimin dhe propozimin për përdorimin e rezultatit të ushtrimit

- Ndjekja e detyrave të ngarkuara nga eprorët në drejtim të aktivitetit të tyre dhe zhvillimit të ankandëve me transparencën e duhur

- Ndjekja e procesit të vlerësimit të objekteve dhe miratimit e raporteve vlerësuese për përcaktimin e vlerës fillestare të shitjes

- Dhënia e asistencës së nevojshme në drejtim të procedurave që ndiqen nga shoqëritë

- Monitorimi dhe mbikqyrja e procesit të likuidimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive Shtetërore në likuidim

- Organizimi dhe kontrolli i informacionit dhe evidentimi i problematikës në lidhje me aktivitetin likuidues të shoqërive dhe ndërmarrjeve, analizimi i problemeve të ngritura, informimi i titullarit dhe këshillave mbikqyrës të shoqërive për mbarëvajtjen e punës së tyre

- Ndjekja e procedurave të transformimit të ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare të formës anonime
- Ndjekja e procedurave të privatizimit të shoqërive anonime me kapital shtetëror dhe të Shoqërive të Përbashkëta
- Ndjekja procedurale e ndryshimeve në Aktet e themelimit të shoqërive tregtare shtetërore ose me pronësi mikse dhe ndjekja e depozitimeve në regjistrin tregtar të akteve të transferimit të së drejtës së pronësisë nga shteti tek të tretët
- Ndjekja e procedurave të likuidimit në rrugë gjyqësore të shoqërive anonime të shpallura në likuidim
- Ndjekja e procesit të hipotekimit të pasurisë së paluajtshme në shoqërive tregtare shtetërore dhe ato me pronësi të përzier
  - o Sigurimi në kohë dhe në mënyrë profesionale për eprorët të informacioneve të nevojshme dhe të kërkuara lidhur me zbatimin e politikave të likuidimit të shoqërive dhe ndërmarrjeve në likuidim konform bazës ligjore në fuqi
  - o Asistimi në ndihmën që u jepet Ndërmarrjeve dhe Shoqërive në likuidim dhe monitorimi i realizimit me sukses të ankandeve të organizuara për shitjen e aseteve të shoqërisë
  - o Zbatimi me përgjegjësi i kodit etik dhe të parimeve të etikës profesionale

#### 2.1.2. Privatizimi në Sektorin Strategjik. Strategjia e privatizimit dhe implikimet e saj

Sot tingëllon absurd theksimi i bërë në Strategjinë e privatizimit “Brenda vitit 1997 qeveria do të marrë në analizë fenomenin e krijuar nga emetimi i pabalancuar ligjërisht, ekonomikisht dhe pa kushte tregu të lekëve dhe bonove të privatizimit, duke parashikuar masat për të kapërcyer gjendjen e rënduar”

Bonot e privatizimit, deri me tani, janë përdorur në procesin e privatizimit për:

- blerjen e aksioneve të shoqerive anonime shtetërore (të vogla e të mesme) gjatë privatizimit të tyre.
- transferimin e paketave të aksioneve për punonjesit e shoqerive të privatizuara
- blerjen e aktiveve fizike (aseteve) ose Ndërmarrjeve të vogla gjatë ankandeve publike ose në shitjen direkte të tyre.
- Janë depozituar në Fondet e Investimit.

Emetimi i bonove të privatizimit u bë nga Banka e Shqipërisë sipas përcaktimeve të Ministrisë së Financave, ndërsa shpërndarja ju ngarkua Bankës së Kursimeve.

Gjithashtu bonot e privatizimit janë të tregtueshme ndërmjet shtetasve shqiptare, Ndërsa pas miratimit të Ligjit nr. 8162, datë 7.11.1996, "Për miratimin me disa ndryshime të Dekretit nr. 1630, datë 1.11.1996...", edhe të huajt mund të blejnë dhe të përdorin bono privatizimi ashtu si dhe shtetasit shqiptarë.

Bonot e privatizimit u planifikuan të shpërndareshin në tre valë, por me vonë u realizuan vetëm në dy valë. Bonot e privatizimit të shpërndara në valën e parë kishin afatin e përdorimit deri në korrik të vitit 1996, dhe përbënin 1/5 e bonove. Vala e dytë filloi të shpërndahej në shtator 1996. Me Aktin normativ nr.4, datë 16.2.1999 "Për një ndryshim në Ligjin nr. 8162, datë 7.11.1996, "Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 1630, datë 1.11.1996", afati i përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit është deri më 31.12.2005.

Vlera e bonove të privatizimit ka rënë në mënyrë të vazhdueshme në treg. Zhvlerësimi ka ardhur si rrjedhim i disa faktorëve, nga me kryesoret mund të përmenden:

- Procesi i privatizimit masiv, i cili transferoi në mënyrë të menjëhershme



pronësinë tek aksionaret privat të shoqërive me borxhe të mëdha, menaxhim të dobët, treg të dominuar nga importi dhe i pa kontrolluar, etj, nuk dha efektet e parashikuara.

- Raport i disfavorshëm i vlerës së kapitaleve shtetërore të hedhur në treg dhe vlerës së shpërndare të bonove dhe lekëve të privatizimit.
- Efekti i krizës së piramidave në fillim të vitit 1997, e uli vlerën e tyre deri në masën 2-3 %.

Në ndryshim nga Çekia (vendi nga ku u mor modeli i privatizimit ) në Shqipëri tregtimi i bonove të privatizimit me *Cash* –in u la e lirë. Tregu informal shërbeu si vendi i një shkëmbimi të tillë duke i dhënë atij një dimension të ri joformal me pasoja ekonomike, sociale e politike.

**Tabela 1. Situata për bonot e privatizimit të emetuara ( në lekë privatizimi) është:**

|                            |                                            |
|----------------------------|--------------------------------------------|
| Të shpërndara              | 51.229.000.000 lekë privatizimi ose 68.3 % |
| Të pashpërndara            | 23.748.000.000 lekë privatizimi ose 31.7 % |
| <b>Totali</b>              | <b>74.977.000.000 ose 100.0 %</b>          |
| Të përdorura në privatizim | 10.935.193.000 lekë privatizimi ose 14.6 % |
| Të pa përdorura            | 64.041.807.000 lekë privatizimi ose 85.4 % |

Situata për lekët e privatizimit, të cilat u janë shpërndarë ish të përndjekurve politike është:

|                            |                                            |
|----------------------------|--------------------------------------------|
| Të shpërndara              | 17.113.000.000 lekë privatizimi ose 100.0% |
| Të përdorura në privatizim | 4.668.759.000 lekë privatizimi ose 27.4 %  |
| Të pa përdorura            | 12.444.241.000 lekë privatizimi ose 72.6 % |

(Burimi : **Banka e Shqipërisë**)

**Mundësia e përdorimit të Letrave me Vlerë dhe Bonove të Privatizimit në privatizimin e shoqërive tregtare shtetërore që veprojnë në sektorët strategjike;**  
Angazhimi i qeverisë shqiptare për përdorimin e letrave me vlerë në sektorët strategjike,

shprehet në Ligjin nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjmë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", në nenin 8 të të cilit theksohet që: "Pjesëmarrja me letra me vlerë për privatizim, në privatizimin e ndërmarrjeve dhe shoqërive të sektorëve me rëndësi të veçantë, përcaktohet në formulën e privatizimit, por në çdo rast ajo nuk mund të jetë më e lartë se 20 përqind e kapitalit të kontabilizuar...".

Përdorimi i bonove dhe lekëve të privatizimit në shoqëritë tregtare të sektorëve strategjike përcaktohet me ligj të veçantë për secilën shoqëri.

**Hapat që mund të ndërmerren për futjen në përdorim të letrave me vlerë dhe bonove të privatizimit;** Për futjen në përdorim të lekëve dhe bonove të privatizimit duhet të plotësohen disa parakushte:

**Së pari:** përgatitja dhe miratimi i amendimit të Dekretit të Presidentit nr. 1030, datë 23.02.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit", për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të përdorimit të letrave me vlerë.

**Së dyti:** të përgatitet dhe miratohet kuadri i nevojshëm ligjor, për përcaktimin e platformës dhe programit të përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit.

**Së treti:** është e nevojshme të bëhet inventarizimi i gjendjes aktuale të shpërndarjes së tyre dhe poseduesve të tyre, evidentimi i shpërndarjes së deritanishme dhe përcaktimi i skemës së ndarjes së pjesës të pashpërndare të letrave me vlerë.

**Së katërti,** licencimi i një numëri të caktuar të Fondeve të Investimeve nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Banka e Shqipërisë, pasi aktualisht shoqatat joqeveritare (përfshirë edhe atë në fjalë) janë juridikisht të pa licencuara për grumbullimin dhe administrimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

**Së pesti**, përcaktimi nga Ministria e Financave i një raporti të qartë për të ardhurat nga privatizimi, midis lekë dhe/apo Bono + Lekë privatizimi.

### *2.1.3. Pjesëmarrja e punëtorëve në vendimmarrje përkitazi mbi procesin e privatizimit.*

Në qasjen analitike të problemeve, çdo fazë të procesit të vendosjes e shqyrtojmë në mënyrë të veçantë, por duke mos humbur nga kujtesa që secila fazë në realitet shkon njëra pas tjetrës dhe nuk janë gjithaq të ndara mekanikisht ndërmjet tyre. Nëse duam shkurtazi të dëshmojmë shkallën e pjesëmarrjes së punëtorëve nëpër faza të veçanta të procesit të vendosjes, vërehet se në renditjen normale, të këtyre fazave punëtorët nuk marrin pjesë në tri fazat e para të procesit të vendosjes, përkatësisht nga faza e paraqitjes së problemit e gjer te ajo e shqyrtimit të projektvendimit; Rrjedha logjike e fazave të vendosjes është: 1. Paraqitja e problemit, 2. Studimi i problemit, 3. Përpunimi i projektit të zgjidhjes, 4. Njoftimi përfaqësuesve me projektzgjidhjen, 5. përgatitja e përfaqësuesve për vendosje, 6. Shqyrtimi në tubime, 7. Votimi, 8. Realizimi i vendimit (Marijanovid, Donoenjë, 1971: 47).

Pjesëmarrja e punëtorëve në faza të tjera mund të minimizohet ose të maksimalizohet, përkatësisht mund të kryhet formalisht ashtu që vendosja të realizohet vetëm në aktin e votimit, dhe atë me ngritjen mekanike të dorës. Në këtë vend nuk ka nevojë dhe nuk dëshirojmë të lëshohemi në shqyrtimin e kësaj praktike, por të kontestojmë faktin që sot vendosja e zakonshme të mos ketë mundësi që një gjë e tillë të ndodhë. Atëherë kur punëtori fillon të marrë në duar të veta menaxhimin mbi afarizmin akumulimin dhe marrëdhëniet e ndryshme, ai krijon bazat, por vetëm bazat, të bëhet menaxher. Vetëm mbi këtë bazë mund të realizohet mundësia e participimit të plotë mbi afarizmin dhe ndoshta riprodhimin e përgjithshëm. Faza e parë, iniciativa përkatësisht

paraqitja e problemit nuk është sipas rregullit në duart e punëtorit, por iu takon më shumë apo më pak ekspertëve - shërbimeve profesionale dhe të specializuara. Mbi njohjen e problemit apo idesë punëtori është i obliguar të njoftojë instancat më të larta. Informacioni plotësohet dhe zgjerohet në thellësi të ndërmarrjes varësisht nga natyra e problemit mbi të cilin do të merret vendimi, por në rrjedhë normale gjërat dhe informacionet nuk dalin jashtë rrethit të ekspertëve dhe punëtorëve udhëheqës. Në shumicën e rasteve punëtori përmbajtjen e kësaj faze nuk e njih.

Përmbajtja e fazës së dytë të vendosjes po ashtu mbetet jashtë fushë veprimtarisë së punëtorit, sepse përmbajtja e problemit, si dhe njohja e çështjeve të tilla nga aspekti i informimit të punëtorit nuk është e mundur. Ekspertët të cilët nga faza e mëparme e definojnë problemin tani e marrin në shqyrtim si grup profesionist. Përpunimi i propozimit të zgjidhjes si fazë e tretë vazhdon nga faza e dytë dhe për arsye të ndryshme bën pjesë në fushë veprimtarinë e ekspertëve, udhëheqësve për plotësime të ndryshme në ekipin e ekspertëve në raport ndaj fazës së mëparme. Projektvendimi si propozim i zgjidhjes së problemit përpunohet në një apo disa variante. Punëtorët si kolektivitet edhe në këtë fazë nuk janë të informuar në mënyrë të plotë mbi paraqitjen e problemit.

Në fazën e katërt bëhet përgatitja e projekt-propozimit të vendimit me arsyetime të nevojshme, për paraqitje para anëtarëve të kolektivit dhe përfaqësuesve të privatizimit/vlerësim për privatizim. Përgatitja e materialit për mbledhje, dhënia e materialit punëtorëve dhe anëtarëve tjerë si përfaqësues të menaxhimit, kuptohet formalisht si rregull në informim. Përgatitja për vendosje, e njohur si faza e pestë, vazhdon menjëherë pas fazës së katërt. Kjo do të thotë që për vendime të rëndësishme edhe trupi zgjedhës duhet të njoftohet me material të përgatitur për mbledhje të menaxhimit për

privatizimit/vlerësim për privatizim, përkatësisht mbi përgatitjen e propozimit të vendimit. Vendosja përmes përfaqësuesve bazohet në pjesëmarrjen aktive të strukturave të ndryshme në ndërmarrje. Në fazën e gjashtë përfaqësuesit e menaxhimit për privatizimit/ vlerësim për privatizim i paraqesin qëndrimet e veta nga baza. Vendi për këto është mbledhja ku gërshetohen mendimet dhe qëndrimet e ndryshme gjer te procesi përfundimtar dhe i harmonizuar mes anëtarëve. Faza e shtatë (votimi) në kuptim të përgjithshëm nuk paraqet ndonjë fazë të plotë, por më drejt do të ishte të quhet si moment, por me qëllim analize e kemi paraqitur si fazë të pavarur. Siç është e njohur, përmbajtja e votimit paraqet përmbajtjen e kësaj faze në raportin e pjesëmarrjes së punëtorëve në procesin e vendosjes. Realizimi i vendimit, faza e tetë, njihet si fund i njërit dhe fillim i ciklit të ri të vendosjes. Vendimi u jepet për realizim ekzekutorëve qoftë si udhëheqës apo punëtorë të drejtpërdrejtë, parimisht po atyre që atë vendim edhe e kanë përgatitur.

Realizimi i idesë së pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim është proces mjaft i gjatë, i cili është i përcaktuar (determinuar) me zhvillimin e fuqisë prodhuese, marrëdhënieve shoqërore dhe zhvillimin e përgjithshëm. Idetë e para janë paraqitur në gjysmën e parë të shekullit nëntëmbëdhjetë në Angli dhe në Francë. Më vonë gjejnë shprehje shumë ide të tjera që burojnë qoftë nga vendet më të zhvilluara kapitaliste apo nga ato të ashtuquajturat socialiste. Pastaj kemi idetë që burojnë nga vendet në zhvillim e më në fund në këto vitet e fundit (pas viteve tetëdhjetë) kemi idetë nga vendet më të zhvilluara qoftë të Evropës Perëndimore, SHBA-ve apo nga Japonia. Procesi i pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim si proces global mund të ndahet në tri faza:

a) faza e parë, nga vitet 30-te e gjer në ato të 70-te, të shekullit 19-te, b) faza e dytë, nga fundi i shekullit 19-të e gjerë në fillim të shekullit 20-te, përkatësisht gjer në

përfundim të Luftës së Parë Botërore, c) faza e tretë përfshin periudhën mes dy luftërave botërore dhe pas tyre Faza e parë, nga "The Grande National", deri te "Komuna e Parisit", paraqet periudhën e parë të procesit të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim. Lëvizja e parë e madhe e pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim ka qenë lëvizja e plebejve në Angli në ndikim nga Oueni: Në vitin 1834 përafërsisht 500.000 punëtorë iu bashkëngjitën kësaj lëvizjeje ("The Grande National Consolidatëd Trades Uniones"): Në vitin 1871 "Komuna e Parisit" e realizoi për herë të parë pjesëmarrjen e punëtorëve në menaxhim në subjektet ekonomike të asaj kohe: Historikisht kjo paraqet shprehjet më faktike të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim në shekullin e 19-të. Gjatë "Komunës së Parisit" edhe pas saj ka pasur kërkesa të ndryshme të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim dhe këto ishin nga Gjermania, Italia, Austria, Rusia, Anglia etj. Ajo që mund të karakterizojë këtë fazë është: - në këtë periudhë për herë të parë gjeti shprehje realizimi i idesë së pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim - parimi i qeverisjes nga punëtori me punën e vet dhe pushtetin që rezulton nga puna dhe "Komuna" tregoi se cila është rruga më radikale rreth çështjes së çlirimit të punës; kjo mund të realizohej përmes procesit të privatizimit.

Faza e dytë e karakterizon periudha nga vitet e paraluftës së Parë Botërore gjer në ato pas përfundimit të saj. Periudha gjatë Luftës së Parë Botërore ka rëndësi të madhe për trajtimin e procesit të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim, sepse tani kemi "ndryshimet e tetorit" në Rusi. Në këtë kuptim më e rëndësishmja është krijimi i instituteve të kontrollit të punëtorëve në ndërmarrje, edhe pse duhet theksuar se fenomeni i pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim në literaturën sovjetike është mjaft dobët i përpunuar. Arsyet për këtë qëndrojnë, në njërin anë, nga mos hyrja në thellësi të problemeve në nivel të subjekteve ekonomike (Ndërmarrjeve) dhe në anën tjetër nga

vetë praktika që nuk u ka dhënë rëndësi hulumtimeve detale në këtë lëm. Duhet nënvizuar një fakt relevant që buron nga kjo periudhë - konceptimin rreth rolit të sindikatës. Roli i "ndryshimeve të tetorit", i njohur si Revolucioni i Tetorit, ka qenë i madh. Në Gjermani këto ngjarje çështjen e pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim në ndërmarrje ekonomike e sollën në plan të parë. Presioni ishte i tillë sa që në "Kushtetutën e Vajmerit" të vitit 1919 iu pranuan disa të drejta e 128 punëtorëve pjesëmarrje në proceset e privatizimit/ vlerësim për privatizim.

Krijimi (konstituimi) i organeve të tilla dhe të ngjashme u bë edhe në Francë, Angli, Itali, Hungari etj. Ç'është e përbashkët për të gjitha këto ka qenë shprehja e kërkesave gjithnjë e më të mëdha për realizimin e pjesëmarrjes masive në menaxhim.

Greva e madhe në Austri e vitit 1918 është shenjë e krijimit të këshillave të para të punëtorëve në këtë vend. Duke marrë parasysh se këto lëvizje e përfshinë gati tërë Evropën, këto ide i gjejmë edhe në Belgjikë, Finlandë, Danimarkë etj.

Karakteristikat që mund të na japin konkludime konkrete nga kjo fazë janë:

- në raport me fazën tjetër kërkesat për pjesëmarrje të punëtorëve në menaxhim qoftë në nivele të ulëta të ndërmarrjes apo në ato më të larta janë më të pjekura - "Ndryshimet e tetorit" kanë pasur ndikim edhe në vendet e tjera - kjo fazë ka treguar se nuk është fjala për fenomen të rastësishëm, por për ide dhe dukuri që gjithherë mund të jenë aktuale.

Fazën e tretë e përbën periudha midis dy luftërave botërore dhe pas tyre. Në këtë periudhë gjen shprehje dukuria e pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim. Ajo veçanërisht në këtë periudhë merr përmasa edhe më të gjera si në nivel të esencës së vetë procesit ashtu edhe në nivelet e tjera. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore procesi i pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim kishte karakteristika mjaft të

kufizuara, nëse e krahasojmë me periudhën e mëvonshme. U zgjeruan kërkesat jo vetëm në drejtim të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim, por edhe për marrjen e pushtetit dhe ekonomisë së përgjithshme në duart e veta në tërësi.

Në periudhën mes dy luftërave botërore qeverisja më e drejtpërdrejtë u bë në Spanjë, në territorin e lirë të Katatonisë, në të cilin pushtetin e kishin republikanët, punëtorët kanë marrë mbi vete fabrikat dhe kanë organizuar menaxhimin në to. Gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore prapë gjen shprehje fenomeni i pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim nëpër ndërmarrje ekonomike. Menjëherë pas luftës nuk pati kriza të thella ekonomike, pozita materiale e punëtorëve është përmirësuar gjithnjë e më shumë. Organizmat sindikalë dhe politikë kanë marrë rol gjithnjë më të madh në shoqëri etj. Në Britani të Madhe, SHBA dhe Kanada me qëllim të mobilizimit gjithnjë më të dukshëm të prodhimit industrial dhe me iniciativën e shtetit e në bazë të marrëveshjes midis punëdhënësve dhe sindikatave, janë formuar "këshillat prodhues të përbashkët" (Joint Production Committës), të cilët kanë pasur funksione këshillëdhënëse. Në vendet e Evropës Perëndimore u formuan organet e punëtorëve me emërtime të ndryshme e që karakteristike të përbashkët kishin sigurimin e një pjesëmarrjeje gjithnjë e më të madhe të punëtorëve në menaxhim dhe kontroll në ekonomi.

Procesi i pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim pas Luftës së Dytë Botërore më së shumti u zhvillua dhe mori përmbajtje të gjerë në vendet Skandinavie, Angli, Holandë etj. Realizimi i këtij procesi është bërë përmes organeve të përziera (të kombinuara) ndërmjet të punësuarve dhe drejtorive të ndërmarrjeve. Roli i këtyre organeve kryesisht ishte këshillëdhënës dhe veprimtaria e tyre ishte më e zhvilluar në aspektin e kushteve të punës, çështjeve sociale-personale, kulturore, rreth banimit etj.



Format e lartpërmendura të procesit të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim nëpër vendet e Evropës Perëndimore të ish-blokut kapitalist paraqesin në fakt bazat embrionale që në ndërkohë marrin karakteristika të formave zhvilluara në procesin e "participimit" të punëtorëve në menaxhim në ekonomi. Këto forma të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim në momente të ndryshme marrin karakteristika të ndryshme, herë dalin në sipërfaqe me argumentet "për" e herë me ato "kundër" të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim varësisht nga rrethanat ekzistuese shoqërore dhe ekonomike. Fenomeni i pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim nëpër ndërmarrje ekonomike në këto vende bëhet gjithnjë e më aktual, sidomos nga periudha e viteve shtatëdhjetë e këndej, që shënon një epokë të re të zhvillimit të një filozofie humaniste dhe realiste që përshkohet me shumë forma të mbrojtjes së të drejtave njerëzore individuale dhe kolektive, qoftë në nivel të organizmave ekonomike apo më gjerë dhe atë veçanërisht në vendet e Evropës Perëndimore. Mekanizmat e ndryshëm të sigurimit të një pjesëmarrjeje gjithnjë e më të madhe të punëtorëve në menaxhim nëpër ndërmarrje ekonomike sot janë veçori të shpeshta e ndoshta edhe të përhershme për shumë vende të zhvilluara, pa marrë parasysh nga organizimi dhe struktura shoqërore-politike. Zvogëlimi dhe kufizimi i mundësive të potencialeve materiale në vende të ndryshme, e veçanërisht mjaft të zhvilluara sot kanë ngritur aktivitetin dhe i kanë orientuar qëllimet në shfrytëzimin e potencialeve të kuadrove e organizative, qoftë individuale apo kolektive dhe një gjë e tillë sot me mjaft sukses po shfrytëzohet përmes formave stimulative në rritjen e produktivitet të punës përmes pjesëmarrjes gjithnjë e më të madhe të punëtorëve në menaxhim. Në vendet ish-socialiste, të Lindjes, pas Luftës së Dytë Botërore vjen krijimi i shumë formave me sisteme të ashtuquajtura "socialiste-komuniste" (Kozman, 1966: 37-40). Në shumicën e ish-shteteve socialiste (Bullgari,

Çekosllovakia, Poloni, Hungari, RD Gjermanë, Jugosllavi etj.) (Kozman, 1966: 37-40) gjejnë shprehje shumë forma që nga ato të ngjashme (uniforme) e gjer te ato më të ndryshuara të pjesëmarrjes së punëtorëve në qeverisje nëpër subjekte ekonomike.

Gjer në vitin 1950 gati tërë vendet e ish-bllokut socialist sistemin ekonomik e kishin uniform, përkatësisht i adaptuar sistemit të ish-BRSS e me këtë edhe procesi i pjesëmarrjes së punëtorëve në qeverisje gati ishte i njëjtë me atë që ushtrohej në ish-BRSS.

Pjesëmarrja e punëtorëve në menaxhim sot në botë paraqet pasuri mjaft të madhe qoftë të kulturës së përgjithshme qoftë të asaj ekonomike të përshkruar me karakteristika të humanizimit të punës dhe demokratizimit të jetës. Ky fenomen që sot ka marrë karakteristika të dukurisë në proceset ekonomike dhe shoqërore është karakteristikë e vendeve me shkallë të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Është ky proces i cili ka marrë domethënie dhe forma mjaft të ndryshme gjatë historisë së zhvillimit, qoftë si "ndikim i punëtorëve në menaxhim", "pjesëmarrje e punëtorëve në menaxhim" "pjesëmarrje e punëtorëve në vendosje", "këshilldhënie e punëtorëve" për qëllime të ndryshme në nivel të organizmave ekonomik, apo "si menaxhim drejtpërdrejtë" në organizma të ndryshëm ekonomikë për çështje më vitale të shtimit dhe zhvillimit të përgjithshëm.

Derisa forma e parë është rezultat i raporteve ndërmjet forcave të ndryshme socio-politike e pastaj edhe si shprehje e ekonomisë dhe e afarizmit, forma e dytë është më tepër si shprehje cilësore e zhvillimit të forcave prodhuese dhe e marrëdhënieve të cilat i dikton teknologjia e re dhe format e organizimit të ekonomisë dhe shoqërisë. Forma të participimit që paraqiten sot në botën bashkëkohore mund të përmenden: Të ashtuquajturat "quality Circles" (mjediset e cilësisë) që përbëhen nga grupet e

punëtorëve të cilët në mënyrë të pavarur i realizojnë punët dhe detyrat, praktikisht qeverisin në mënyrë të pavarur pjesën e vet të punës dhe afarizmit. Pastaj duhet përmendur fenomeni i ashtuquajtur i sistemeve paralele të menaxhimit për privatizim/vlerësim për privatizim, në të cilat formohen organet paralele të përbëra nga përfaqësuesit e punëmarrësve (punëtorëve). Si forma të menaxhimit për privatizim/vlerësim për privatizim participativ paraqiten edhe: QWL ("quality of work") - cilësia e marrëdhënieve të punës; EI ("Employers Involvement") - pjesëmarrja e të punësuarve etj. Participimi dhe pjesëmarrja e punëtorëve në proceset afaristo-ekonomike qoftë si proces institucional qoftë spontan po gjen fushëveprim sot jo vetëm në vendet më të zhvilluara që bazohen në ekonominë e tregut, por edhe në ish-vendet e Lindjes, vendet në zhvillim etj. I tërë ky proces po bëhet me qëllim të lehtësimit të kundërtësimeve mes forcave antagoniste në shoqëritë bashkëkohore qoftë në nivel të subjekteve ekonomike qoftë shoqërore.

**Roli i shtetit;** Klasa udhëheqëse (në pushtet) interes themelor ka sigurimin e sistemit shoqëror-ekonomik ekzistues, interes ky që, qëndron shumë më lart sesa ato që burojnë nga ai material apo të ngjashëm. Në këtë aspekt ajo gjithëherë dhe në mënyrë permanente vepron në atë mënyrë që interesat e veta i harmonizon me interesat politike dhe qëllimet e shtetit. Nga kjo dhe shumë arsye të tjera del pohimi se nuk ekziston kurrfarë ndarje e shtetit nga qendrat e fillimit apo interesat e profitit të firmave me kapital. Me plot të drejtë mund të themi se shteti i ndihmon ato.

Pjesa më aktive dhe udhëheqëse e shoqërisë ku mbretëron kapitali, që njihen si ndërmarrës, aksionarë, bankierë, menaxherë apo funksionare të tjerë të kapitalit, aktivisht veprojnë në atë mënyrë që interesat e tyre i inkorporojnë në interesat politike,

detyrat dhe qëllimet e shtetit, ashtu që në këtë mënyrë politika e shtetit t'i realizojë interesat e kapitalit. Duke u mbështetur në lidhshmërinë e interesave të fitimit - kapitalit me interesin e shtetit, në atë kuptim që duke u inkorporuar interesat politike në ato të kapitalit dhe e kundërta, rezulton se shteti është ai që e ndihmon realizimin e interesave të këtyre qendrave të profitit. Roli i shtetit në format dhe proceset participative është i ndryshëm, varësisht nga organizimi i shoqëror dhe politik i tij. Shteti autoritar dhe me pushtet të centralizuar e forcon dhe e zhvillon udhëheqjen dhe qeverisjen autoritare në subjektet ekonomike. Me këtë krijuan kushte dhe bën presion në ngushtimin e proceseve dhe formave të ndryshme të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim. Ndërkaq, shteti demokratik që mbështetet në parimet demokratike dhe në format e ndryshme të realizimit të të drejtave që burojnë nga individi dhe puna e tij, krijon kushte dhe rrethana për zgjerimin e formave të ndikimit dhe pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim, duke formuar nga ato më të ulëta në formë të pjesëmarrjes në këshillime të përbashkëta e tjerë të bashkëvendosja për çështjet e rëndësishme në subjektet ekonomike. Bashkëpunimi reciprok i shtetit me kapitalin, përkatësisht i "qendrave të pushtetit" me "qendrat e profitit" është realitet, por edhe arsyeshmëri e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror që erdhi si rezultat i bashkëveprimit midis sistemit shoqëror me sistemin ekonomik. Prandaj, edhe ndikimi i rolit të shtetit, qoftë në kohën e afirmimit të formave të ndryshme të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim, qoftë në krahën e ngushtimit të këtyre formave dhe proceseve, e ka karakterin e përcaktuesit mjaft të rëndësishëm shoqëror-ekonomik. Demokracia në realitet është vetëm parim i rregullimit të shtetit (e jo i shoqërisë), kurse participimi dhe format e tjera të paraqitjes së tij, në njërin anë shprehin barrikadën apo pengesën e rendit të lirë demokratik të shtetit, kurse

në anën tjetër pa dyshim shprehin pjesën përbërëse të këtij rendi që inkorporohet në normat e rregullimit dhe ruajtjes së sistemit ekzistues shoqëror.

Nga historia e sistemeve politike mund të mësojmë se format e participimit të punëtorëve në menaxhim janë zhvilluar kryesisht në varësi nga ideologjia dhe programi i partive politike udhëheqëse. Në masë të caktuar janë ndikuar edhe nga orientimet politike dhe shoqërore të partive të tjera me orientim social-demokratik, përkatësisht nga organizmat Në kushtet dhe rrethanat e caktuara nëpër vende të ndryshme kemi sisteme të ndryshme politike. Në shumicën e shteteve të zhvilluara, apo të atyre më pak të zhvilluara po dominojnë (udhëheqin), përkatësisht janë në pushtet partitë politike të qendrës së djathtë. Shtrohet pyetja, sa ndikojnë këto parti sot në zhvillimin e proceseve participative në këto vende? Edhe pse në pushtet mund të jenë partitë e djathta, sot kur në kushtet e zhvillimit të demokratizmit të jetës dhe punës, kur teknika dhe teknologjia bashkëkohore e kanë ndërruar mënyrën e jetesës, proceset participative nuk do të mungojnë, jo për ndonjë arsye të zhvillimit të ndonjë programi apo projekti social, por për shkak të mirëqënies dhe ngritjes së standardit të faktorit vendimtar, për krijimin e fitimit- faktorit njeri. Këtu luan rol të rëndësishëm edhe qasja bashkëkohore e të menduarit, se nuk mund të dallohen esencialisht interesat e punëtorëve nga interesi i kapitalit apo bartësit e këtij kapitali. Roli i ndryshëm i partive politike në proceset participative të ndikimit të partnerëve të ndryshëm në menaxhim shihet veçanërisht në sistemet pluraliste politike. Shkalla e institucionalizimit të formave të ndryshme të pjesëmarrjes në menaxhim është e lidhur ngushtë me programet sociale-ekonomike të partive në, pushtet si dhe realizimet e tyre. Nga praktika evropiane del se partitë me orientime socialdemokratike në programet e veta e kanë të përpunuar në mënyrë

relativisht të plotë çështjen rreth (Sharman - Zhuwaj, 1988: 20) proceseve të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim. Këto parti, qoftë me këtë emër apo më emërtime të tjera e që kanë programe të zhvilluara sociale dhe demokratike dhe atë qoftë si parti ne pushtet apo në opozitë, kanë pasur ndikim relativisht të lartë në përcaktimin institucional të pozitës së punëtorëve në menaxhim të ndërmarrjeve ekonomike. Për këtë tregon më së miri shembulli i Gjermanisë, Francës, Italisë, vendeve skandinave etj. Vlen të theksohet se edhe partitë me orientime qoftë të djathta konservative apo të majta socialiste-komuniste, në njëfarë mënyre, më pak apo më shumë, kanë ndikuar në realizimin institucional të formave të ndryshme qoftë të ndikimit apo të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim nëpër subjektet ekonomike. Përvoja shumëvjeçare e zhvillimit të vendeve të ndryshme që kanë pasur sisteme të ndryshme shoqërore-ekonomike ka treguar se roli i partive politike si përcaktues shoqërore-ekonomik i procesit të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim shihet në realizimin e përcaktimit institucional dhe praktik të formave dhe proceseve të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim e aseteve në ideologjizimin e tepruar teorik që vjen nga fetishizimi i kapitalit apo i punës. Roli i partive politike, përkatësisht pozita e tyre në pushtet, është faktor që determinon jo vetëm format participative apo pjesëmarrëse në strukturat organizative, por njëkohësisht edhe e orienton zhvillimin e parametrave kryesorë të ekonomisë kombëtare të një vendi.

**Roli i sindikatës;** Gjatë historisë, konflikti ndërmjet pronarëve të kapitalit, si shfrytëzues të rezultateve të punës dhe punëmarrësve (punëtorëve) si krijues - prodhues të vlerave, janë zhvilluar institucione të ndryshme sindikale. Formimi i sindikatës është bërë me qëllim që me ndihmën e marrëveshjeve kolektive, nëse ka nevojë edhe përmes

grevës, të ndikojnë apo të realizohen kërkesat sociale, ekonomike, profesionale, madje edhe politike të punëtorëve në raport me punëdhënësit apo me shtetin. Roli i sindikatës për realizimin e të drejtave të punëtorëve në lëmin e ekonomisë daton qysh nga kohët më të hershme. Sot është një ndër determinuesit themelorë shoqërorë - ekonomikë për proceset participative, qoftë në nivel të njësive organizative më të ulëta (oficina, fabrika etj) e gjer te dega apo ekonomia kombëtare. Organizimi bashkëkohor i sindikatës është rezultat jo vetëm i ndryshimeve strukturale shoqërore - ekonomike, por edhe i ndërrimeve më të reja në organizimin e punës, teknikën e teknologjinë etj. Raporti i forcave ndërmjet përfaqësuesve të punëdhënësve, në njërën anë, dhe punëmarrësve, në anën tjetër, mund të harmonizohet apo t'iu shmanget relativisht shumë konflikteve vetëm në sajë të organizimit sindikal - marrëveshjeve kolektive, sindikale. Edhe shteti bashkëkohor është i interesuar të zhvillojë institucionin e sindikatës për arsye të rregullimit të marrëdhënieve të brendshme, përkatësisht më e arsyeshme është për shtetin njohja e kundërshtarit apo e palës në konflikt (siç është rasti me punëmarrësit) sesa ndonjë formë e rebelimit apo e kryengritjes që mund t'i ndodhë si fenomen i paparashikuar.

#### *2.1.4. e Proceset koncentrimit centralizimit dhe internacionalizimit të kapitalit si metode e ndërmjetme privatizimi.*

Karakteristikë e zhvillimit ekonomik dhe organizativ, qoftë në nivel kombëtar qoftë ndërkombëtar, pa dyshim se është edhe procesi i forcimit të pushtetit të monopoleve, prej të cilave më efikase konsiderohen dhe centralizimi i kapitalit në planin global nacional dhe ndërnacional. Në literaturë mund të gjejmë shënime të mjaftueshme të trendeve të zhvillimit të këtyre proceseve, por meqë janë procese shumë

të shpejta dhe të dhëna aktuale nuk mund të paraqiten. Internacionalizimi i kapitalit, përkatësisht shtrirja jashtë kufijve shtetërorë të kapitalit sot është vetëm plotësim i këtyre tendencave të koncentrimit dhe centralizimit. Shembull më i mirë për këtë sot mund të përmendet formimi i qendrave të zotësisë dhe fitimit në nivel ndërkombëtar. Shkalla e lartë e monopolizimit, duopolizimit apo e oligopoleve sot është proces mjaft aktual në fushën e industrisë. Në këtë mënyrë, kapitali shumëfishohet me rriten e numrit të ndërmarrjeve. Zvogëlohen mundësitë e konkurrencës, kurse instrumentet ekonomiko-politike të shtetit janë të pa forcë që të ndikojnë. Krijohen kushte për forma të reja të qeverisjes me kapital, me këtë edhe format organizative si truste, apo ndërmarrje gjigante në formë të kompanive kombëtare të cilat njëkohësisht mbesin edhe forma kryesore vendosëse dhe qendra të zotësisë për shumë procese të qeverisjes. Edhe shpërndarja e fitimit merr karakter tjetër si dhe mjetet e informacionit publik bëhen pjesë të këtyre qendrave vendosëse. Këto forma organizative me karakter kombëtar apo ndërkombëtar kanë edhe ndikim mjaft të madh në zhvillimin e veprimtarisë sindikale dhe sistemin politik të shtetit - shteteve. Problemi qëndron në faktin se nuk i marrin në konsiderim normat dhe rregullat e interesit kombëtar shtetëror dhe me këtë ua marrin punëtorëve të drejtën e organizimit sindikal dhe të politikës së tarifave të caktuara. Këto procese përmbajne në vete edhe rrezikun e realizimit të procesit të ndikimit të punëtorëve në menaxhim. Të drejtat për vendosje kryesisht janë të lidhura me personat juridikë, prandaj sa më e madhe të jetë ndërmarrja - subjekti aq më të mëdha do të jenë formalitetet në vendosje. Prandaj, parë realisht kjo paraqet edhe zvogëlimin e rolit të punëtorit në procesin e vendosjes. Duke marrë në konsiderim faktin se këto janë procese që nuk mund t'i ndalë punëtori, procese që dalin nga zhvillimi objektiv i kapitalit dhe i tregut të lirë, atëherë mbetet vetëm t'i konsiderojmë si përcaktues - determinues të



zhvillimit ku patjetër duhet t'iu përshtatemi dhe të gjejmë forma adekuate të pjesëmarrjes në to, si forma të cilat do t'u përgjigjen formave organizative mjaft të mëdha dhe normave ndërkombëtare të realizimit të të drejtave të njerëzve apo punëtorëve për pjesëmarrje në menaxhim.

*-Disa qasje bashkëkohore të procesit të pjesëmarrjes në menaxhim:*

Problemi i menaxhimit për privatizim/ vlerësim për privatizim gjithnjë e më tepër po i preokupon kërkuesit shkencorë të lëmeve të ndryshme, duke filluar nga organizatorët, politologët, psikologët e deri te ata të shkencave teknike. Ky fenomen sot është aktual, jo vetëm në pjesën e botës së zhvilluar, por edhe te ata në zhvillim, si dhe në vendet me sisteme të ndryshme shoqërore. Hulumtimi i procesit të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim në ndërmarrje ekonomike sot është çështje praktike e cila nuk mund të shtyhet për një kohë më të vonshme. Veçanërisht duke i marrë parasysh kushtet në të cilat zhvillohet apo transformohet, ky proces kërkon medoemos zgjidhje përkatëse. Pjesëmarrja e punëtorëve në menaxhim në shumicën e vendeve të zhvilluara nuk është rastësi. Kjo është domosdoshmëri historike, apo siç thotë shkencëtari i njohur Jean De Bengy: "shqyrtimi i idesë së tillë në kohën tonë nuk është rezultat i rastësisë historike, por i vetë historisë". Zhvillimi dhe demokratizimi në vendet e Evropës Perëndimore, në SHBA, në Japoni etj. Gjithnjë e më shumë po i afirmon format e ndryshme të participimit e pjesëmarrjes së punëtorëve (si punëmarrës) në menaxhimin për privatizim/ vlerësim për privatizim. Ky sot interpretohet në forma dhe kuptime të ndryshme dhe praktikisht zbatohet në këto vende po ashtu në forma të ndryshme: Zhvillimi dhe demokratizimi në vendet e Evropës Perëndimore, në SHBA, në Japoni etj, gjithnjë e më shumë po i afirmon format e ndryshme të participimit së institute të

pjesëmarrjes së punëtorëve (si punëmarrës) në menaxhim. Ky fenomen sot interpretohet në forma dhe kuptime të ndryshme dhe praktikisht zbatohet në këto vende po ashtu në forma të ndryshme. Ekonomia e cila bazohet në pronën private sot nuk është ajo që ishte në kohën e akumulimit të kapitalit, por as ajo që ishte para Luftës së dytë Botërore dhe menjëherë pas saj.

Derisa punëtorët si punëmarrës nuk janë të kënaqur vetëm me ndryshime pozitive cilësore në dobi të tyre siç janë programet e ndryshme sociale dhe kushtet e tjera jetësore, ata gjithnjë e më tepër paraqesin kërkesa të natyrës cilësore e bien në sy sidomos ato në lidhje me pjesëmarrjen në menaxhim, qoftë në nivel të ndërmarrjes qoftë të ekonomisë kombëtare. Këto kërkesa sot janë gjithnjë e më shumë evidente jo vetëm në këto vende të zhvilluara.

Nuk është fjala këtu për kurrfarë pronësie shoqërore, për pjesëmarrje gjithnjë e më tepër në kapitalin e përgjithshëm të ashtuquajtura të botës së tretë. Këto aktualizohen veçanërisht atëherë kur kemi organizim të lirë sindikal të punëtorëve - si punëmarrës. Organizimi sindikal sot është komponent mjaft i rëndësishëm në vendet e Evropës Perëndimore, ku kemi sindikata mjaft të forta nëpërmjet të cilave punëtorët realizojnë ndikim mjaft të madh në punë dhe në menaxhim dhe atë ose përmes marrëveshjeve kolektive ose përmes grevave. Kërkesat cilësore të punëtorëve në vendet e ndryshme janë kulminuar sidomos kah fundi i dekadës së fundit. Kundërthëniet e ndryshme në nivel të ndërmarrjes kanë karakteristika të konfliktit për kërkesa në vendosje, përkatësisht në luftën për të drejtën në kontrollin e ndërmarrjes nga ana e punëmarrësve - punëtorëve. Këto ndodhin kryesisht në Evropë e veçanërisht në Gjermani, Itali, Francë, vendet Skandinave dhe në vende të tjera me zhvillim relativisht të lartë. Në SHBA kundërthëniet e natyrës së pjesëmarrjes në menaxhim apo në kontroll të

ndërmarrjeve, për ndryshim nga Evropa burojnë kryesisht jashtë organizatave sindikale ndaj për këtë edhe suksesi, përkatësisht rezultati i aksioneve të ishte relativisht më i vogli. Sipas shumë autorëve, punëtorët në vendet e zhvilluara nuk janë shumë të depolitizuar. Me këtë edhe demontohen disa teori sipas të cilave në kushtet e zhvillimit të lartë ekonomik, siç është shembulli i vendeve të Evropës Perëndimore, vjen te depolitizimi i punëtorëve si rezultat apo pasojë e ngritjes së kushteve të jetesës - standard të tyre. Teza mbi depolitizimin dhe deradikalizimin e punëtorëve nuk ka pohim praktik, sepse kemi mjaft shembuj që edhe sot trajtojnë padëgjueshmërinë e punëtorëve ndaj strukturave udhëheqëse në ndërmarrje (Z. Vidakovig, David Plotke, 1977: 195, Vidakovië, Kritika, 1974: 7), po vërehet tendenca të shtimit nevojës dhe kërkesave për pjesëmarrje të punëtorëve në menaxhim mbi kushtet e punës dhe në sipërmarrjen e rezultateve të punës. Paraqitja e teorive neoklasike mbi organizimin në Perëndim (Elton Mayo) dhe shkolla drejtimi i marrëdhënieve ndërnjerëzore "Human Relations", kanë paralajmëruar ndryshime në sjelljen e ndërmarrësve-kapitalistëve ndaj punëmarrësve (punëtorëve). Kjo ka ardhur në shprehje edhe më shumë me paraqitjen e teorisë mbi organizimin e aftësive njerëzore, përkatësisht "Human Resources". Në qëndrimet e punëtorëve si dhe në kërkesat gjithnjë e më të theksuara të tyre për ndryshime cilësore që shprehen sot në tendencat bashkëkohore të pjesëmarrjes në menaxhim apo kontroll në ndërmarrje, relativisht shumë kanë ndikuar këto procese bashkëkohore: a) Koncentrimi, centralizimi dhe internacionalizimi gjithnjë e më i madh i prodhimit dhe kapitalit, përkatësisht paraqitja e ndërmarrjeve gjigante dhe kompanive nacionale e multinacionale; b) Zhvillimi gjithnjë e më i shpejtë i shkencës, teknikës, teknologjisë dhe i automatizimit ose "boomi shkencor-teknologjik", c) Çlirimi i një numri të madh shtetesh nga kolonializmi dhe procese të ngjashme të okupimit; d) Kriza ekologjike dhe

problemet e ndryshme që burojnë nga kjo fushë dhe që medoemos paraqitën nevojën për ndryshime në sjelljet e subjekteve ekonomike në vendet e zhvilluara; e) Arsimimi gjithnjë e më i madh dhe emancipimi i punëtorëve si punëmarrës dhe transformimet në fushën e pronësisë nga ajo individuale, shtetërore, shoqërore, private e me këtë transformimi edhe në sferën e menaxhimit për privatizim/ vlerësim për privatizim.

Pjesëmarrja ndikimi i punëtorëve në menaxhim për privatizim/vlerësim për privatizim, i ashtuquajtur i procesi i participimit të punëtorëve në menaxhim për privatizim/ vlerësim për privatizim, njihet si fenomen i kohës bashkëkohore. Gjithkund në botë njeriu dëshiron progres dhe participim; Po dalin në sipërfaqe shumë institucione alternative në nivel të ndërmarrjes apo shoqërisë; Po bëhen shumë eksperimente të reja në procesin e menaxhimit; Po bëhen hulumtime të kësaj dukurie në jetën e përditshme reale etj.

Edhe pse dihet se participimi mund të zgjerojë shumë probleme të trashëguara nga sistemi i marrëdhënieve industriale ka pak gjasa për ndonjë argument të qëndrueshëm mbi ndikimin e participimit në rritjen e produktivitetit. Mirëpo, nga ana tjetër ka mjaft argumente se me këtë proces zvogëlohet tjetërsimi ndaj punës dhe pasojat nga hierarkia e ashpër e njohur nga organizimi burokratik tradicional, që në instancën e fundit ka ndikim pozitiv në efikasitet apo efektivitet të subjektin ekonomik.

Të pranosh participimin si tërësi mjetesh apo metodash me të cilat punëtorët disponojnë me qëllim që të ndikojnë në vendimet që merren (aprovohen) në ndërmarrjen ku punojnë, do të thotë se është fenomen, i cili mund të zgjidhë relativisht shumë probleme në marrëdhëniet mes punëdhënësve dhe punëmarrësve .

Një komision i BIT-it, “Bureau International du Travail”, në vitin 1967 ka pohuar se është mjaft vështirë të definohet koncepti i participimit në atë mënyrë që të jetë i kuptuar për të gjithë në mënyrë unike. Anëtarët e komisionit të përbërë nga përfaqësues te punëdhënësve, sindikatës, qeverisë dhe të universitetit janë pajtuar me faktin se koncepti i participimit më së tepërmi përdoret në kontekst të participimit të punëtorëve në menaxhim (në nivel të ndërmarrjes, për ndryshim nga pjesëmarrja në vendosje në shoqëri - komunë apo shtet). Po ashtu shumë autorë të cilët janë marrë me problemin e participimit e pranojnë participimin si proces të ndikimit apo pjesëmarrjes së punëtorëve në përgatitjen, aprovimin dhe kontrollin e realizimit të vendimit të marrë në nivel të ndërmarrjes dhe që ka të bëjë me probleme të natyrave të ndryshme (pagat, kushtet e punës, mbrojtja në punë, sigurimi, disiplina, punësimi, arsimimi profesional), Participimi është shprehja më e shpeshtë për të gjitha format e bashkëpjesëmarrjes së punëtorëve në vendosje. Krahas këtij koncepti në literaturë gjejmë edhe shprehje të tjera më së shpeshti si “demokraci ekonomike” (e ka kuptimin e ndikimit të punëtorëve në vendime të cilat kanë karakter ekonomik); “demokraci industriale” (e ka kuptimin e marrëdhënieve demokratike në ndërmarrje); “bashkëvendosje” (e ka kuptimin e pjesëmarrjes së barabartë të punëtorëve në menaxhim); “participimi financiar” (e ka kuptimin e bashkëpronësisë me punëtorët në ndërmarrje në të cilën punojnë); “participimi teknologjik” (e ka kuptimin e ndikimit të punëtorëve në zgjedhjen teknologjike); “participimi në vendin e punës” (e ka kuptimin e ndikimit të punëtorit në kushtet e punës në vendin e punës); “participimi në ndërmarrje” (e ka kuptimin e ndikimit të punëtorëve në vendosje në nivel të ndërmarrjes); “participimi vertikal” (ka të bëjë me demokratizimin e udhëheqjes); “kontrolli i punëtorëve” (e ka kuptimin e bashkëvendosjes apo këshilldhënies) etj.

I definuar në këtë mënyrë participimi në njërën anë ngushtoi kuptimin e këtij koncepti vetëm në suaza të organizatës ekonomike, kurse në anën tjetër lejon mundësi të bëhet ndonjë krahasim mes asaj që është formale dhe ndikimit (pjesëmarrjes) të vërtetë të punëtorëve në aprovim të vendimeve.

Format më të zhvilluara të procesit të ndikimit të punëtorëve në menaxhim, qoftë përmes fenomenit të participimit qoftë të ndonjë forme tjetër, pa dyshim se ekzistojnë sot në vendet e Evropës Perëndimore, përkatësisht në vendet tradicionale të zhvillimit të kësaj pjese të Evropës. Këtu mund t'i përmendim Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Italinë, Francën, Suedinë etj. Evropën Perëndimore që nga viti 1970 e karakterizon fenomeni i shpërthimit të proceseve participative. Këto procese përmbajnë më shumë apo më pak demokraci, por është e përbashkët se në to ekzistojnë institucione të caktuara me ndihmën e të cilave të punësuarit drejtpërdrejt apo përmes përfaqësuesve - besueshmëve, marrin pjesë në proceset e vendosjes. Në këtë mënyrë punëtorët qeverisin, përkatësisht marrin pjesë - ndikojnë apo participojnë në marrjen (aprovimin) të vendimeve.

Duke u nisur nga klasifikimi i formave të institucional-vizuara të pjesëmarrjes së të punësuarve në menaxhim në ndërmarrje në nivel botëror<sup>50</sup>, në vendet e Evropës Perëndimore ekzistojnë të rregulluara normativisht disa forma themelore:

a) Pjesëmarrja nëpërmjet organeve këshillëdhënëse në nivel të oficinës apo njërive të tjera ekonomiko-prodhuese .

b) Nëpërmjet organeve mbikëqyrëse në nivel të ndërmarrjes dhe

c) Nëpërmjet sindikatës në përmbajtje të kontratës kolektive.

Numri, struktura, emërtimi, zgjedhja e anëtarëve, zgjatja e mandatit, fusha e ndikimit dhe elementet e tjera të rëndësishme të organeve këshillëdhënëse në nivel të

oficinës apo njësisë ekonomiko-organizative (p.sh. këshilli i oficinës, komiteti, këshilli i fabrikës, komisioni i përbashkët këshilldhënës etj.) me ligj janë të rregulluara në mënyra të ndryshme, në vende të ndryshme.

Në vendosjen për nivelin e pagave dhe të përfitimeve të tjera personale, si dhe për kushtet e punës, fitimin (intensitetin) e punës dhe format e tjera të punës, çështjet rreth banimit etj. Punëtorët ndikojnë apo marrin pjesë përmes sindikatës, në përmbajtje të marrëveshjeve dhe kontratave kolektive të cilat i bëjnë (lidhin) sindikata dhe punëdhënësit në nivel të ndërmarrjes, oficinës apo në nivel të ndonjë dege. Rregullativa e zakonshme vjen për një vit dhe paraqet të drejtën e obligueshme të partnerëve në marrëveshje, që për atë periudhë nuk mund të sjellin norma të reja më të vështira për punëtorët për të cilët vjen kontrata kolektive.

Sipas disa mendimeve dhe praktikës nga përvoja e këtyre viteve të fundit (pas vitit 1990), në Evropën Perëndimore në kuptim të procesit të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim (participimit) ekzistojnë ndryshime mjaft qenësore. Britania e Madhe me demokraci industriale, unike dhe të aprovuar vetëm nga kjo vetë, Franca dhe Italia me modelin e veçantë të kundërshtive ndërmjet shtresave dhe grupeve të tjera sociale, Gjermania me modelin e vet “integruar” të participimit të njohur si shembull tipik.

Padyshim, shumica e vendeve të Evropës Perëndimore në konceptimet e tyre më të hershme të procesit të pjesëmarrjes së punëtorëve në menaxhim kryesisht bazoheshin në modelin e ish-Gjermanisë Perëndimore. Por ka edhe vende të cilat nuk e kanë këtë mbështetje (Belgjika, Italia, Suedia etj). Pa marrë parasysh dallimet, sot vërehet një trend i ri në industrinë e Evropës Perëndimore. Respektimi i rëndësisë së faktorit njeri, si dhe punëtorit në kuptimin e punëmarrësit paraqet element dominant në këto trende.

## **2.2. Ideologjia e privatizimit në Evropën qendrore (që nga vitit 1989)**

Në kohën kur shteti hungarez i hapi kufijtë e tij shtetit austriak në shtator të vitit 1989, kjo ndikoi në mënyrën më efektive në fundin e dominimit të Bashkimit Sovjetik në Evropën qendrore dhe që në atë kohë filluan iniciativa dhe aktivitete për bashkimin e Gjermanisë demokratike me atë komuniste. Hungaria edhe para kalimit nga sistemi post-komunist, pati filluar të lejojë që të bëhen disa investime të huaja direkte (IJD) në vendin e tyre. Shteti hungarez pati rritje të bruto prodhimit shoqëror (në tekstin e mëtejshëm GDP), nga 5% në 50%, për 4 vite me radhë që nga vitit 1989. Po ashtu edhe Republika Çeke pati rritje të GDP në 47% në vitin 2007 (EBRD, 2008). Po ashtu edhe në shtetin e Polonisë, sektori privat ose gjenerimet që i binte ky sektor, përbënin 30% të GDP-së qysh në vitin 1993. Procesi i privatizimit filloi të tejkalohet dhe të realizohet edhe në shumë vende të tjera, si, p.sh., në Ukrainë sektori privat gjeneronte 50% të GDP-së, etj.

Të dhënat që do të shfrytëzohen për mënyrën se si bizneset e vogla dhe ato me rëndësi më të fuqishme gjeneruese, do të shfrytëzohen nga të dhënat e siguruar nga Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim (EBRD). Kryesisht këto të dhëna, përfshijnë procesin e privatizimit që është bërë që nga viti 1989 – 2008. Janë 9 shtete që kryesisht i takojnë pjesës së Evropës lindore dhe jug-lindore, mirëpo në mesin e tyre përfshihen edhe disa shtete të Evropës qendrore: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e zi, Serbinë, Kosovën, Kroacinë, Maqedoninë, Hungarinë, Bullgarinë dhe Republikën Çeke.



Po fillojmë me Republikën e Shqipërisë kur në vitin 1991 në pushtet ishte një parti me natyrë konservatore - nacionaliste dhe popullore. Por ky problem nuk ishte prezent vetëm në Shqipëri, por pothuajse edhe në vendet e tjera të Evropës lindore dhe juglindore, si p.sh. Kroacia që udhëhiqej nga një lider nacionalist. Ndërsa në vendet e tjera, sidomos të RSFJ-së, kishin filluar konfliktet dhe luftërat e përgjakshme, në veçanti në Bosnjë dhe Hercegovinë, vendet si Sllovenia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i zi, Kroacia, filluan fazën e tranzicionit, e në veçanti atij ekonomik më vonë sesa vendet e Evropës qendrore. Në vijim do i paraqesim në formën tabelore se në çfarë periudhash dhe rrethanash kohore ka filluar tranzicioni, e në veçanti duke i konsideruar dhe marrë parasysh disa variabla të cilat do i paraqesim në tabelën si në vijim:

**Tabela 2. Datat e shkëputjes nga sistemi post-komunist**

| <i>Vendi</i>                           | <i>Data/Viti</i>             | <i>Luftë civile</i>      |
|----------------------------------------|------------------------------|--------------------------|
| <b>Shqipëria</b>                       | mars, 1991                   | -                        |
| <b>Kroacia</b>                         | qershor, 1991 (nga ish-RSFJ) | mars 1992 – nëntor 1995  |
| <b>Mali i zi</b>                       | qershor, 2006 (nga Serbia)   | -                        |
| <b>Sllovenia</b>                       | qershor, 1991 (nga ish RSFJ) | 10 ditë                  |
| <b>Maqedonia</b>                       | shtator 1991 (nga ish RSFJ)  | -                        |
| <b>Republika Çeke</b>                  | dhjetor, 1989                | -                        |
| <b>Republika e Kosovës<sup>3</sup></b> | qershor, 1999                | mars 1998 – qershor 1999 |

Burimi : Literatura

**Ndërmarrjet publike, roli dhe sfidat e tyre në zhvillimin e vendit;** Numri i ndërmarrjeve në pronësi të shtetit ose siç quhen ndryshe edhe ndërmarrje publike (**NP**), u rrit dukshëm duke filluar nga vitet ‘ 30-të, por veçanërisht pas Luftës së dytë botërore si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në vendet në zhvillim. Synimi ishte i shumëfishtë :

- kapërcimi i problemeve të dala nga deficitet e tregut dhe mungesat në kapital

<sup>3</sup>Republika e Kosovës është shpallur nga Kuvendi i Kosovës me 17 Shkurt 2008 , por ende nuk është anëtare e OKB-së edhe pse gjerë në këtë moment numëron plot 108 njohje nga 108 vende të pavarura të botës (01. 12. 2014).

- nxitja e rritjes ekonomike
- reduktimi i papunësisë masive si dhe:
- sigurimi i kontrollit kombëtar mbi drejtimin e përgjithshëm të ekonomisë, veçanërisht në vendet në zhvillim.

Duke ofruar kapital dhe teknologji në fusha strategjike ku sektori privat ose nuk futej ose i mungonte kapitali i nevojshëm për të investuar ( si në industrinë e rëndë apo infrastrukturë) shumica e qeverive shpresonin që me anën e NP-ve të rritnin formimin e kapitalit, të prodhonin mallra të domosdoshme me kosto të ulët, të rrisnin numrin e vendeve të punës dhe të kontribuonin ndjeshëm në zhvillimin e vendit. Kjo tendencë vazhdoi deri në fillimin e viteve 80-të.

Por një sërë dukurish negative si rritja e korrupsionit, inefficienca në menaxhim, tejmbushja e ndërmarrjeve me staf, inflacioni dhe rritja e deficitit buxhetor, bëri që në vitet '80-të të ekspozonin dështime masive të qeverive dhe kufizimin e rolit të përcaktuar më parë për ndërmarrjet publike si aktorë kryesor në zhvillimin ekonomik. Pavarësisht nga këto dhe nga reduktimi që i është bërë numrit dhe peshës së ndërmarrjeve publike me anën e procesit të privatizimit ( i cili arriti kulmin në vendet në zhvillim në vitin 1997 dhe megjithëse ngelet në një nivel të ulët në përgjithësi, prapë procesi i privatizimit ka filluar rritjen e tij graduale), përsëri **NP**-të vazhdojnë të kenë një prezencë të rëndësishme në shumë vende, të jenë ofruesit më të mëdhenj të një sërë shërbimesh sociale si dhe gjenerues të një numri të konsiderueshëm vendesh pune.

Nëse do t'ju referoheshim shifrave, do të dukej qartë se në vendet me *të ardhura më të larta*, pesha e ndërmarrjeve të këtij lloji në PPB dhe investime përbën respektivisht **8%** dhe **13%**. Për vendet me *të ardhura mesatare* këto shifra janë **9%** dhe

**17%**, ndërsa në *vendet më pak të zhvilluara* (Least Developed Countries) ato janë **14%** dhe **28%**.

Këto ndërmarrje përbëjnë një burim të rëndësishëm të të ardhurave të qeverive në shumë vende në zhvillim (si p.sh, në Kinë 7%, Turqi 6%, Liban 17%, Siri 24% dhe duke arritur pikën më të lartë në Algjeri me 60.5, ndërsa në vendet e Evropës Lindore luhetet në kufijtë mesatarë nga 3 – 5 %) dhe nga pikëpamja e punësimit, një përqindje të ndjeshme të totalit të zënë me punë. (në Kinë rreth 7.4% dhe në Indi 8.1%). Ndërsa të dhëna më të detajuara për **NP**-të, në disa vende të botës jepen në Tabelën 3.

**Tabela 3. Të dhëna mbi rëndësinë e Np-ve në ekonominë kombëtare**

| <b>Vendet</b> | <b>Numri i NP-ve</b>                                              | <b>Pesha në ekonomi</b>                                      |
|---------------|-------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|
| Suedia        | 59 duke përfshirë edhe 15 ndërmarrje ku shteti është bashkëpronar | Të punësuar 200 000 njerëz dhe vlerësohen 350-410 mld korona |
| Zelanda Re    | 30                                                                | Vlera neto 9.8 mld \$ zelandeze japin 10% të PPB             |
| Franca        | 1500                                                              | Vlerësohen më shumë se 150 mld EUR                           |
| Anglia        | 26                                                                | Rreth 20 mld paund                                           |
| Kanada        | 43 (në nivel federal)                                             | Asete 77 mld kanadeze të punësuar 72 mijë njerëz             |
| Singapori     | 22                                                                | 20% e PPB, vlerësohen rreth 90 mld \$                        |
| Shqipëria     |                                                                   | Të punësuar 188 965                                          |

Burimi: Literatura

Qeveritë e kanë konsideruar dhe e kanë pozicionuar reformimin e sektorit publik në përgjithësi dhe rritjen e performancës së ndërmarrjeve publike në veçanti, si një moment të rëndësishëm dhe i kanë dhënë një vend të dukshëm në kuadrin e programeve qeveritare, sidomos në prag fushatash elektorale. Por pavarësisht nga përpjekjet e qeverive dhe nga programet e tyre për përmirësime radikale e shpresëdhënëse, praktika ka treguar se performanca e këtij sektori dhe veçanërisht e kompanive shtetërore është e dobët dhe nuk mund të krahasohet me sektorin privat. Reformat e zbatuara jo vetëm në shtetet e ekonomive në tranzicion, kanë qenë përgjithësisht joefektive në drejtim të sigurimit të një performace më të mirë dhe sidomos në kuadër afatgjatë në këtë sektor

sepse nuk i janë adresuar si duhet problemeve themelore të qeverisjes së ndërmarrjeve publike. (Sh Llaci: Qeverisja e korporatave, cikël leksionesh kap.9 faqe 260-265 shkurt 2008 )

Në tranzicionin ekonomik shqiptar pas viteve 90-të, ndryshimi i menaxhimit të pasurisë nga dora shtetërore në duar private ka evidentuar rolin e një numri faktorësh si ai i vlerësimit të pasurisë publike dhe metodave të përdorura për këtë qëllim. Në këtë aspekt studimi im fokusohet në marrëdhënien mes metodës së vlerësimit dhe faktorëve influencues në kontekstin e hidrokarbureve në Shqipëri.

Pyetjet që ngre studimi im e kanë origjinën në realitetet praktike që kanë krijuar privatizimet e 20 viteve të fundit. Por ato bartin dhe reflektojnë edhe një interes shkencor nga një këndvështrim teorik. Tentativa për tu dhënë përgjigje atyre ndihmohet edhe nga debati teorik e shkencor që ekziston mbi metodën e vlerësimit. Kështu që për arritur në një kuptim më të mirë të dinamikave të metodave të vlerësimit dhe një sens më të mirë të fakteve që vëzhgohen në kontekstin shqiptar të hidrokarbureve, një ndër gjërat që bën ky studim është edhe sqarimi i 3 elementeve:

- Pse vlerësimi i pasurive publike përfaqeson një fenomen me interes studimor?
- Cilat çështje dominojnë debatin teorik mes shkollave dhe studiuesve sa i përket vlerësimit?
- Cilat janë dallimet mes shkollave dhe teorive sa i përket vlerësimit?

### **2.3. Alternativat e politikës për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit të ndërmarrjeve publike.**

Qeveritë vendosin të mbajnë në pronësi shtetërore ndërmarrjet publike me performancë të dobët për një sërë arsyes<sup>4</sup>,

- a-** duke besuar se mallrat apo shërbimet që ata sigurojnë nuk mund të ofrohen në mënyrë efikase nga sektori privat për shkak të kundërshtimit të fort politik për privatizimin, me qëllim mbrojtjen e asaj që konsiderohet një industri strategjike apo sektor për qëllime zhvillimi ekonomike;
- b-** për shkak të frikës së luhatjeve të mëdha sociale dhe politike nga reduktimi apo shkurtimi i vendeve të punës apo për shkak të plogështisë politike.

Reformat e qeverisë janë mënyrat më të rëndësishme për të përmirësuar performancën e ndërmarrjeve publike. Me qëllim funksionimin me efikasitet të ndërmarrjeve publike, ato duhet të mbikëqyren mirë nga ndonjë agjenci shtetërore ose një bord i pavarur. Drejtimi i ndërmarrjes përfshin ato struktura dhe procedura që të sigurojnë funksionimin me efikasitet dhe me përgjegjshmëri të ndërmarrjes në interes të publikut dhe të kontribuojë në zhvillimin kombëtar. Roli i qeverisë është të caktojë politikën, procedurat dhe strukturat organizative që drejtojnë veprimtarie të ndërmarrjeve publike për të arritur ato qëllime. Struktura më e përshtatshme për qeverisje ndryshon midis vendeve, por në mund të japim tre opsione kryesore:

---

<sup>4</sup>Sh.Llaci Qeverisja e korporatave cikël leksionesh kap.9 faqe 290 , shkurt 2008

1. Një objektiv politik dhe një bord drejtuesish i kualifikuar i përbërë nga përfaqësues të qeverisë dhe anëtarë të jashtëm të cilët nuk kanë konflikt interesash apo potencial për fitime personale të paligjshme, kur janë në shërbim të bordit;

2. Një organ qeverisës i përgjegjshëm si Komisioni i Ndërmarrjeve Publike apo agjencia me përgjegjësi për mbikqyrjen e aktiviteteve të ndërmarrjes duke audituar financat e saj dhe duke siguruar komformitetet me ligjet dhe rregulloret;

3. Një kompani shtetërore e cila i raporton një sërë ndërmarrjesh shtetërore.

Qeveritë duhet të marrin masa për të siguruar se operacionet dhe procedurat e organeve qeverisëse të ndërmarrjeve publike janë transparente dhe të hapura për kontroll.

Tre janë drejtimit kryesore ku duhen përqendruar përpjekjet për reformimin e qeverisjes së ndërmarrjeve publike: *përcaktimi i objektivave të qarta për NP-të, reduktimi i ndërhyrjes së politikës dhe burokracisë, si edhe transparencë më e lartë.*

#### *A) Përcaktimi i objektivave të qarta për NP-të.*

Para së gjithash qeveria duhet të vendosi objektiva të qarta për NP-të. Nëse synimi themelor i tyre do të ishte përformancë financiare, atëherë mbikqyrësit e shtetit (institucione, agjenci etj) duhet të përcaktojnë objektiva të qartë për këtë çështje. Matësit / treguesit e përformancës nuk është e thënë që patjetër duhet të përputhen me ato të sektorit privat – ku maksimizimi i fitimit tenton të jetë objektivi i vetëm. Por sidoqoftë objektivat e përformancës duhet të sigurojnë, që një NP do të rikuperojë koston e kapitalit të saj (kur kostot e objektivave jo komerciale janë të përjashtuar). Vetëm kur qeveria është e sigurt që një NP ka një gjendje të shëndoshë financiare,

mund t'i drejtohet kësaj kompanie, që të ketë në vëmendje objektiva jo komerciale si stabiliteti i të punësuarve etj. Çdo këndvështrim tjetër riskon gjendjen e shëndoshë financiare të kompanisë në një kuadër afatgjatë. Në rastet kur qeveria përcakton objektiva të shumëfishta, atëherë është e domosdoshme që të përcaktohet rradha prioritare e plotësimit të tyre dhe me direktiva të qarta mbi *trad offs* ndërmjet objektivave sekondare. Ndërsa kjo duket racionale, pak qeveri e realizojnë praktikisht, të paktën deri tani. Përveç kësaj, qeveritë duhet të kalkulojnë kostot për plotësimin e objektivave jo komerciale dhe t'i bëjë të ditura publikisht. Akoma më tej, do të ishte më mirë nëse përcaktohen edhe fonde të veçanta për të “mbuluar” arritjen e këtyre objektivave. Në Zelandën e Re për këtë gjë duhet të merret aprovimi i parlamentit. Dhe në vitin 2003 qeveria përkatëse dha një fond prej 10.7 ml \$ zelandezë për zhvillimin e programeve televizive lokale.

#### *B) Reduktimi i ndërhyrjes politike*

Mbajtja e NP-ve larg ndërhyrjes politike është një gjë mjaft e vështirë dhe jo vetëm në vendet në tranzicion. Por një gjë e tillë mund të minimizohet sikurse na tregojnë shembujt nga vende të ndryshme të botës, sikurse është eksperiencia e Zelandës së Re apo e ndonjë vëndi tjetër, ku praktika ka treguar se rritjet e performancës së NP-ve nga reformat e ndërmarra në kuadrin afatgjatë do të varen në një masë të konsiderueshme nga “distanca” në të cilën mbahen politikanët dhe burokratët e qeverisë. Krijimi i distancës ndërmjet qeverisë dhe NP-ve e bën të vështirë për politikanët dhe burokratët që të ndërhyjnë për interesat e tyre dhe e bëjnë reformën të qëndrueshme në kohë. Në të njëjtën kohë nga kjo gjë kanë përfitim dhe politikanët, edhe punonjësit civilë. Ajo minimizon mundësinë që ata të kritikohen për vendimet jo efektive, që menaxherët do

të ishin të detyruar të ndërmerrnin nga ndërhyrjet e politikanëve. Një shembull i qartë i kësaj mosndërhyrje është ndarja e bankës qendrore nga politika në Angli. Parlamenti anglez ka deklaruar në mënyrë të qartë se ai nuk do të ndërhyjë në përcaktimin e përqindjes së interesave nga Banka e Anglisë. Për rrjedhojë Parlamenti dhe publiku nuk mund të bëjnë përgjegjës ministrat për politikën eventualisht jo popullore të interesave të ndërmarra nga kjo bankë. *Hapi i parë* në zbutjen e ndërhyrjes politike do ishte *qartësimi i roleve të qeverisë* si aksioner, financier, rregullator, furnitor, klient etj. Një mënyrë për arritjen e kësaj është përqendrimi i pronësisë dhe i kontrollit të NP-ve në një agjenci të vetme qeveritare. Në Suedi p.sh, aksionet e shumicës së NP-ve janë në duart e Ministrisë së Industrisë, ku një njësi e specializuar brenda saj monitoron këto ndërmarrje dhe ushtron të drejtat e aksionerit, të tilla si emërimi i drejtorëve dhe aprovimi i blerjeve të rëndësishme të ndërmarrjeve.

Në Singapor, pronësia dhe monitorimi janë në varësi të Temask Holding një kompani më vete e themeluar gati 30 vjet më parë. Qeveria franceze ngriti në vitin 2003 Agjencinë e pjesëmarrjes së shtetit (Agence des participations de l'Etat) për të centralizuar funksionet e aksionerëve, që më parë ishin të shpërndara nëpër ministri të ndryshme. Qeveria kineze ka ngritur Komisionin për mbikqyrjen dhe administrimin e aseteve për bashkimin e monitorimit dhe pronësisë në 196 ndërmarrje të mëdha të drejtuara në mënyrë të centralizuara. Ndërsa në Shqipëri, si rregull të gjitha ndërmarrjet publike në formën e shoqërive anonime, për çështje të administrimit ekonomik varen nga drejtoria e administrimit të shoqërive anonime në Ministrinë e Ekonomisë, ndërsa udhëheqja e tyre nga pikëpamja profesionale bëhet nga Ministria në varësi të së cilës ajo është (për shembull Drejtoria e Përgjithshme Hekurudhave) – pra nuk kemi bashkim në një agjenci të vetme si të monitorimit ashtu edhe të pronësisë.



Një hap i tillë e bën të qartë se është një entitet qeveritar “pronari” i NP-ve, që ushtron të drejtat e aksionerit dhe nga ana tjetër, menaxherëve duhet t’ju komunikohet se ata kanë vetëm një “bos”. Përsa i përket agjencive të tjera qeveritare, ato duhet të udhëzohen që të bashkëveprojnë me NP-të duke ruajtur “distancën” mes tyre. Rregullatorët industrialë, për shembull duhet t’i trajtojnë NP-të njësoj si ndërmarrje analoge privatë. Një shembull i favorizimit të padrejtë ishte ajo që thuhej se Ministria Kineze e Informacionit rriti tarifën e telefonisë, me qëllim që të nxiste interesin e investitorve ndaj telekomit kinez në 2002.

Po kështu, kur një njësi qeveritare jep hua në para për NP-të, duhet që huatë t’i ofrojë me të njëjtat kushte sikur të ishte huadhënës privat. Në shumë vende NP-të marrin hua nga thesari i shtetit apo nga bankat që janë pronë e shtetit me përqindje interesi nën ato të tregut dhe me kushte më të favorshme, sesa ato që ofrohen nga bankat e tjera. Kjo lloj mbrojtje, që ju bëhet atyre nga forcat e tregut, reduktojnë interesin e ndërmarrjeve publike për të përmirësuar performancën si edhe ndikon negativisht në konkurrueshmërinë e tyre në kuadrin afatgjatë.

Më e mira akoma do ishte, që NP të kërkojnë hua vetëm në sektorin privat. Kjo jo vetëm që do të eliminonte një mundësi ndërhyrje nga ana e qeverisë, por dhe do të edukonte një disiplinë më të madhe në marrëdhëniet me institucionet financiare të menaxherëve të këtyre kompanive. Ky lloj trajtimi përdoret në Suedi, e cila ka detyruar disa nga kompani publike që të marrin nga tregu privat. Arsyeja është i tillë, që përfitimi i NP-ve duke operuar me bankat / tregjet e kapitalit mësojnë, për rrjedhojë ja vlen kostoja më e lartë e paguar. Dhe tani asnjë kompani nuk ka pasur probleme me pagesat ndaj bankave dhe dividendët e lartë të paguar nga NP-të ndaj qeverisë suedeze janë shenja se kjo strategji po jep rezultate pozitive.

Atje ku konsideratat politike e quajnë të pamundur bashkimin në një agjenci edhe të pronësisë edhe të monitorimit, qeveria duhet të përpiqet që të ngrejë një agjenci për monitorimin e NP-ve në emër të të gjithë aksionerëve (multiple shareholders). Një trajtim i tillë ndihmon për më shumë koherencë në politikën e NP-ve, lejon që të zhvillohet një ekspertizë më e kompletuar në bizneset e NP-ve si dhe lehtëson adaptimin e praktikave më të mira ndërmjet këtyre kompanive. Në Zelandën e Re, ku aksionet e NP-ve janë në duart e dy ministrive, monitorimi i NP-ve bëhet nga një njësi gjysëm autonome (Craën Compani Monitoring Advisory Unit- CCMAU). Kjo njësi këshillon edhe ministrinë përgjegjëse për strategjinë e NP-ve, mundësitë për investime, si dhe një sërë çështjesh të tjera që lidhen me ndërmarrjet publike.

Qeveritë mund të rrisin shkallën e ndarjes nga politika edhe me anën e *ndryshimit të statusit ligjor të ndërmarrjeve* në varësi të shtetit, e duke i dhënë autoritet real një bordi profesional drejtorësh. Në këtë mënyrë, duke transformuar ndërmarrjet, që momentalisht operojnë si departamente qeveritare në një korporatë që vepron sipas ligjit të kompanive, vende të ndryshme adaptojnë një model qeverisje, i cili në shumë aspekte ka më shumë sens për NP-të e orientuara nga komercialiteti. Ligji i kompanive e distancon më shumë akoma ndërhyrjen e qeverisë dhe të politikanëve në përgjithësi sepse seksione të veçanta të këtyre lloj ligjeve (sipas veçorive të vendeve respektive) në shumë vende e kufizojnë të drejtën e aksionerëve, që të menaxhojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërmarrjen. Kjo e drejtë ushtrohet nga bordi i drejtorëve dhe shefi ekzekutiv, nëse nuk është e shprehur ndryshe me ligj të veçantë (apo në statutin e kompanisë).

Natyrisht që këto nuk i zgjidhin deri në fund problemet e varësisë dhe të ndërhyrjes së politikës. Shembull evident në këtë drejtim është Evropa Lindore në këto vite të gjata

tranzicioni, ku megjithëse shumë ndërmarrje publike janë kthyer në shoqëri aksionere (sh.a), ndërhyrja e shtetit vazhdon të jetë në nivele relativisht të larta. Për biznesin publik në vendin tonë, në pjesën më të madhe të kohës është lënë jashtë vëmendjes fakti, që ky segment duhet të menaxhohet me rregullat e kapitalit privat. Sigurisht që kjo nuk është e thjeshtë sidomos kur flasim në terma konkrete. “Difekti kryesor që konstatohet nga një vëzhgim i ushtruar mbi 14 ndërmarrje shtetërore është ai mungesës së koncepteve manaxheriale. Ndryshimet e shpeshta të ekipeve drejtuese dhe sidomos psikologjia e të qenit i përkohshëm në postet drejtuese të sektorit publik ka qënë me pasoja mjaft të rënda për të. Është shumë e vështirë që të formohen drejtues dhe sipërmarrës, qofshin këta edhe për sektorin publik. Në 14 ndërmarrjet e vëzhguara në vitet e para të tranzicionit shqiptar rezultonte se për 5 vjet drejtuesit kryesor janë ndërruar mesatarisht 2.16 herë, çka do të thotë se çdonjëri është ndërruar mesatarisht për gati 2 vjet. Për periudha kaq të shkurtra, kur në vendin tonë mbizotëroi psikologjia e braktisjes dhe e fillimit nga e para, efekti drejtues është i papërfillshëm.

Analiza e mëvonshme (viti 2008)<sup>5</sup> tregon se në intervalin 1- 3 vjet kanë vjetërsi punë manaxheriale 48 % e manaxherëve dhe se në një post drejtues që nga viti 2008 e deri më sot janë ndryshuar mesatarisht 3.34 persona. Ky proces “permanent” ndryshimesh përbënte një faktor bazë që ka ndikuar në moskonsolidimin e administratës në përgjithësi dhe të asaj publike në veçanti. Është fakt se jo rrallë, biznesi publik, shërbeu si një mjedis ku mund të zhvilloheshin format e kamufluara të korrupsionit nën emërtimet e termave të ekonomisë së tregut.

Nga të intervistuarit (Sh. Llaci, 2008) i jepeshin mesatarisht 3.99 pikë nga 5 të mundëshme, roli që luante angazhimi politik në caktimin e personave në poste drejtuese

---

<sup>5</sup>Sh. Llaci “manaxhimi dhe produktiviteti”, monografi, Tiranë 2008

manaxheriale, sidomos e theksuar kjo në administraten publike. Kjo përforconte më tej atë çka dihet për ndikimin e njëanshëm të politikës mbi manaxhimin në përgjithësi dhe në emërimet e individëve edhe në nivelet relativisht të ulta hierarkike.

Autoriteti i qeverisë duhet të ngelet brenda kufijve të tillë si përcaktimi i objektivave dhe standardeve të performancës (siç është dividendi apo madhësia e të ardhurave) emërimi i drejtorve, monitorimi i performancës së ndërmarrjes dhe i drejtorve si edhe ndërhyrja, kur punët shkojnë keq apo ndodhin skandale financiare, pjesa tjetër e autoritetit duhet realisht t'i kalojë de fakto bordit të drejtorve. Në fakt, çështja e një bordi realisht efektiv është një gjë e vështirë edhe për sektorin privat. Prandaj ndërtimi i një bordi solid të NP-ve nuk është e lehtë, sidomos në tregjet e reja ku edhe kandidatët potencialë për drejtorë janë të pakët. Në bord duhet të përfshihen njerëz, që janë jo vetëm të talentuar, por edhe të përkushtuar e të gatshëm të mësojnë mbi biznesin, të sfidojnë manaxhimin e lartë të kompanisë si edhe të jenë në gjendje t'i rezistojnë ndërhyrjes së politikanëve dhe të punonjësve civilë.

Ndodh jo rrallë, që në vend të specialistëve të zotë e me integritet, zgjidhjen individë në sajë të lidhjeve dhe preferencave politike. Bordet në Indonezi, për shembull, janë të mbushur me qeveritarë dhe individë nga sfera ushtarake, të cilët nuk kanë as aftësitë dhe eksperiencën e duhur. Emërimet në përbërje të bordit duhet që të ndjekin një proces rigoroz të formalizuar dhe të bazuar në meritokraci. Njësia e monitorimit (CCMAU) në Zelandën e Re verifikoi që kandidaturat potenciale për drejtorë të plotësojnë kriteret e përcaktuara që më parë për borde të veçanta dhe pastaj bëhet emërimi i tyre.

### *C) Më shumë transparencë mbi performancën e NP-ve*

Zakonisht transparenca konsiderohet si guri i themelit të një reforme serioze të qeverisjes. Aksesit i gjerë tek informacioni ofron një bazë të mirë për përgjegjshmërinë e qeverisë dhe njëkohësisht përbën edhe një barrierë të fortë ndaj ndërhyrjeve, që i shërbejnë interesit vetiak të individëve apo segmenteve të caktuara të pushtetit e politikës. Pa informacion të saktë dhe të detajuar, është e vështirë të vlerësojmë performancën e kompanisë dhe të bordit, të përcaktojmë objektiva të sakta dhe të alokojmë në mënyrë efikase kapitalin. Një nga aspektet e qeverisjes së korporatës, që nuk i jepet prioriteti i duhur nga ana e NP-ve është raportimi i menaxhimit tek aksioneri/nerët. Menaxhimi zakonisht emërohet nga shteti, disa herë si një “qoshkë e ngrohtë” dhe rrallë ata janë përgjegjës vetëm për performancën financiare. Edhe nënndarjet e NP-ve shpesh menaxhohen nga shteti apo të emëruarit nga ministritë, të cilët nuk kanë ndonjë përgjegjësi reale ndaj aksionerëve imediatë të NP-ve. Shpesh kemi një sistem dual raportimi, e cila de facto do të thotë të mos ketë fare raportim. Ky aspekt i pavarësisë ka ndikim në dëmtimin e mundësisë për një monitorim efektiv të performancës. Në të njëjtën kohë ka edhe një zbehje të përgjegjshmërisë për një performancë të tillë. Prandaj NP-të duhet të sigurojnë transparencë të plotë tek aksioneri. Auditë me reputacion duhet të emërohen për të gjitha NP-të dhe atyre duhet t’ju kërkohet që të sjellin në vëmendje të aksionerëve aspekte të riskut apo të performancës së pafavorshme. Njëkohësisht duhet të kërkohet që auditët të veprojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Megjithatë shumë prej NP-ve nuk janë të listuar në bursë, sikurse është rasti i kompanive analoge shqiptare, në thelb ato janë kompani publike (në kuptimin e detyrimeve njëloj si shoqëritë aksionere të listuara) dhe duhet të jenë transparente, të

paktë aq sa edhe kompanitë e listuara. Informacioni duhet të jetë jo vetëm për performancën, por edhe për objektivat e çdo ndërmarrje (veçanërisht objektivat jo komerciale si edhe objektivat sociale), koston e angazhimit për të plotësuar objektivat jo komerciale si edhe çdo lloj granti të dhënë nga qeveria. Rritja e investigimit nga publiku, shtypi dhe organizmat joqeveritare ngre në një shkallë të lartë përgjegjshmerine si nga manaxhimi i ndërmarrjes ashtu edhe nga mbikqyrësit e qeverisë. Edhe qeveria duhet të jetë më transparente. Ajo duhet të bëjë publike direktivat për mbikqyrjen e NP-ve duke përfshirë këtu edhe se kur dhe si do të ndërhyjë vetë qeveria. Ajo duhet të publikojë edhe objektiva të qarta të vëna për NP-të dhe manaxhimin e tyre, së bashku me vlerësimin periodik sesa i kanë arritur ndërmarrjet e objektivat e vendosura. Shkalla e transparencës së ndërmarrjeve publike shqiptare është e kufizuar në publikimin e pasqyrave financiare. Me projektligjin e ri të shoqërive tregtare, kjo transparencë parashikohet të jetë më e madhe, sidoqoftë përsëri është disi e kufizuar po të kemi parasysh vendet si Suedia, të cilat i kemi marrë herë pas here si shembuj të një transparence të lartë. Ndërsa transparenca e qeverisë karshi NP-ve është në nivele mjaft të ulta, çka mbetet një çështje, që kërkon një angazhim serioz dhe profesional të agjencive dhe institucioneve të qeverisë.

*Së fundmi*, çdo reformë në qeverisjen e kompanive shtetërore kërkon mbështetjen nga publiku. Në të kundërt, sidikatat dhe grupet e tjera të interesit mund ta dëmtojnë procesin. Një gjë e tillë kërkon një debat konstruktiv. Pikërisht kështu veproi Suedia 5 vjet më parë. Fillimisht ajo organizoi takime me përfaqësues të sindikatave, duke i bindur ata se mbajtja e vendeve të punës më shumë sesa ishte e nevojshme, do ta jepte ndikimin e vet negativ në gjendjen ekonomiko-financiare të kompanisë në një kuadër afatgjatë.

## 2.4. Tranzicioni ekonomik në rajon

### 2.4.1. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Kroaci

Procesi i privatizimit në Kroaci, filloi qysh me fillimin e luftës, vazhdoi edhe me përfundimin e luftës dhe deri më sot, kur shteti kroat tanimë është edhe zyrtarisht anëtar i 28-të i Bashkimit Evropian (BE). Në bazë të ligjeve të aprovuara nga Republika e Kroacisë: a) *Ligji mbi kapitalin shoqëror (1989)*, dhe b) *Ligji mbi transformimin e ndërmarrjeve shoqërore (1991)*, e në veçanti në bazë të ligjit të dytë, të gjitha ndërmarrjet do duheshin të shndërroheshin në ndërmarrje me kapital të përzier, ose në ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar (Selmanaj, 2006). Gjatë këtij procesi u përdoren kryesisht këto modele: a) shitjen e një pjese, ose të ndërmarrjes në tërësi, b) investimi shtesë në kapitalin e ndërmarrjes, c) transformimi i kërkesave ndaj ndërmarrjes në investime në ndërmarrje, d) transformimin e të gjitha aksioneve në Fondin Kroat për Zhvillim dhe po ashtu edhe në Fondin e Pensioneve (Isufi, 2005). Për nga këndvështrimi ekonomik, procesi i ndryshimit dhe i tranzicionit ekonomik në Republikën e Kroacisë, njihet edhe si i “ashtuquajtur” proces i reformave të Markoviçit<sup>6</sup>, i cili demonstroi një sërë novacionesh në fushën ekonomike, ashtu siç e quajnë dhe e njohin edhe shkencëtarët kroatë (Mestrovic, 2007). Pas shpalljes së pavarësisë nga shteti kroat, struktura e kompanive ka filluar të ndahet në njësi dhe nën-njësi. Vlen të theksohet se sipas një hulumtimi të bërë nga *Agjencioni i Konkurrencës së Kroacisë*, shitja me pakicë përgjatë viteve 2008 – 2010, është rritur nga 52.4% në 58.4% (Agency, 2011). Këto të dhëna, qoftë nga literaturat relevante, apo edhe agjencioni në fjalë, individët dhe hulumtuesit e pavarur, dëshmojnë se procesi i tranzicionit, e në veçanti tranzicioni ekonomik ka ndikuar shumë pozitivisht në

---

<sup>6</sup> Ante Markoviç – President dhe Kryeministër i Republikës së Kroacisë , 1989 – 1991

qëndrueshmërinë dhe stabilitetin ekonomik të këtij vendi (Cvijanovic, 2011), pasi që siç dihet që njëri nga kriteret kryesore që i kërkon BE-ja, është pikërisht plotësimi i standardeve të kriterit ekonomik. Kapitalizmi kroat është specifik, qoftë në formë apo në zhvillimin e tij. Këtë fakt e kanë dëshmuar edhe analizat e shumta të autorëve të ndryshëm kroatë, qoftë për nga aspekti sasior ose cilësor (Cvijanovic, 2011), edhe pse Banka Botërore e ka rankuar të 84 të mesin e 183<sup>7</sup> shteteve për bërjen e biznesit, mirëpo edhe Banka Europiane për Zhvillim dhe Ndërtim (ERBD) e ka rankuar me notën 3 (nga 1 deri në 3). Shpenzimet qeveritare që i dedikohen zhvillimit të arsimimit dhe edukimit mbështetur në GDP e saj, janë dukshëm më të vogla në krahasim me vendet e BE-së (Eurostat, 2011), edhe pse tanimë shteti kroatë duhet të investojë më tepër, pasi që pikëpamjet dhe qëllimet e firmave globale në njërën anë kërkojnë të gjejnë punonjës me kosto më të ulët, por paralelisht individë që të posedojnë dije dhe kriterë sa i përket njohurive të punëve qoftë të shërbimit, e në veçanti atyre të dijes (Mouhoud, 2007).

#### *2.4.2. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Malin e zi*

Faza fillestare e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Malin e zi është bërë nëpërmes shëndrrimit të ndërmarrjeve shoqërore në “shoqëri aksionare”, ose në “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (Simon, 2003). Pavarësisht ligjit të aprovuar në vitin 1994, me ç’rast janë paraparë 8 modele të privatizimit (Ljajovic, 1998), megjithatë në praktikë janë përdorur kryesisht tri modele kryesore, a) modeli i *dhënies dhe i shitjes së fletë-aksioneve ose pjesëve të aseteve me zbritje, me qëllim të shitjes së kapitalit shoqëror*, b) modeli i *dhënies dhe i shitjes së fletë-aksioneve me qëllim të krijimit të*

---

<sup>7</sup>Sipas të dhënave të vitit 2011




kapitalit shtesë, gjegjësisht rritjes së kapitalit, c) modeli i bartjes së fletë-aksioneve në fondet pa kompensim: në

Fondin për zhvillimin e Republikës së Malit të zi, Fondin e pensioneve dhe Fondin inValideor, në Fondin për punësim ose në korporatën “Holding”, edhe modeli i shpërndarjes së fletë-aksioneve pa kompensim për 10% të vlerës kontabël të kapitalit të ndërmarrjes së privatizuar.

Fondet ishin të obliguara që fletë-aksionet, të cilat hidheshin në shitje, para se gjithash, duhet t’i ofrohen ndërmarrjes e cila këto fletë-aksionë i ka bartur në fonde në mënyrë që të mund të blejë në llogari të të zënëve me punë. Këtë të drejtë ndërmarrja mund ta realizonte në 2 mënyra: a) me blerjen e fletë-aksioneve për punëtorët dhe persona të tjerë, ndërmarrja vepron në llogari të huaj, dhe b) ndërmarrja mund të veprojë në emër të vet dhe po ashtu edhe në llogari të vet (Selmanaj, 2006) - i referohet Medojević Nebojša, Podgoricë, 1996, fq. 252.

**Tabela 4. Struktura fillestare e pronës në korporatë**



*Burimi: Literatura*

#### *2.4.3. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Slloveni*

Në bazë të disa provave, përfshirë ligjet, praktikat dhe parashikimet e parapara nga autoritetet kompetente të shtetit slloven, konstatohet (Selmanaj, 2006):

- a) Procesi i privatizimit të pronës shoqërore është realizuar në mënyrë shumë të ngadalshme
- b) Shitja e ndërmarrjeve nuk është bërë sipas intensitetit të paraparë
- c) Interesimi i kapitalit të huaj ishte dukshëm nën parashikimet sllovene.

Duke u mbështetur në këtë “dështim” nëse ashtu mund ta quajmë, kreatorët e modelit paraprak, u përcaktuan për privatizim masiv nëpërmes “certifikatave” pa kompensim të të gjithë qytetarëve sllovenë duke e përfshirë vetëm moshën e tyre madhore, por natyrisht duke ia përcaktuar edhe çmimin e kësaj “certifikatë”, e cila në atëbotë i takonte ish-valutës gjermanë (markës). Vlerat e “certifikatave” ndryshonin, pasi që çmimi më i lartë ishte për personat me moshë më madhore, Ndërsa çmimi i një “certifikatë” për një të moshës rinore ishte 300%-400% më i ulët.

#### *2.4.4. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Maqedoni*

Për shitjen ose më mirë thënë përgatitjen dhe realizimin e procesit të privatizimit në Maqedoni është përkujdesur Agjencioni i Privatizimit i Republikës së Maqedonisë. Gjithsesi sikurse në çdo vend tjetër që ka kaluar në procesin e tranzicionit ekonomik, e në veçanti privatizimin si njërin nga pjesët më vitale të tranzicionit, e ka mbështetur në ligjet e miratuara në kuvendin e Republikës së Maqedonisë (Selmanaj, 2006). Privatizimi i **ndërmarrjeve të vogla** është realizuar nëpërmes dy modeleve:

- a) *blerja e ndërmarrjes nga punëtorët përmes fletë-aksioneve interne*
- b) *shitjes së pjesë ideale të ndërmarrjes*

Privatizimi i **ndërmarrjeve të mesme** është realizuar nëpërmes këtyre modeleve:

- a) shitjes së pjesës ideale të ndërmarrjes*
- b) blerjes së ndërmarrjes nëpërmes aksioneve internë*
- c) shitjen e ndërmarrjes të cilët e udhëheqin ndërmarrjen*
- d) dhënies së fletë-aksioneve për hir të deponimeve plotësuese*
- e) përmes shndërrimit të kërkesave kontestuese në kapital të përhershëm*

Në krahasim me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për **ndërmarrjet e mëdha** zgjedhjen e modelit pak më “ekskluziv” e ka përcaktuar Agjencioni i Privatizimit të Republikës së Maqedonisë. Specifikat e privatizimit të këtyre ndërmarrjeve mund të sintetizohen në këto drejtime:

- a) në rast se ndërmarrja blihet nga një person i cili do të udhëheq me ndërmarrjen, i kërkohet t’i paguajë, shumat fillestare e pagesës është 10% nga totali i vlerës së kapitalit të ndërmarrjes, në krahasim me ndërmarrjet e mesme ku kërkohet të paguhej vetëm 20% e vlerës.

Sipas kësaj del se në Republikën e Maqedonisë për sa i përket privatizimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha është përdorur kryesisht modeli i shitjes me kredi dhe i blerjes së manipuluar, i cili ka rezultuar me një plaçkitje më të madhe të kapitalit shoqëror në të cilën plaçkitje është përzier edhe qeveria e vendit (Selmanaj, 2006).

#### *2.4.5. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Republikën Çeke*

Në Republikën e Çekisë, procesi i privatizimit ka filluar qysh në fillim të vitit 1990, dhe qysh atëherë është bërë privatizimi i ndërmarrjeve të vogla. Bazuar në kriteret e shpejtësisë, në të cilin kishin të drejtë të blinin triska vetëm individët e moshës

madhore, dhe atë pa kompensim. Tiparet kryesore të modelit çek të transformimit të pronës dhe të privatizimit të pronës do ta mund ta mbështetnim në dy çështje kryesore (Patrick, 2007):

a) Qëllimi procesit të privatizimit në Republikën Çeke ishte që pas këtij procesi të depërtonin sa më shumë investime dhe kapitale të huaja në vend.

b) Për shkak të kohëzgjatjes (më tepër se 4 vjet), menaxherët e ndërmarrjeve nëpërmes të ashtuquajturit “privatizim spontan” kanë përfituar një pjesë të madhe të pasurisë, dhe duke e marrë parasysh faktin se fondet janë shndërruar në pronësi të pronarëve të ndërmarrjeve të mëdha, njëherësh janë shndërruar në pronarë të mëdhenj të institucioneve financiare (Selmanaj, 2006).

#### *2.4.6. Tranzicioni ekonomik – me theks të veçantë procesi i privatizimit në Kosovë*

Kosova, edhe pse ka përjetuar një luftë të përgjakshme, dhe të dhimbshme për popullatën dhe që solli një shkatërrim të konsiderueshem material të vendit, menjëherë pas ndalimit të luftës filloi me krijimin dhe ndërtimin e institucioneve të saja, përfshirë këtu edhe Agjencionin për Privatizimin e Kosovës.

Agjencia Kosovare e Privatizimit themelohet si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr. 04/L-034, mbi AKP-në.

AKP ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

AKP themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, me ndryshime, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të AKP-së. Dhoma e Veçantë ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë e AKP-së i janë dhënë Bordit të Drejtorëve, i përbërë nga tre drejtorë-Ndërkombëtarë dhe pesë Kosovarë. Në përputhje me Ligjin e vjetër të AKP-së Nr. 03/L-067, mbledhja inauguruese e Bordit të AKP-së është mbajtur më 26 gusht 2008. Që nga atëherë, AKP-ja është duke punuar në Privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-ve).

Të fillosh të diskutosh për procesin e privatizimit në Kosovë, është sikur “*një student i cili në një provim universitar, pretendon vazhdimisht se rezultatin përfundimtar kontabël e di, ... mirëpo nuk di se si të arrijë tek ai*”! Kosova si në vend me 10. 908 km<sup>2</sup>, me një popullsi më të re në rajon, me burime natyrore shumë të dobishme dhe të begatshme, por edhe me asetet të cilat ishin prezente në kohën e pasluftës, do të mund të shfrytëzoheshin, së paku në mënyrën më optimale, në mënyrë që ky vend, pra Kosova, sot, në vitin 2014, të ketë një gjendje dukshëm më të qëndrueshme për nga aspekti i treguesve mikroekonomik, e në veçanti atyre makroekonomik (punësim më të lartë, rritje reale ekonomike të vazhdueshme, stabilitet të çmimeve, kosto shumë më të ulët financiare në raport me tregtinë e jashtme, e në veçanti një kosto shumë më të ulët sociale).

Në aso kohe, “Agjencioni i Mirëbesimit i Kosovës – AKM”, sot Agjencioni i privatizimit të Kosovës në tekstin e mëtejshëm *Agjencia*), me rastin e konsolidimit të saj, numëronte 8 drejtorë, dhe atë 4 ndërkombëtarë, 4 banorë që duhet të jenë banorë të

Kosovës (Rregullorja 18/05 e UNMIK<sup>8</sup>-ut). Kompetencë e kësaj Agjencie, ishin të gjitha ndërmarrjet me kapital shoqëror dhe ndërmarrjet me kapital publik. Ky institucion merrej edhe me “likuidimin” e të ashtuquajturit “kapital i zhveshur”, por njëkohësisht do të merret edhe me privatizimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror përmes modelit SPIN-OFF dhe SPIN-OFF special. Nga rreth 600 ndërmarrje shoqërore që ishin në Kosovë, Agjencia ka arritur t’i privatizojë pjesën dërrmuese të tyre (AKP, 2014). Sipas Agjencisë, ish-punonjësit janë përfitues të 20% të shitjes së ndërmarrjeve shoqërore, dhe se gjer më sot, punonjësit kanë përfituar rreth 80 milionë €. (AKP, 2014).

Sipas Prof. Selmanaj (Selmanaj, 2006), ***përparësi e këtij procesi është që “është kufizuar”*** prezenca e theksuar e nomenklaturës së vjetër politike në realizimin e tij, d.m.th e ndërprejë ndërlidhjen e nomenklaturës së vjetër politike me krimin e organizuar dhe njëkohësisht edhe krijimin e perandorive të dyshimta komerciale, që kanë përfshirë pjesën më të madhe të pjesës euro-aziatike. Në anën tjetër, shkalla e investimeve në krahasim me konsumim e eliminon ruajtjen e disa karakteristikave të sistemit të vetëqeverisjes, gjithsesi nëse i referohemi të dhënave të ndryshme shkencore, por e kundërta e thotë nëse e analizojmë dhe e paraqesim edhe raportin e progresit të disa organizatave kredibile. Por, mos të harrojmë se zhvillimi i procesit të privatizimit, dhe tranzicioni i treguar në Kosovë, e krijon një përshtypje dhe rrugë të mirë për anëtarësim në organizatat më kredibile ndërkombëtare, pse jo një ditë edhe në BE.

---

<sup>8</sup> United Nation Mission in Kosovo

## **2.5. Vlerësimi i Pasurive Publike: Çfarë e bën të rëndësishëm këtë fenomen?**

Rëndësia e vlerësimit është edhe praktike, edhe teorike. Në aspektin praktik, rëndësia e metodës së vlerësimit ka të bëjë me efektet që shkakton lloji dhe saktësia e saj. Metoda ndikon mbi vlerën që i atashohet pasurisë së destinuar për privatizim; d.m.th ndikon mbi faktin nëse vlera është ose jo reale. Vetë vlera e privatizimit ndikon pastaj në një kontekst më të gjerë mbi efektivitetin e procesit të privatizimit dhe të ekonomisë dhe në një kontekst më të ngushtë mbi ecurinë e ndërmarrjes të krijuara nga privatizimi. Në aspektin teorik, rëndësia e trajtimit të metodës së vlerësimit ka lidhje me 5 gjëra (Vandell 2006, Kinnard 2011).

Së pari, ka lidhje me karakterin e teorisë së vlerësimit. Kjo sepse vlerësimi anon me shumë nga arti sesa shkenca për shkak të abstragimit të tejskajshëm të realitetit dhe sjelljes problematike të aktorëve dhe tregjeve. Vlera e një teorie qëndron jo vetëm në shpjegimin e realitetit por edhe në thjeshtësinë e saj.

Së dyti, çështja e vlerësimit ka lidhje me konceptin e vlerës. Por vetë koncepti i vlerës, të paktën që nga shekulli i 19-të e këtej, ka njohur një diversitet të madh; mjafton të përmendet që dikush mund të flasë për vlerë të praktikave të tilla si sigurim, vlerësim, huadhënie, investim, përdorim, tregu, etj, çka e bën më kompleks diskutimin mbi metodën e vlerësimit.

Së treti, vlerësimi ka lidhje me natyrën e pasurisë. Ndërsa numri i aktorëve që kanë lidhje me pasurinë dhe pronën është i shumtë, trajtimi që i bëhet pasurisë jo vetëm është i ndryshëm, por edhe vetë studiuesit ende nuk kanë rënë në një mendje përse i përket natyrës së pasurisë dhe pronës.

Së katërti, trajtimi i metodës së vlerësimit ka lidhje me përqasjet ndaj vlerësimit. Përqasjet janë zhvilluar jo vetëm në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra, por edhe karakterizohen nga supozime nistore shpesh arbitrare e të ndryshme.

Së pesti, metoda e vlerësimit reflekton dhe ka lidhje edhe me shkollat e shumta që ekzistojnë. Vlerësimi si praktik nuk është një element vetëm i shoqërisë sonë, ca më tepër i konteksteve të tilla si ai shqiptar që i karakterizon ndryshimi i menaxhimit të pasurisë nga një dorë shtetërore në atë private. Vepra të Herodotit apo Akuinas tregojnë se vlerësimi si praktik dhe debati mbi të kanë ekzistuar që në Antikitet. Ndërsa që nga shekulli i 18-të e deri më sot mund të identifikohen një numër shkollash si; Shkolla Klasike e Ekonomisë e shekullit 18-të, (me Smith, Malthus, Rikardo, George, Mill), Shkolla Austriake e Ekonomisë e shekullit të 19-të (me Bohm-Bawerk, Menger, von Wieser), Shkolla Neoklasike e fundshekullit të 19-të dhe fillimshekullit të 20-të (me Marshall). Në shekullin e 20-të, debati mbi vlerësimin është avancuar nga Shkolla e Ekonomisë së Tokës (1920-1940) me përfaqësues Ely, Babcock, Fisher, Mertzke, Hyder, Atkinson; Shkolla Kritike ndaj Disiplinës së Pasurive të Patundshme (1940-1960) me përfaqësues Ross, Schmutz, Ellwood, Medici, Ratcliff, Graaskamp, Kinnard, Gibbons, Wendt; Shkolla ri-Integruese (1970-1990) me Colwell, Isaakson, Vandell, Gau, Wang, Grën, Kinnard, Fisger, Vandell, Kenney, Karvel. Në ditët e sotme debati përfshin zhvillimet më të fundit në mendimin teorik (1990-2013) nga Fisher, Gatzlaff, Geltner, Haurin, Goetzmann, Peng, Lin, Vandell, Bond, Hwang, Lai, Wang, Capozza, Schilling, Gyourko, Corgel, Sirmans, Mei, Knight, Riddiough, Ott, Childs, Titillan, Torous, Ciochetti, Kau, apo Case (Kinnard 2011).



*2.5.1. Metodatat e vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe vlerësimi i pronave në procesin e privatizimit në Shqipëri.*

Metodat e përdorura për vlerësimin e pronave shtetërore në Shqipëri janë dy:

- Vlerësimi i aktiveve në bazë të vlefës në inventar
- Vlerësimi i biznesit

Metoda e dytë është kufizuar vetëm tek sektorët strategjik, kurse metoda e parë është metoda e përdorur më gjerësisht gjatë procesit të privatizimit. Edhe pse ligjet për vlerësimin ishin fleksibël duke përcaktuar se: “...Vlerësimi i një prone shtetërore që do të privatizohet bëhet duke marrë parasysh gjendjen fizike, vendndodhjen dhe llojin e objektit (prodhimi apo shërbimi)...”, apo “...Vlerësimi i pronës shtetërore për motive orientuese bëhet me akte nënligjore”, fakti është që këto vendime nuk qenë dhe aq të lehta.

**Metoda e vlerësimit të aktiveve;** Kjo metodë që është përdorur më parë, bazohet në koston historike të aktiveve e regjistruar në librat kontabël të ndërmarrjes. Nga këndvështrimi institucional vlerësimi i ndërmarrjeve ndoqi këtë rrugë: Në çdo ndërmarrje, objekt i privatizimit, ngrihet një komision me teknikë të fushave të ndryshme. Detyra e komisionit është që t’u jepen vlera të gjitha aktiveve të ndërmarrjes. Komisioni inspekton aktivet e trupëzuara dhe verifikon nëse Vlefata Kontabël e Mbetur korrespondon me gjendjen reale të aktiveve. Në rast se të dhënat historike nuk ekzistojnë ose gjendja aktuale e një aktivi ndryshon shumë nga Vlefata Kontabël e Mbetur, komisioni ka të drejtën të vendosë mbi vlerën. Në fund llogaritet një Vlerë Aktuale Minimale (VAM) për çdo ndërmarrje apo aktiv që do të privatizohet. Pas kësaj dokumentacioni i ndërmarrjes me vlerësimin e përfshirë, kalon në zyrat rajonale e rrethëve dhe që janë në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Këto zyra kontrollojnë rregullsinë e dokumentacionit dhe e dërgojnë atë direkt për tek dega e AKP në rreth në rastin e një ndërmarrje lokale, ose në ministrinë e linjës në rastin e një ndërmarrje nacionale. Në rastin e parë dega e AKP në rreth fillon menjëherë procedurat e ankandit, kurse në rastin e dytë dokumentacioni shkon në fillim në ministrinë e linjës, më pas në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (e cila vendos për kohën dhe metodën e privatizimit) dhe në fund në AKP për t'u shitur. Nëse nuk ka asnjë kërkuar në ankand, dokumentacioni i ndërmarrjes kthehet në degët e rretheve të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, ose në ministritë e linjës për të përcaktuar një VAM të ulur. Cikli ripërsëritet. Kjo është një skemë komplekse dhe e pavolitshme, e cila e ngadalëson ndjeshëm procesin e privatizimit. Vlerësimi bazohet në Vleftën Kontabël të Mbetur, indeksin e çmimeve të konsumit dhe vendndodhjen. Këta tre komponentë përcaktojnë Vlerën Aktuale Minimale (VAM).

$$\text{VAM} = \text{Vlefta Kontabël e Mbetur} \times (1 + \text{indeksi i çmimeve të konsumit} + \text{koeficienti i vendndodhjes})$$

Vlefta Kontabël e Mbetur përcaktohet nga vlera fillestare e aktivitetit, plus të gjitha shpenzimet e kryera për riparimin dhe mirëmbajtjen gjatë jetës së tij, minus amortizimin e akumuluar.

Rregullat e shpjeguara më sipër janë marrë nga VKM nr. 47, datë 07.02.1994 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore...” . Me fillimin e privatizimit masiv u pa që ky vendim kishte nevojë për disa ndryshime të cilat u kryen në tetor 1995 me VKM nr. 589 datë 16.10.1995. Ky vendim nuk ndryshoi metodologjinë por vetëm disa koeficiente korrigjues dhe për këtë arsye nuk trajtohet këtu.

• **Metoda e vlerësimit të biznesit;** Kjo metodë vlerësimi preferohet të përdoret në sektorin strategjik. Në fakt ndërmarrjet e sektorit minerar, (të mesme dhe të mëdha) duhet të vlerësohen me metodën e “Rrjedhës së skontuar të parasë”<sup>9</sup>.

Në mungesë të tregut të kapitaleve është e vështirë të përcaktohet kostoja e kapitalit për investimet shtetërore. Për këtë arsye gjatë vlerësimit me metodën e “rrjedhës së skontuar të parasë”, përgatiten skenarë të ndryshëm, duke përdorur norma të ndryshme skontimi”, të cilat të çojnë në vlera të aktualizuara të ndryshme, pa dhënë një bazë solide për negociata me blerës të mundshëm privatë.

Në procesin e privatizimit kjo metodë është shumë e kufizuar; vetëm SH.A e Albkromit, miniera e Bitumit Selenicë dhe Guri Gëlqeror në Elbasan, janë vlerësuar deri tani me këtë metodë për qëllime privatizimi.

#### *2.5.2. Mjedisit i jashtëm dhe implikimet në procesin e vlerësimit për privatizim*

Zhvillimi i aktivitetit të organizatave të biznesit dhe marrja e vendimeve për privatizim realizohen nën trysninë e vazhdueshme të një diapazoni të gjerë forcash e faktorësh të mjedisit të jashtëm, të cilët kanë një influencë relativisht të madhe në mbijetesën dhe perspektivën e zhvillimit të ardhshëm të tyre. Për rolin e faktorëve të mjedisit mbi shkallën e suksesit të organizatave të biznesit ekzistojnë tri pikëpamje të ndryshme:

a- Roli determinues i mjedisit. Kjo pikëpamje- e ka zanafillën e saj në teorinë darviniste të seleksionimit natyral. Studiuesit e fushës së organizimit industrial, të cilët mbështesin këtë ide, pohojnë se performanca e biznesit varet në mënyrë absolute nga konkurrenca në industri dhe se firmat nuk mund të influencojnë mbi mjedisin.

---

<sup>9</sup>Discounted Cash Flow (DFC)

b- Roli determinues i organizatës. Kjo pikëpamje mbështetet nga studiuesit e fushës së sociologjisë, ekonomisë dhe të menaxhimit strategjik, të cilët argumentojnë se organizatat e biznesit jo vetëm që i përshtaten mjedisit, por suksesi i tyre varet nga fakti se sa ato influencojnë mbi të. Organizatat e fuqishme të biznesit, të cilat disponojnë burime të mëdha kanë një influencë më të madhe mbi mjedisin sesa organizatat e vogla.

c- Roli determinues i mjedisit dhe i organizatës. Kjo pikëpamje, e cila mbështetet nga shumica e studiuesve sot pohon se në suksesin e biznesit ndikojnë së bashku si mjedisi ashtu edhe organizata.

Faktorët e mjedisit të jashtëm janë ata faktorë që veprojnë jashtë kufijve të një organizate dhe që ndikojnë mbi operacionet e saj. Në spektrin e faktorëve të mjedisit dallohen dy grupe të mëdha, të cilët në mjaft raste veprojnë në mënyrë të ndërthurur midis tyre. Në grupin e parë bëjnë pjesë makrofaktorët e mjedisit të jashtëm, ose siç quhen shpesh në literaturën e sotme, mega mjedisi dhe në grupin e dytë përfshihen mikrofaktoret e mjedisit.

Mega mjedisi, apo mjedisi i përgjithshëm, inkludon atë grup makrofaktorësh ose atë segment të mjedisit të jashtëm që pasqyron kushtet dhe tendencat e shoqërisë brenda së cilës vepron organizata e biznesit. Në këtë grup inkludohen një sërë faktorësh, ku më të rëndësishmit janë pesë: faktorët politiko-ligjorë, faktorët ekonomikë, teknologjikë, socialë dhe ndërkombëtarë.

Këta faktorë veç e veç, ose në mënyrë të kombinuar, diktojnë kufizime apo ofrojnë oportunitete të ndryshme për biznesin. Ky realitet duhet të njihet mirë nga menaxherët, të cilët duhet të veprojnë në një mënyrë të tillë që jo vetëm të shmangin efektet e padëshirueshme, por edhe që të shfrytëzojnë me efektivitet të lartë mundësitë potenciale të krijuara prej tyre.

Faktorët politiko-ligjor; Këta faktorë të rëndësishëm përcaktojnë kuadrin ligjor dhe qeveritar si pronarë brenda të cilit operojnë organizatat e biznesit. Qeveria me legjislacionin që nxjerr, sidomos në fushën e taksave dhe politikën fiskale, ushtron një impakt shumë të madh jo vetëm në sferën e biznesit por edhe në fushat e tjera të aktivitetit të jetës shoqërore. Praktika e tregtisë, marrja dhe sigurimi në punë, veprimtaria e sindikatave, marrëdhëniet me jashtë etj, rregullohen me anën e legjislacionit në fuqi të çdo vendi. Qeveria ndërhyr në jetën ekonomike, veç të tjerave, edhe për të bërë shpërndarjen optimale të burimeve të shoqërisë, pra për të siguruar një strukturë optimale të produktit të prodhuar. Legjislacioni që nxjerr qeveria vepron si frenues apo stimulues i veprimtarisë së biznesit. Qëndrimi dhe pikëpamjet e tyre do të pasqyrohen në ndërtimin e kuadrit ligjor, në llojet dhe madhësinë e taksave dhe tarifave doganore, në kushtet favorizuese në tregtinë me jashtë, në shkallën e atraktivitetit të vendit ndaj investitorëve të huaj etj. Nga ana tjetër, shkalla e stabilitetit politik të vendit luan një rol të veçantë në zhvillimin e biznesit dhe është një faktor vendimtar në tërheqjen e biznesmenëve dhe investitorëve të huaj. Në kushtet e një destabilizimi politik ata do të preferonin të bënin biznes në vendet e tjera më të sigurta ku do të transferonin edhe kapitalet e tyre. Kështu, në vendet e Evropës Qendrore e Lindore, duke përfshirë edhe vendin tonë në fillimet e tranzicionit, kur situata politike ishte më e paqëndrueshme, fluksi i investimeve të huaja dhe i biznesmenëve seriozë ishte relativisht i vogël.

Faktorët ekonomikë; Në këtë grupim përfshihen një tërësi faktorësh, ku ndër më të rëndësishmit mund të përmendim: rritjen ekonomike, madhësinë e interesit, inflacionin, papunësinë, investimet industriale, tregun e parasë dhe të kapitalit, natyrën e

konkurrencës, strukturën industriale etj. Për të shpjeguar influencën e faktorëve ekonomikë mbi organizatat e biznesit do të përqendrohemi në katër faktorët e parë.

Përqindja e rritjes ekonomike luan rol në përcaktimin e madhësisë së kërkesës për mallra dhe shërbime. Gjatë periudhave të rritjes ekonomike kemi një zhvillim të shpejtë të biznesit, zvogëlim të papunësisë e më shumë të ardhura në duart e popullatës. E kundërta ndodh gjatë periudhave të rënies ekonomike gjatë të cilave ulet dukshëm kërkesa për mallra e shërbime të firmave, njerëzit bëhen më kursimtarë për shkak të rrezikut të papunësisë, aktiviteti i biznesit është më i vogël dhe një pjesë e tyre shkon drejt falimentimit. Gjatë periudhave kur përqindja e interesit ulet, konsumatorët janë më të gatshëm për të marrë kredi për të blerë mallra dhe shërbime që ofrojnë firma të ndryshme, për të ndërtuar shtëpi, për të filluar një biznes të tyre etj. Nga ana tjetër, firmave u koston më lire kreditimi për të zgjeruar aktivitetin e tyre të biznesit. Në kushtet kur inflacioni është i lartë, firmat e biznesit duhet të paguajnë më shumë për materialet, shërbimet e mirëmbajtjes etj. Paraja zhvlerësohet e bashkë me të mund të dobësohet edhe gjendja ekonomike e firmave. Nëqoftëse në tregun e punës paraqiten me shumë të papunë, një kërkesë e shtuar do të ndikojë në nivelin e pagës që do të ofrojnë punëdhënësit. Ndërsa kur papunësia është e ulët, oferta do të pësojë rënie dhe punonjësit e kualifikuar do të kenë avantazhin t'u kërkojnë paga më të larta firmave që do të jenë të interesuara për ta.

Ndryshimet e ndodhura në fushën sociale, jo vetëm influencojnë në ecurinë e biznesit, por edhe ato vetë evoluojnë nën ndikimin e ofertave që bën biznesi. Kështu, rritja e interesimit të njerëzve për kujdesin ndaj shëndetit ka bërë që të marrin një përhapje të gjerë jo vetëm në botë, por edhe në Shqipëri, firmat që prodhojnë dhe tregtojnë pajisje për të ruajtur një paraqitje të formë të mirë fizike, apo i firmave që

prodhojnë produkte dietetike. Prezantimi i produkteve e shërbimeve të reja në këtë fushë bën që edhe qëndrimet e njerëzve të pësojnë ndryshime e ta ndjekin dinamikën e këtyre bizneseve. Faktorët socialë veprojnë, gjithashtu, edhe si kufizues të veprimtarisë së biznesit. Kështu, ndërgjegjësimi i opinionit publik ndaj ndotjes së mjedisit ka bërë që qeveritë të nxjerrin ligje specifike për këtë qëllim, kuadri i të cilit do të plotësohet gjithnjë e më shumë në të ardhmen. Në këtë kontekst, edhe në vendin tonë, për shkak të rëndësisë së veçantë, në vend të Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit, aktualisht funksionon Ministria e Mjedisit.

Faktorët teknologjikë; Faktorët teknologjikë në tërësinë e tyre janë pasqyrimi i njohurive aktuale të prodhimit të produkteve e shërbimeve. Impakti i teknologjisë reflektohet në produktet e reja, makineritë e pajisjet bashkëkohore si edhe në shërbimet e reja. Përfitimet nga teknologjia janë të shumta, por në mënyrë të përmbledhur ato janë produktivitet dhe standard jetese më i lartë, më shumë kohe të lirë dhe varietet më të madh produktesh e shërbimesh. Në qoftë se firmat e biznesit dëshirojnë një mbijetesë të gjatë e ekspansion ekonomik, duhet të jenë gjithnjë në dijeni të ndryshimeve teknologjike të industrisë ku ato bëjnë pjesë. Njëkohësisht duhet të bëjnë edhe rinovimin e teknologjisë së tyre më përpara se konkurrentët, për të qenë sa më kompetitiv e të suksesshëm në treg. Më të vëmendshëm ndaj ndryshimeve teknologjike duhet të jenë sidomos firmat që operojnë në ato fusha të industrisë, ku edhe novacionet janë më të shpejta, sikurse është industria elektronike, e kompjuterëve etj. Përdorimi i kompjuterit sot nuk është më një luks, por një domosdoshmëri e zhvillimit të shpejtë teknik e teknologjik, e dinamizmit dhe e kompleksitetit të mjedisit për të përpunuar shpejt e saktë informacionin me qëllim që vendimet menaxheriale të kenë efektivitet të lartë. Ndryshimet teknologjike të viteve të fundit në fushën e kompjuterëve dhe të

aplikimit të tyre në marrjen e vendimeve, kanë qenë mjaft të rëndësishme. Këto novacione po e ndryshojnë tërësisht natyrën e vendit të punës. Progresi në teknologjinë e kompjuterit do t' i bëjë faktorët teknologjikë akoma më të rëndësishëm në të ardhmen.

Mjedisi ndërkombëtar inkludon zhvillimet në vendet ku realizon aktivitetin organizata e biznesit e që ushtrojnë një impakt të caktuar mbi të. Për shkak të rritjes së shpejtë të biznesit ndërkombëtar, këta faktorë po marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Faktorët ndërkombëtarë influencojnë jo vetëm mbi firmat multinacionale si IBM, Coca Cola, Ford etj, por edhe mbi firmat lokale e sidomos për ato, të cilat prodhojnë produkte të njëjta apo të ngjashme me firmat shumëkombëshe, që e kanë shtrirë aktivitetin edhe në vendin e tyre. Zhvillimet ndërkombëtare kanë ndikim jo të vogël mbi mundësitë e firmave për të zhvilluar biznes jashtë vendit të tyre. Kështu fluktuacioni i vlerës së dollarit ka ndikim mbi konkurrueshmërinë e firmave në tregun botëror. Kur vlera e dollarit është më e lartë ndaj monedhës së vendeve të tjera, kompanitë amerikane i kanë mundësitë për të konkurruar në tregun botëror, dhe e kundërta krijon mundësi për hapjen e bizneseve të reja. Në vendin tonë po rritet me shpejtësi numri i firmave të huaja që kanë aktivitet biznesi në fusha të ndryshme të industrisë, bujqësisë, turizmit etj. Përfitimet nga këto firma të huaja janë të dukshme, sepse jo vetëm që plotësohen kërkesat për mallra dhe shërbime të ndryshme e punësohen njerëzit, por edhe për biznesmenët që hyjnë në marrëdhënie me ta mësojnë si të punojnë ndryshe e t'u përshtaten rregullave të reja të lojës. Firmat shqiptare importojnë pajisje e teknologji të huaja dhe eksportojnë mallra tradicionale e lëndë të para. Të tilla transaksione kryhen sepse çdo vend ka disa produkte që i prodhon me një avantazh të caktuar ekonomik. Tregtia ndërkombëtare ofron oportunitete e fitime të mëdha dhe ndihmon për stabilizimin e çmimeve. Klima politiko-ligjore e një vendi, e



mishëruar në politikat ekonomike, nxit apo dekurajon firmat e ndryshme për të bërë biznes ndërkombëtar; për disa prej tyre ofron oportunitete e për disa të tjera kufizime e pengesa.

Gjatë shekullit XIX, veçanërisht në Amerikë, shpirti sipërmarrës mori një përhapje të gjerë. Njerëzit inkurajoheshin të ndërmerrnin përsipër riskun dhe të bëheshin sipërmarrës. Rockefeller, Morgan etj, u bënë të pasur pikërisht pse kishin këtë kurajo. Shpirti sipërmarrës bëri që biznesi të ecë më shpejt në rrugën e progresit dhe që standardi i jetesës të ngrihej më lart. Evolucionin e biznesit në shekullin XX eci me hapa të shpejta. Aktualisht sot ekziston një strukturë industriale krejt e ndryshme nga ajo e kohës së A. Smith-it. Organizatat e biznesit janë rritur e në të njëjtën kohë është zmadhuar edhe pjesa e tregut që zotërojnë firmat e veçanta. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që kompanitë e mëdha janë më të mbrojtura në luftën e konkurrencës, duke disponuar burime të konsiderueshme, ato janë në gjendje të përballojnë me sukses dështimet e përkohshme e kanë fuqi të mjaftueshme dhe gjendje financiare për të influencuar mbi mënyrën e shpërndarjes së burimeve, që t'i kushtojnë më tepër rëndësi planifikimit strategjik afatgjatë, të pranojnë humbjet afatshkurtra në funksion të fitimeve për periudhat e ardhshme, të bëjnë shpenzime relativisht të ndjeshme për të ruajtur dhe përmirësuar imazhin e tyre në sytë e opinionit publik etj. Organizmat e tilla të mëdha kanë ndikim përcaktues mbi ekonominë kombëtare. Strategjia dhe vendimet e tyre për ekspansionin ekonomik, për investimet, punësimin etj, influencojnë mbi modelin dhe shkallën e zhvillimit ekonomik të vendit.

**Para Luftës së II-të Botërore, kompanitë e naftës ishin korporatat kryesore ndërkombëtare,** kurse tani kompani të tilla ekzistojnë në shumë fusha të aktivitetit të biznesit, megjithatë ato janë primatë i përhershëm ekonomik edhe në Shqipëri.

Ndërhyrja e shtetit jo vetëm që është rritur, por ajo ka ndryshuar edhe karakterin e saj. Në fillimet e saj ndërhyrja qeveritare përqendrohej kryesisht në vendosjen e rregullave brenda të cilave duhet të operonin bizneset. Mjaft qeveri janë të interesuara edhe në vetë procesin e menaxhimit. Kështu, qeveria britanike, duke u ballafaquar për vite të tëra me krizën e bilancit të pagesave, ishte në kërkim të rrugëve dhe mjeteve për përmirësimin e eficiencës industriale dhe të stimulimit të eksportit. Ajo arriti deri në stimulimin financiar për të nxitur bashkim me kompani, me shpresën se kompanitë e mëdha të biznesit do të ishin më tepër në gjendje për të konkurruar me sukses në treg. Aspekt tjetër i ndërhyrjes së shtetit është rritja e pjesëmarrjes së biznesmenëve në këto përpjekje të saj. Shumë menaxherë biznesi të niveleve të larta të drejtimit në kompani të mëdha, tani kanë më pak kohë për tu marrë me drejtimin e kompanive të tyre, sepse një pjesë të konsiderueshme të kohës e shpenzojnë nëpër bordet këshilluese të qeverisë, në borde e komitete për industrinë e tyre apo atashohen pranë departamenteve qeveritare.

Progresi i shpejtë tekniko-teknologjik jo vetëm ka ndryshuar elementet dhe cilësitë e mjedisit ku vepron organizata e biznesit, por ka bërë që edhe ritmi i ndryshimit dhe i vjetërsimit të produkteve të jetë i lartë. Është pikërisht kjo arsyeja, që për të përballuar këto ndryshime e për të qenë më konkurrues në treg karshi prodhuesve të produkteve të njëjta apo të zëvendësuesve të tyre, kompanitë e biznesit e veçanërisht ato me përmasa të mëdha, shpenzojnë shuma të konsiderueshme për sektorin e kërkim-zhvillimit.

Aplikimi i teknologjisë së avancuar të informacionit është bërë një moment i pazëvendësueshëm për rritjen e efektivitetit të vendim-marrjes. Kompjuteri dhe interneti ka bërë të mundur realizimin e transaksioneve të biznesit *online*. Sot forma elektronike e biznesit (e-biznesi) po zgjerohet me shpejtësi dhe jo vetëm në vendet e zhvilluara.

Organizatat e biznesit veprojnë në kushtet e zgjerimit të biznesit ndërkombëtar e të funksionimit të një sërë organizatash ndërkombëtare si OPEC, NAFTA etj, si edhe të një procesi të pandalshëm globalizimi dhe aspirimi për tu integruar në kuadrin e BE. Një gjë e tillë i jep natyrë e tipare të tjera biznesit e kërkon gjithnjë e më shumë aftësi e profesionalizëm nga biznesmenët e menaxherët.

Niveli arsimor dhe kulturor i popullsisë, sidomos këtë fillim shekulli është rritur me shpejtësi. Nga njëra anë, ky fenomen ka bërë që kërkesat e njerëzve të rriten më tepër e të kërkojnë që të trajtohen më shumë si qenie sociale, si subjekt sesa si një krah punë apo objekt. Nga ana tjetër, një gjë e tillë ka influencuar që menaxhimi të dalë nga guacka e tij autokratike e të përdorë një stil lidhshipi më demokratik. Rritja e numrit të të rinjve që ndjekin universitetet e që specializohen si menaxherë, ka bërë që kompanitë e biznesit të shohin tek ky brez menaxherët e rinj me koncepte moderne. Gjithashtu, janë rritur më tepër mundësitë që ata të zgjedhin ato kompani, ku puna i tërheq më tepër e ku mund të zhvillojnë më tepër aftësitë e tyre.

Ngritja e nivelit arsimor dhe e standardit të jetesës, ka bërë që njerëzit të kenë një gamë e strukturë të re nevojash e kërkesash. Njerëzit, në këto kushte, aspirojnë më tepër për përmirësimin cilësor të jetës së tyre, për rritjen e kënaqësisë që u jep puna, për një mjedis më të pastër etj.

Shtetet dhe qeveritë e tyre sot i japin rëndësi të veçantë jo vetëm rritjes ekonomike por edhe kostos sociale që shoqëron zhvillimin ekonomik (si p.sh. ndotja e ujit dhe e ajrit etj.) dhe një gjë e tillë e pasqyruar edhe në legjislacionin qeveritar po zë gjithnjë e më tepër vend edhe në objektivat dhe planet e biznesit. Në mjaft vende të botës ekzistojnë organizata, si për shembull, Grënpeace, qëllimi i të cilave është të kontribuojnë në uljen e nivelit të ndotjes, të tjera grupe kanë si qëllim të tyre

shpërndarjen më të drejtë të të ardhurave, demokracinë industriale, pjesëmarrjen më aktive të punonjësve në menaxhim etj. Kështu, opinioni publik është ndërgjegjësuar më tepër dhe e konsideron një detyrë të mbarë shoqërisë ndërhyrjen në aktivitetin e biznesit kur organizatat nuk i plotësojnë parametrat e pranuar. Çdo devijim nga standardet e vendosura bëhet objekt diskutimi i këtij opinioni.

Gjithnjë e më tepër një organizatë biznesi nuk mund ta kufizojë veten vetëm drejt qëllimit tradicional të fitimit. Aktualisht ekziston një motiv më i gjerë që përfshin një diapazon më të gjerë përgjegjësish. Njëkohësisht pjesëmarrja e punonjësve në qeverisjen e korporatave sot është bërë fenomen mjaft i përhapur dhe pjesë integrale e legjislacionin të shoqërive tregëtare, përfshirë edhe vendin tonë.

M. Friedman, megjithëse nobelist në fushën e ekonomisë, ishte i mendimit se përgjegjësia sociale nuk shkon më tepër se përgjegjësia tradicionale. Ai theksonte: "Menaxherët janë të punësuar nga pronarët dhe jo nga publiku, prandaj, ato duhet të veprojnë në përputhje me interesin e pronarëve, për më tepër, kostot e përgjegjësisë sociale bien në kurriz të konsumatorëve në formën e çmimeve më të larta, d.m.th si taksa të pashfaqura." (M. Friedman, 1962) Ndërsa figura të tilla si A.Carnegie u bënë donatorët më të mëdhenj për çështje të ndryshme sociale, të tjerë industrialistë të pasur duke mos e pranuar përgjegjësinë sociale ndoqën shembullin e industrialistit të madh të hekurudhave H.Vandërbilt, i cili në vitin 1882 thoshte: "Unë punoj për aksionerët." Ky qëndrim i bëri që punëtorët të paguheshin keq, sigurimi në punë të ishte i pamjaftueshëm dhe që fitimi të ishte qëllimi i vetëm menaxherëve e pronarëve të tyre dhe këta "baronë" të përqendronin në duart e tyre shumë pasuri e pushtet. Këto abuzime shkaktuan reagimin e opinionit publik. Presioni i ushtruar prej tyre detyroi qeveritë, që

në fillim të shekullit kaluar të ndërhyjnë për të rregulluar me anën e legjislacionit praktikën e veprimtarisë së biznesit.

Pra, organizata e biznesit, si pjesëtare aktive e shoqërisë moderne, me qëllim që të ketë një mbijetesë të gjatë, reputacion e fitim të qëndrueshëm në planin perspektiv, duhet që t'i përgjigjet në çdo kohë pozitivisht qëndrimin kritik të opinionit publik

**Dy janë çështjet më kryesore** që dominojnë debatin e sotëm mbi vlerësimin.

Çështja e parë ka të bëjë me përqasjen (Vandell 2006). Esenca e debatit këtu është cila prej përqasjeve ofron një kuptim dhe analizë më të mirë të vlerësimit. Përqasjet konkurruese janë dy: 1) nga niveli mikro dhe, 2) nga niveli makro.

Përqasja nga niveli mikro ka përgjithësisht karakter kuantitativ (matematiko-statistikor), bazohet në disponimin e të dhënave dhe instrumenteve elektronike, dhe fokusohet në 4 elemente kryesore të pasurisë dhe vlerësimit (Kinnard 2001): kosto, shitje, kapitalizim i të ardhurave, përtëritja e çmimit të shitjes. Në esencën e tyre këto elemente marrin parasysh koston e tokës, ndërtimit apo investimit të bërë, krahasimin e çmimit dhe vlerës të pronave të ngjashme, vlerën e fitimit, amortizimin, apo ngjashmërinë e pasurive. Problemet më të spikatura me këtë përqasje janë mospërputhja shpesh mes çmimit të vlerësimit dhe vlerës së tregut apo edhe mosmarrja në konsideratë e faktoreve të tjerë influencues. Përqasja e vlerësimit nga elementi i koston ka qenë dhe mbetet një nga metodat dominuese. Por debati mbi vlefshmërinë e kësaj metode mbetet i hapur për shkak të karakterit *ad hoc* të teorisë së amortizimit. Kështu që kësaj metode, ndonëse dominuese, i është dashur të “rehabilitojë” vetveten (Vandell 2006).

Përqasja nga niveli makro ka përgjithësisht karakter kualitativ (analizë cilësore), bazohet në analizën e të dhënave që kanë të bëjnë me sjelljen dhe vendim-marrjen e

aktorëve, ambientit dhe kontekstit, impaktit të politikave të qeverisë, kuadri institucional, ligjor, politik, social të komunitetit, politikat publike (zonimi/planifikimi), apo sistemi i taksimit (Ratcliff, Kinnard 2001). Ai fokusohet në 2 elemente kryesore të vlerësimit (Kinnard 2001): dimensionin psiko-social dhe dimensionin ekonomik. Në esencën e vet dimensionin psiko-social reflekton prurjet nga shkencat sociale dhe teoritë *behavioriste* (nga fushat e psikologjisë, sociologjisë, antropologjisë) dhe tenton të analizojë dhe shpjegojë dinamikat dhe motivet në sjelljen njerëzore dhe proceset vendim-marrëse. Dimensionin ekonomik reflekton prurjet nga këndvështrimi ekonomik neoklasik dhe fokusohet në aspektin e maksimalizimit të fitimit, e më të mirës së mundshme, apo zgjedhjes optimale në vendimet që bëhen. Problemet më të spikatura me këtë përjasje janë pamundësia e verifikimit të motiveve reale prapa vendim-marrjes, aplikueshmëria problematike e nocioneve “maksimalizim” apo “optimalizim” në sjelljen e njeriut, të tregjeve, dhe në vendim-marrje. Përjasja ekonomike, sidoqoftë, mbetet mjaft e preferuar për shkak të kombinimit të shumë faktorëve të tjerë të ndryshëm me vendim-marrjen.

**Studimi im,** parë nga këndvështrimi i përjasjes, e sheh vlerësimin në kontekstin shqiptar të hidrokarbureve duke kombinuar elemente nga të dy përjasjet: nga përjasja mikro merr elementin e kostos; nga përjasja makro merr elementin ekonomik të maksimalizimit të fitimit.

Çështja e dytë ka të bëjë me faktorët influencues (Vandell 2006). Esenca e debatit këtu është se cilët faktorë shpjegojnë më mirë dinamikat që vërehen lidhur me vlerësimin. Shkolla të ndryshme identifikojnë faktorë të ndryshëm. Pak a shumë mund të dallohen 5 grupe faktoresh: 1) Financiare, nga Shkolla Klasike e Ekonomise, Shkolla Kritike, Shkolla e Ri-integritit, dhe Zhvillimet e Fundit Teorike, 2) Ekonomike, nga

Shkolla Neoklasike dhe Shkolla e Ekonomisë së Tokës, 3) Politike dhe politikave qeverisëse, nga Shkolla Klasike e Ekonomisë, Shkolla e ekonomisë së Tokës, dhe Shkolla Kritike, 4) Socio-Psikologjike, nga Shkolla Austriake e Ekonomisë dhe Shkolla e Ri-integritit, si dhe 5) Ambientalist-Gjeografik, nga Shkolla e Ri-integritit.

Në grupin e faktorëve financiarë, studiuesit vënë theksin në rolin e vlerës (Malthus), kostos (Smith), fluksit të parasë (Ellwood), investimet (Graaskamp, Kinnard), fitimi (Gibbons), termat e financimit dhe taksimit, niveli i të ardhurave (Geltner, Gilberto, Quigley) dhe opsionet e disponueshme (Wendt, Babcock, Ratcliff, Graaskamp), situata sa i takon likuiditetit dhe numrit të shitjeve (Lai, Vandell, Wang), kompanive dhe portofoleve publike (Capozza, Shilling, Gyourko, Corgel, Sirmans, Mei, Knight), derivateve (Riddiough, Ott, Childs, Titillan, Torous, Ciochetti, Vandell, Kau), apo çmimi i kontratave për Ndërtimet e ardhshme (Case, Shiller). Ndër faktorët ekonomike studiuesit dallojnë rolin e çmimit, tregjeve, shpërndarjen e burimeve, procesin e vlerësimit (Ely 1924, Schmutz 1941), indeksin e çmimeve, numri i përsëritjes së shitjes (Bailey, Muth, Nourse, Rasti, Shiller) dhe llojin e aktivitetit ekonomik (Kinnard, Fisher, Vandell, Kenney, Karvel). Ndër faktorët politike, studiuesit venë gishtin mbi sistemin e taksimit (Geroge, Mill), shpërndarjes së burimeve (Ely 1924), procesi dhe praktikat e vlerësimit (Ross, Wendt, Ratcliff, Graaskamp), apo qëndrimin e vlerësuesit (Wendt, Babcock, Ratcliff, Graaskamp). Në faktorët psiko-sociale studiuesit përfshijnë rolin e kohë-preferencës (Menger, Bawerk), nivelin e kriminalitetit, përberjen racore dhe etnike, pasigurinë e aktorëve, rolin e gjykatave, identitetin e investuesit (Kinnard 2001), apo vendim-marrje mbi buxhetin, shpërndarjen e burimeve, dhe shit-blerjen (Ellwood). Ndër faktorët ambientalist-gjeografike studiuesit nënvizojnë rolin e venddodhjes fizike dhe gjeografike (von Thunun), nivelit

të ndotjes, trafikut, dhe zhurmave, largësinë nga autostrada dhe nëntregjet e afërta, prania dhe lartësia e ndërtesave apo mundësia e përdorimit efektiv të pasurisë tokësore (Clapp, Pace, Gilley).

**Studimi im**, nga këndvështrimi i faktorëve influences, e sheh metodën e vlerësimit në sektorin e hidrokarbureve nga një përjasje e nivelit makro dhe të lidhur me rolin e 3 faktorëve kryesorë me karakter politik e psiko-sociale: 1) ekspertët vlerësues & financiare, 2) kuadri ligjor, dhe 3) rregullat kontabël. **Teza qendrore** e studimit tim në lidhje me vlerësimin për privatizim të sektorit hidrokarbur, është që cilësia e metodës së vlerësimit të përdorur në privatizimin e sektorit të hidrokarbureve në Shqipëri reflekton rolin dhe influencën jo vetëm të faktorëve ekonomikë, gjeografikë, dhe financiarë por edhe rolin e faktorëve politikë dhe psiko-sociale. Këta të fundit përcaktojnë nëse metoda e vlerësimit shfaqet e aftë ose jo për të gjeneruar një vlerë të industrisë së hidrokarbureve të destinuar për privatizim të përafërt me vlerën reale të tregjeve.

#### *2.5.3. Shkollat & Teoritë e Metodës së Vlerësimit: Çfarë i dallon nga njëra-tjetra?*

Tri janë elementet kryesore që dallojnë shkollat dhe teoritë: 1) fokusi, 2) kuptimi dhe supozimet nistore, dhe 3) modelet që ofrojnë.

Një analizë e tyre për nga fokusi nxjerr se vëmendja më e madhe i kushtohet koncepteve të tilla si “vlerë, “ “kosto, “ apo “çmim.“ P.sh, fokusi tek vlera është tipar i Shkollës Klasike dhe Shkollës së Tokës. E para elaboron kuptimin e vlerës drejt formulimit të një teorie, e dyta e merr teorinë e vlerës dhe e aplikon, teston, formalizon, dhe racionalizon. Vlera si variabël shihet të marrë forma të ndryshme si vlerë përdorimi, vlerë këmbimi, vlerë e tokës (Ely 1924) dhe shihet i lidhur me dy elemente: çmimin



(Smith, Mill) dhe procesin e vlerësimit (Scmutz 1941). Fokusi tek kostoja është tipar i Shkollës Klasike dhe Shkollës Kritike. Të dy shkollat e shohin koston si variabël me vlera të ndryshme. Por për të parën, ndryshimet në kosto reflektojnë dinamikën e tregut, ndërsa për të dytën reflektojnë rolin e agentëve dhe formulave përlogaritëse (Wendt). Fokusi tek çmimi është tipar pothuajse i të gjithë shkollave. Çmimi mund të vëzhgohet në tipe të ndryshme, p.sh i shitjes apo i tregut (Shkolla Klasike), i kapitalit (Shkolla Kritike), i indekseve apo i përsëritur (Shkolla e Ri-integrimit), apo i likuiditetit (Zhvillimet Teorike të Fundit). Si variabël i varur ai e shpreh variancën në formën “i mundshëm” apo “i mirë” (Shkolla Kritike) dhe shihet i influencuar nga dobia marginale e mallit, kohë-preferenca e aktorëve (Shkolla Austriake), raporti kërkesë-ofertë, ekuilibri i përgjithshëm (Shkolla Neoklasike), raporti kosto-përfitim (Shkolla Kritike), apo elementet mikro të tregut si natyra, kosto, vlera dhe norma e fitimit të kapitalit dhe portofoleve, historikut të paternave të amortizimit, borxheve shoqëruese, derivatëve, edhe numrit të shitjeve të përsëritura (Shkolla Ri-integrimit, Zhvillimet Teorike të Fundit).

Studimi im, nga këndvështrimi i fokusit, përqendrohet në rolin e agentëve, formulave përlogaritëse, si dhe te kuadri ligjor.

Dallime mes shkollave tregon analiza edhe kur bëhet fjalë për kuptimin që kanë ato për vlerësimin. Vlerësimi shihet si çështje vlere (punë/prodhimi) dhe vendndodhjeje (Shkolla Klasike) preference (Shkolla Austriake); si çështje ekuilibri tregjesh (Shkolla Neoklasike), përfitimi social (Shkolla e Tokës); si çështje financiare, juridike, vendim-marrjeje, apo gjendjeje fizike (Shkolla Kritike); si çështje procesesh vlerësuese (Shkolla Kritike, Shkolla e Riintegrimit, Zhvillimet Teorike të Fundit), apo edhe si çështje strukturimi të tregjeve, kompanive, aseteve, kapitaleve, portofoleve, borxheve derivatëve

(Shkolla Kritike, Shkolla Ri-integrit, Zhvillimet Teorike të Fundit). Dallimet në kuptim reflektohen edhe në supozimet e tyre nistore që qëndrojnë në themel të hipotezave dhe modeleve teorike që ofrojnë. Sipas këndvështrimit të Shkollës Klasike, vlera që rezulton nga vlerësimi reflekton koston e prodhimit (fiziokratët), vlerën e krijuar nga tregtia (merkantilistët), ndërveprimin e forcave ekonomike (Smith) vlerën e tokës (Malthus, Rikardo), pozicionin gjeografik (Thunun) dhe kontributin e forcave të jashtme (Mill). Sipas Shkollës Austriake dhe asaj Neoklasike, vlera reflekton kohe-preferencën për një mall specifik, raportin të ardhura-kursim-shpenzim (Baverk, Menger, Wieser) dhe balancën kërkesë-ofertë (Marshall). Shkolla e Tokës ngrihet mbi supozimin se vlera reflekton lidhjen me tokën (Ely, Moorhouse), përfitimin social apo privat, dhe rolin e qeverisë (Ely 1924). Shkolla Kritike ngrihet mbi supozimin se vlerësimi reflekton influencën e dimensioneve financiare, juridike, fizike (Thurston, Ross), të kushteve specifike që kanë të bëjnë me normën e fitimit, hipotekimin, apo zhvlerësimin (Schmutz 1941, Ellwood, Gibbons), si dhe të vendim-marrjes (Kinnard 2001). Shkolla Ri-integrit, supozimeve të Shkollës Kritike ju shton edhe supozimin që vlerësimi reflekton rolin e faktorëve ambientale, sociale, si dhe të komponentëve që kanë të bëjnë me procesin dhe përlllogaritjen e vlerës (Laronge, Wandell).

Studimi im, nga këndvështrimi i kuptimit dhe supozimeve nistore, e kupton vlerësimin dhe metodën si një element me dimension sa financiar aq edhe juridik e politik. Supozimet mbi të cilat ngrihet studimi im qëndrojnë afër me supozimet e Shkollave Kritike dhe Ri-integruese, pra që beson se vlerësimi dhe metodat reflektojnë rolin e faktorëve financiarë, juridikë, dhe fizikë.

Shkollat ofrojnë gjithashtu edhe modele teorike të ndryshme. Mund të flitet për 4 teori kryesore: 1) të vlerës, 2) të interesit, 3) të kostos, dhe 4) të opsioneve reale. Esenca

e Teorisë së Vlerës është që vlerësimi dhe vlera përfaqësojnë vlerën e komponentëve në tërësi. Në Teorinë e Interesit vlera dhe vlerësimi përfaqësojnë dinamikën në kohë-preferencën e individëve. Në Teorinë e Kostos, vlera dhe vlerësimi përfaqësojnë kombinimin e vlerës aktuale (bazë apo të prodhimit) me vlerën e ardhshme (të shtuar). Teoria e Opsioneve Reale e sheh vlerën dhe vlerësimin si reflektim i alternativave që ekzistojnë në një moment të caktuar në treg.

**Studimi im** konsiston në kombinimin e elementeve nga të katër teoritë dhe e sheh vlerën dhe vlerësimin si produkt jo vetëm të vlerës, interesit, kostos, dhe opsioneve reale por edhe si reflektim i cilësisë së rolit të aktorëve (ekspertë), dhe instrumentave (ligj, rregulla kontabël).

### **KAPITULLI III**

#### **SEKTORI I HIDROKARBUREVE DHE NDIKIMI I PRIVATIZIMIT NË PERFOMANCËN MAKROEKONOMIKE**

##### **3.1.Globalizimi si koncept dhe si realitet i pashmangshëm në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare**

Kur flasim për tranzicionin ekonomik, nuk duhet menduar vetëm ashtu si të tillë, pasi qysh me rënien e murit të Berlinit, është bërë një tranzicion i madh edhe për nga aspektet dhe fushat e ndryshme të jetës, p.sh, është bërë ndryshim i madh për nga aspekti i stilit të jetesës, kulturës në përgjithësi, ndikimit të madh që po bën teknologjia informatike, lëvizjet më të shpeshta të qytetarëve anembanë botës, qoftë për qëllime shkollimi, zhvillimi tregtie, etj. Me fjalë të tjera, koha në të cilën po jetojmë, është kohë ku para se gjithash dominojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. I tërë ky proces po reflekton edhe në zhvillimin e aktiviteteve të pavarura ekonomike edhe në mes vendeve të ndryshme të botës (ashtu siç u përshkrua edhe në pjesën e dytë të këtij punimi, ku bëhej fjalë për IJD-të). I tërë ky korrelacion ka shkuar deri tek një proces i globalizimit të përgjithshëm. Me fjalë të tjera, me nocionin “*globalizim*”, nënkuptojmë shndërrimin e ekonomive kombëtare në ato ndërkombëtare. Kur themi të ekonomive, nuk duhet kursesi t’i mendojmë vetëm bashkëpunimin në mes sektorëve të caktuar të ekonomisë, por edhe në nivele të kompanive, agjencive, individëve të pavarur, bile bile, edhe jashtë sferës dhe qëllimeve ekonomike, p.sh. në edukim, kulturë, sport, etj. Ka shumë mendime rreth shfaqjes së fenomenit të globalizimit, mirëpo lirshëm mund të konkludojmë se globalizimi është shfaqur nga shumë arsye të ndryshme, si, p.sh,

zhvillimi dhe aplikimi i sistemit kapitalist, hapja e kufijve dhe lëvizja e lirë, interesi i kompanive për të vepruar me shkallë më të lartë të eficiencës, etj.

**Ndikimi i krizës globale në vendet e Evropës Jug-lindore;** Një sërë vendesh të Evropës Jug-lindore, që mund t'i klasifikojmë dhe t'i emërojmë edhe si “grupi” i vendeve të Evropës Juglindore, janë ndikuar nga recension i ekonomik (Prica, 2009). Në vijim do e paraqesim një tabelë të disa vendeve të Evropës Jug-lindore se si kriza ekonomike ka ndikuar në disa agregatë makroekonomike të këtyre vendeve.

**Tabela 5. Ndikimi i krizës globale në disa nga vendet e Evropës Jug-lindore**

| Vendi            | Rritja reale ekonomike (GDP %) |      |      |                       | Ndryshimet në prodhimet industriale (2008-2009) | Rritja në % e papunësisë 2008-2010 |
|------------------|--------------------------------|------|------|-----------------------|-------------------------------------------------|------------------------------------|
|                  | 2008                           | 2009 | 2010 | 2009-2010 (mesatarja) |                                                 |                                    |
| <b>Shqipëria</b> | 7.7.                           | 3.3  | 3.0  | 3.2                   | -                                               | -                                  |
| <b>Mali i zi</b> | 7.5                            | -5.7 | -0.6 | -3.2                  | 1.5                                             | -                                  |
| <b>Kroacia</b>   | 2.4                            | -5.8 | -1.5 | -3.7                  | -9.2                                            | 3.4                                |
| <b>Maqedonia</b> | 4.8                            | -0.8 | 0.8  | 0.0                   | -                                               | -                                  |

**Burimi:** Manuali Ekonomik, Volumi LVI, Nr. 191 / tetor – dhjetor 2011

Siç mund të vërehet në tabelë; Shqipëria e ka mbajtur në një “konstante” rritjen ekonomike pasi që përgjatë vitit 2009-2010, edhe pse e krahasojmë me vitin 2008, rritjen reale e kishte dukshëm më të mirë, pothuajse ka pasur fare pak recension, sidomos nëse e krahasojmë me Malin e zi i cili pëson recension të dukshëm në vitin 2009, sidomos nëse e krahasojmë me rritjen që e ka pasur në vitin 2008 me një normë prej 7.5%, dhe rënie një vit pas në -5.7%.

Kroacia po ashtu është goditur në vitin 2009, pasi që shënon rënie ekonomike prej -5.8%, për ta përmirësuar një vit më pas në një rënie më të ulët 1.5%.

Maqedonia, në krahasim me vendet e tjera të prezantuara në tabelë, sidomos nëse e krahasojmë vitin 2009-2010, nuk ka pasur as rritje dhe as rënie ekonomike, pasi që në

vitin 2009 kishte rënie prej -0.8%, ndërsa në vitin 2010 rritje ekonomike prej 0.8%, që në raport i bie 0.0%.

Sa i përket rënies së numrit të të papunëve, të dhënat janë evidentuar nga institucioni që e ka zhvilluar hulumtimin, vetëm për Kroacinë, së cilës norma e papunësisë ka shënuar rritje prej 3.4%. Edhe pse nuk kemi të dhëna faktike, por në mënyrë hipotetike, mund të themi se me siguri ka pasur ndikim në rritjen e papunësisë edhe në vendet e tjera të prezantuara në tabelën 4, sidomos kur i marrim parasysh edhe statistikat e rritjes së papunëve edhe në shtetet e BE-së, si p.sh., në Greqi, Spanjë, Itali, etj.

**Tabela 6. Disa nga treguesit kryesorë makroekonomik të gjendjes së tanishme pas dhe gjatë fazës së tranzicionit ekonomik në Shqipëri**

| Indikatorët       | Përshkrimi | Viti | Periudha           |
|-------------------|------------|------|--------------------|
| (% GDP)           | 5.41       | 2014 | ¼ kalendarike      |
| Papunësia         | 14.64      | 2014 | Përafërsisht mujor |
| Inflacioni        | 3.21       | 2014 | Përafërsisht mujor |
| Norma e interesit | 5.48       | 2014 | Përafërsisht mujor |
| Bilanci tregtar   | -16.485    | 2014 | Përafërsisht mujor |
| Buxheti i shtetit | -3.50      | 2013 | Vjetor             |

**Burimi:** Manuali Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Republika e Shqipërisë 2016

**Ndikimi i globalizimit në aspektet mikroekonomike të ekonomisë, në veçanti në vendet që po kalojnë tranzicionin ekonomik;** Globalizimi ekonomik, ka ndikuar që bizneset dhe kompanitë të fillojnë ta ndryshojnë mentalitetin e tyre për nga qasja ekonomike (Domniku, 2010). Në veçanti vendet të cilat kanë kaluar ose po e kalojnë tranzicionin ekonomik, ka ndikuar që shumë ndërmarrës dhe menaxherë të ballafaqohen me probleme të shumta të cilat ndërthuren dhe ndërlidhen me konkurrencën globale, e cila dita ditës sjell novacione të cilat ua vështirësojnë ndërmarrësve që të luftojnë kundër llojllojshmërisë së produkteve dhe shërbimeve të huaja, pastaj, çmimeve që

ofrohen me një çmim shumë më të lirë sesa ndërmarrësit të cilët operojnë dhe sigurojnë produkte kryesisht vendore ose të importuara nga vendet fqinje ose edhe nga vet konkurrentët e tyre.

Sipërmarrja për nga aspekti i avantazhit konkurrues, është që të arrijë të sigurojë produkte ose shërbime për konsumatorët e tij, me çmimin kryesisht të njëjtë dhe cilësi natyrisht të mirë. Secili biznes i caktuar, pavarësisht veprimtarisë, madhësisë dhe formës së tij ligjore, duhet të ketë marrëdhënie me qeverinë, qoftë atë lokale ose atë qendrore. Një ndërmarrje duhet në radhë të parë ti respektojë normat juridike në aspekt të veprimeve të saj dhe në radhë të dytë të jetë likuide në aspektin e shlyerjes së të gjitha obligimeve financiare ndaj shtetit. Nëpërmes ligjeve shteti rregullon kushtet mbi të cilat duhet të veprojnë ndërmarrjet, mirëpo këto kushte gati gjithmonë kanë ndikim në rezultatin financiar të këtyre ndërmarrjeve. Nëse qeveria e një vendi përcakton një normë më të lartë të tatimeve, p.sh. tatimit në fitim, atëherë automatikisht kjo mund të ndikojë që të startohet hyrja e konkurrentëve ose firmave të reja në treg të cilat ushtrojnë veprimtaritë e caktuara, e veçanërisht e bizneseve të vogla. Si pjesë tjetër e politikës së një shteti mund të jenë, politika restriktive dhe ekspansive fiskale, p.sh, shteti mund të aplikojë masa lehtësuese të hyrjeve të reja por njëkohësisht edhe të përdor masat frenuese të cilat zakonisht mund ti aplikojë nëpërmes doganimit dhe barrierave hyrëse në treg.

Si pjesë e autoritetit shtetëror është edhe banka qendrore e një vendi, e cila ndikon në rregullimin e normave të interesit nëpërmes politikës monetare, p.sh, nëse banka qendrore e një vendi përcakton kushte që bankat tregtare të një vendi të ofrojnë kredi me norma të interesit më të ulëta, atëherë në këtë rast për biznese do të krijohen kushte më të mira të kreditimit, që nëpërmes këtyre kredive bizneset do të mund të mendonin

për rritjen e kapaciteteve të prodhimit. Mirëpo në shumë raste banka qendrore si pasojë e rritjes së inflacionit ndikon që normat e interesit të rriten, që nëpërmes këtyre veprimeve ndikohet që të zvogëlohet sasia e qarkullimit të parasë në treg. Në këtë rast firmat e biznesit do të zvogëlojnë kapacitetin e tyre të prodhimit, si pasojë e ofertave kredituese jo të volitshme.

***Ndikimi i politikës në zhvillimin e sipërmarrjes dhe sektorit privat;*** Politika pothuajse ka rolin kryesor në ndryshimin e një gjendjeje të caktuar ekonomike në një vend. Një politikë e cila inkurajon iniciativën private, favorizon tregtinë e jashtme, mundëson transferimin e pronës shoqërore tek ajo private, krijon një ambient të sigurt për investitorët potencialë e veçanërisht për ata të jashtëm, është një politikë jetike që një vend i caktuar dhe bizneset e këtij vendi arrijnë prosperitetin e tyre, rimëkëmbjen ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit ekonomik në vend (Worthington, 2005). Përvoja më e mirë e cila e dëshmon këtë fakt, është përvoja e vendeve ish-socialiste ajo të cilën e përmendem në kapitullin e parë të këtij punimi, si p.sh, Sllovenia, Hungaria, Çekia, etj, të cilat nëpërmes vendimeve efektive politike, kanë ndikuar në transferimin e sistemit ekonomik dhe rritjen ekonomike në vendet e tyre.

***Ndikimi i faktorëve ekonomikë (me theks të veçantë të politikës fiskale dhe monetare) në zhvillimin e sektorit privat;*** Faktorët ekonomikë zakonisht manifestohen nëpërmes; ndryshimeve në treg, rritjes reale ekonomike, normave të interesit, konkurrencës, papunësisë, etj. Rritja reale ekonomike ka një rol të rëndësishëm në përcaktimin e madhësisë për mallra dhe shërbime. Zakonisht kur shënohet rritje ekonomike, rriten të gjitha aktivitetet ekonomike që përfshinë edhe rritjen e fuqisë blerëse (*njëra nga 5 forcat e Porterit*) dhe në anën tjetër ndikon në rritjen e punësimit. Në rastet kur kemi recension ekonomik, atëherë kemi edhe rënie të kërkesës për mallra



dhe shërbime, kështu që si rezultat i kësaj shumë biznese ballafaqohen me likuidim përkatësisht falimentim (Mustafa, 2006).

Në rastet e **ekspansionit ekonomik** tek ndërmarrjet kjo mund të manifestohet në disa mënyra, p.sh:

- bizneset financojnë fushata të ndryshme të marketingut në mënyrë që të rrisin numrin e klientëve.
- bizneset me çdo kusht tentojnë ti mbajnë punëtorët e tyre, sidomos ata të kualifikuarit duke i paguar dhe motivuar mirë dhe njëkohësisht duke investuar në formimin dhe zhvillimin e tyre profesional.
- bizneset përpos që rrisin sasinë e stokeve, mendojnë edhe në rritjen e ofertës së tyre duke ofruar produkte dhe shërbime të reja, rritjen e shkallës së investimeve, etj.

Në rastet e **recensionit**, tek ndërmarrjet kjo mund të manifestohet në disa mënyra, p.sh:

- bizneset kërkojnë të blejnë sa më lirë dhe të shesin sa më shtrenjtë.
- bizneset tentojnë që punëtorët ti paguajnë me paga sa më të ulëta.
- bizneset reduktojnë sasinë e stokeve të tyre, dhe minimizojnë shkallën e investimeve.
- bizneset reduktojnë menunë (zgjedhjen) e ofertës së tyre, etj.

### ***Ndikimi i faktorëve të kulturës dhe sjelljes në fazat e tranzicionit ekonomik, por edhe më gjerë***

Të veprosh në një ambient të caktuar, dhe të ofrosh produkte ose shërbime një caku të caktuar të tregut, është e domosdoshme që ta njohësh edhe kulturën e tij. Me termin kulturë nënkuptojmë dijen, përvojën, besimin, vlerën, sjelljet, etj, të një individi ose grupi të caktuar. Kultura nuk është diçka unike, kështu që nënkupton se secila shoqëri e ka kulturën e vet. Secili ndërmarrës i mirë, duhet të di ti përshtatet faktorëve

kulturorë, në mënyrë që të realizojë afarizmin në mënyrën më të mirë. Qëndrimet jokorrekte ndaj një kulture mund të bëhen pengesë e madhe në realizimin e procesit të punës dhe arritjes së objektivave të biznesit.

### 3.1.1. Relacioni në mes IJD-së dhe privatizimit ne aspektin global

Që të dyja, IJD-të dhe privatizimi janë komplekse fenomenale. Pikërisht për këtë arsye në këtë pjesë nuk do të trajtohen veçmas këto dy fenomene, por do të analizohen për nga aspekti se si ndikojnë duke i përfshirë edhe pjesëmarrjen e investitorëve të huaj, ndikimin e tyre në stabilitetin ekonomik, etj. Në vijim, përmes paraqitjes tabelore do paraqesim korrelacionin në mes IJD-së dhe privatizimit:

**Tabela 7. Ndikimi i privatizimit në rritjen e investimeve të jashtme direkte në disa nga vendet të Evropës qendrore, lindore dhe jug-lindore (vlerat janë të shprehura në milionë dollarë amerikanë \$)**

| Vendi                 | Indikatori                   | 1993 | 1994 | 1995 | 1996 | 1997 | 1998 | 1999 | 2000              | To<br>tali    |
|-----------------------|------------------------------|------|------|------|------|------|------|------|-------------------|---------------|
| <b>Kroacia</b>        | Privatizimi në raport me IJD | -    | -    | 88   | 105  | 83   | 437  | 320  | 591               | 18<br>17      |
| <b>Republika Çeke</b> | Privatizimi në raport me IJD | -    | -    | 654  | 869  | 2562 | 1428 | 1300 | 2540<br>4877      | 14<br>23<br>0 |
| <b>Hungaria</b>       | Privatizimi në raport me IJD | 1459 | 1417 | 2339 | 1146 | 4453 | 1788 | 1811 | 1410<br>/167<br>5 | 17<br>55<br>2 |
| <b>Maqedonia</b>      | Privatizimi në raport me IJD | -    | -    | -    | 20   | 1    | 5    | 9    | 113               | 14<br>8       |

**Burimi:** Manuali Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Republika e Shqipërisë 2016

Shumica e studimeve në lidhje me tranzicionin ekonomik, kanë dëshmuar se IJD-të janë forma më efektive që privatizimi të implementohet sa më mirë. (Frydman, 1997). Por më fazën e hershme të tranzicionit, konsideratat jo-ekonomike (barazia shoqërore dhe nevoja për ndërrimin e shpejtë të pronësisë), ishin më të rëndësishme për disa qeveri të vendeve që kalonin nëpër tranzicionin e përgjithshëm, përfshirë edhe atë ekonomik. Vendet nën presionin dhe nevojën financiare, ishin të detyruara që të zvogëlonin deficitin buxhetor, duke i rritur të ardhurat nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Kjo ndodhi në Hungari në vitet '95 dhe '96, pastaj në Çeki dhe Rumani, e në veçanti në vendet e Evropës juglindore në vitin 1999, si rezultat i krizës së atëhershme në Kosovë.

### **3.2. Ndikimi i privatizimit në performancën makroekonomike të Shqipërisë**

Shqipëria vlerësohet të ketë rezerva relativisht të larta të naftës, që arrijnë deri në 400 milionë tonë, por kjo mbetet ende e pakonfirmuar, për shkak të investimeve të larta që kërkohen për kërkim. Sipas Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore është e njohur se 40 milionë tonë janë të pashfrytëzuara, ndërsa 50 milionë tonë janë tashmë të shfrytëzuara. Patos Marinza është zona kryesore e naftës në Shqipëri dhe më e madhja në tokë në Evropë, me një sipërfaqe prej rreth 17.8 mijë hektarësh dhe rezervat e saj të provuara janë rreth 5.4 miliardë fuçi naftë. Nafta bruto e Patos Marinzës shitet me një zbritje prej rreth 50-60% ndaj naftës referencë evropiane Brent, për shkak të natyrës së saj të rëndë.

Pas viteve '90, kompanitë e huaja kanë treguar interes të vazhdueshëm për të investuar në fushat e naftës në Shqipëri, përmes marrëveshjeve koncesionare me

qeverinë shqiptare dhe kompaninë shtetërore Albpetrol, të angazhuar në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e naftës bruto dhe gazit.

Qeveria ka marrëveshje për eksplorimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit me kompani të tilla si: Islandrockall JV. dhe Australian Beach Petroleum Ltd, Capricorn Albania Ltd, një degë e kompanisë Cairn Energy Company, Petromanas Albania GmbH, Bankers Petroleum Albania dhe Sky Petroleum.

Marrëveshje të tjera janë nënshkruar për prodhimin dhe zhvillimin e fushave ekzistuese të naftës dhe gazit me Bankers, Stream Oil & Gas, Sherwood International Petroleum dhe IEC Visoka. Bankers Petroleum prodhon naftë që prej vitit 2014, ndërsa Stream Oil & Gas ka filluar aktivitetin prodhues gjatë viteve të fundit. Kompanitë e tjera janë ende në fazë shfrytëzimi për rezerva të reja nafte, në tokë dhe në det.

Por, sa ka fituar deri tani vendi nga shfrytëzimi i kësaj pasurie mjaft të madhe natyrore që mbart nëntoka shqiptare?!

### **Bankers Petroleum**


Bankers Petroleum ka pozicionin kryesues aktualisht – ai është operatori i vetëm në Patos Marinzë, duke prodhuar 1.06 milionë tonë naftë në vitin 2013, sipas të dhënave të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, nga 1.2 milionë tonë, që ishte prodhimi gjithsej po atë vit.

Kompania ka shënuar rritje të shpejtë të aktivitetit të saj në vite, duke u bërë aktualisht sipërmarrja më e madhe në vend për sa i përket qarkullimit vjetor.

Në vitin 2013, xhiroja e kompanisë (Të ardhurat e akorduara me deklaratimet tatimore PDF për efekt të TVSH-së), arriti një nivel rekord prej rreth 68 miliardë lekësh

(484 milionë euro), me një rritje prej 28% me bazë vjetore, sipas bilancit të saj të vitit 2013.

**Grafiku 1. Prodhimi i naftës bruto në Shqipëri v.1990-2013 (ton) :**




**Burimi:** Manuali Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Republika e Shqipërisë 2015

Kompania rezulton me një tatim fitimi kontabël të shtyrë prej 8.2 miliardë lekësh në 2013 (rreth 60 milionë euro), nga 6.5 miliardë lekë në 2012-n.

Por, sipas shpjegimit në bilancin e saj të vitit 2013, “rezultati tatimor i shoqërisë nuk llogaritet sipas ligjit ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ por, bazuar në marrëveshjen e Hidrokarbureve lidhur midis Albpetrol sh.a. dhe Bankers (në atë kohë i quajtur me emrin tregtar Saxon International Energy) që është aprovuar me VKM 77, datë 16.07.2004. Në këtë marrëveshje neni 13 (1) përcaktohet që kontraktori (Saxon) është përgjegjës që të llogarisë dhe të paguajë tatimin mbi fitimin në përputhje me ligjin 7811, datë 12.04.1994 ‘Për aprovimin e dekretit 782, datë 22.02.2004 ‘Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve’. Sipas nenit 2 të këtij ligji, për periudhën e kërkimit dhe zhvillimit,

rezultati llogaritet pasi nga të gjitha të ardhurat të zbriten paraprakisht të gjitha shpenzimet operative dhe kapitale të bëra nga nënkontraktori.

**Grafiku 2. Prodhimi i naftës sipas kompanive v.2013 (ton):**



**Burimi:** *Manuali Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Republika e Shqipërisë 2015*

Po kështu, në këtë legjislacion paraqitet dhe mënyra e llogaritjes së tarifës dhe të tatimit mbi fitimin, të cilën e grumbullon për llogari të shtetit shqiptar Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve (aktualisht Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore). Në Marrëveshjen e Hidrokarbureve, përcaktohet në aneksin B dhe procedura e llogaritjes së kostove dhe të ardhurave nga ana e Bankers për llogaritjen e fitimit. Kjo është dhe baza e përdorur për llogaritjen e rezultatit të shoqërisë Bankers Petroleum Albania Ltd për vitin 2013. Aplikimi i tatimit në masën 50% dhe jo në masën 10% i njohur sipas legjislacionit tatimor shqiptar është bërë pasi ka marrë në konsideratë marrëveshjen koncesionare, ku në dallim nga legjislacioni aktual shqiptar njihen si shpenzime të njohura për efekte tatimore, përveç shpenzimeve të periudhës të cilat sjellin të ardhurat në po atë periudhë dhe vlera të tilla si: Kosto të ndërtimit të aktiveve afatgjatë; Kosto e inventarëve që përdoren në procesin e ndërtimit të aktiveve afatgjatë dhe prodhimit;

Kosto e përmirësimit të aktiveve afatgjata materiale; komisionet bankare; diferencat nga këmbimi të njohura sipas legjislacionit shqiptar fiskal etj”, thuhet në raportin vjetor të kompanisë për vitin 2013.


Në lidhje me Tatim fitimin aktual / “Në vijim të Marrëveshjes së Hidrokarbureve e lidhur midis Albpetrol sh.a. dhe Bankers, për periudhën e kërkimit dhe zhvillimit, rezultati llogaritet pasi nga të gjitha të ardhurat zbriten të gjitha shpenzimet operative dhe kapitale të bëra nga nënkontraktori. Po kështu, në këtë legjislacion paraqitet dhe mënyra e llogaritjes së tarifës dhe të tatimit mbi fitimin, të cilën e grumbullon për llogari të shtetit shqiptar Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve (aktualisht Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, AKBN). Në vijim të sa më sipër, Bankers Petroleum Ltd komunikon çdo vit me AKBN deklarin e humbjes së periudhës si dhe humbjen e mbartur deri në datën e raportimit. Ky deklarin, sipas marrëveshjes së mësipërme, quhet përfundimtar në rast se nuk ka në përgjigje negative prej AKBN brenda 3 viteve nga data e përgatitjes së PF dhe e llogarive”, thuhet në raportin vjetor të Bankers. Humbja e tatueshme, e deklaruar nga Bankers për vitin 2013, është 142 milionë euro, sipas bilancit të saj dorëzuar tek autoritetet shqiptare. Ndërsa në raportin vjetor publikuar në faqen e saj të internetit dhe që deklarohet edhe në Bursën e Torontos, kompania deklaron të ardhura neto për vitin prej 61.7 milionë dollarësh dhe fitim për aksion prej 0.24 dollarësh.

Në gjashtë vjet (nga 2008-a, kur Bankers figuron për herë të parë në listën e kompanive më të mëdha në vend deri në 2013-n), kompania ka siguruar të ardhura nga shitja e naftës shqiptare në vlerën e 1.4 miliardë eurove, rreth 14% e Prodhimit të Brendshëm Bruto të një viti. Nga ana tjetër, ndikimi në ekonomi ka qenë disa herë më i ulët, si në drejtim të krijimit të vendeve të reja të punës, (kompania kishte 522 punonjës

direkt në fund të vitit 2013, sipas bilancit të saj) ashtu dhe të ardhurave në buxhet. Sipas bilancit vjetor 2013, e drejta minerare e paguar prej saj ishte 60 milionë euro në 2012-n dhe 70 milionë euro në 2013-n.

Deri në fund të vitit 2013, kompanitë e hidrokarbureve ishin të përjashtuara nga TVSH si në fazën e kërkimit ashtu dhe atë të prodhimit (shfrytëzimit), ndërsa nga 1 janari 2014 ato përjashtohen vetëm për fazën e kërkimit.

**Grafiku 3. Qarkullimi vjetor i Bankers Petroleum (miliard lekë) :**



**Burimi:** Manuali Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Republika e Shqipërisë 2014

**Stream Oil & Gas ;** Stream Oil & Gas Ltd është kompania e dytë më e madhe në vend e prodhimit të naftës, pas Bankers Petroleum. Ajo shfrytëzon 4 vendburime të njohura naftë dhe gazi në Shqipëri, atë të Ballsh-Hekalit, Gorisht-Koculit dhe Cakran-Mollajt në naftë, si dhe fushën gazmbajtëse të Delvinës, në bazë të një kontrate koncesionare 25-vjeçare, më të drejtë zgjatjeje 5-vjeçare. Pas një rritjeje të shpejtë nga viti 2009, kur nisi prodhimin e naftës, në 2013 Stream Oil & Gas raportoi rënie të lehtë të të ardhurave, me rreth 4.5%, në 25.5 milionë euro. Kompania deklaroi humbje të mëdha prej 1.9 miliardë lekësh (rreth 13.5 milionë euro), nga 334 milionë lekë në 2012-




n, për shkak të rritjes së ndjeshme të zërit të shpenzimeve “mallra, lëndët e para dhe shërbimet”. Në raportin vjetor të vitit 2013, Stream Oil & Gas Ltd shpjegon dhe konfliktin me qeverinë e re, që ka ndikuar në frenimin e prodhimit: “Kompanisë iu desh të përballej me një mjedis sfidues biznesi në vitin 2013, në lidhje me qeverinë e re të zgjedhur në Shqipëri. Si pjesë e këtij ndryshimi, qeveria e re, përfshirë Albpetrol sh.a. dhe Agjencinë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), kishin një periudhë transitore që rezultoi në shtyrjen e zgjidhjes së çështjeve kyçe të lidhura me neutralizimin e taksave dhe transferimit të fushës së naftës Ballsh-Hekal të Stream. Në fund të vitit 2013, qeveria e re shqiptare konfirmoi mbështetje për kompaninë dhe ra dakord që të zgjidhë çështjet në fjalë në një mënyrë të shpejtë, përfshirë fillimin e procedurave të menjëhershme për transferimin e fushës së Ballsh-Hekal të Stream”.

Konflikti me qeverinë e re shqiptare lidhet me faktin se kompania, ndonëse i shfrytëzon këto burime prej disa vitesh, nuk ka paguar detyrimet që i rrjedhin nga marrëveshja koncesionare, lidhur me ndarjen e prodhimit me Albpetrol.

Sipas raportit vjetor të kompanisë, më 30 nëntor 2013, qeveria u angazhua me Stream për të negociuar midis Stream dhe Albpetrol lidhur me rentën e papaguar dhe prodhimin e dorëzuar. Në fund të negociatave ka rezultuar që detyrimi i Stream ishte 9.4 milionë dollarë.

Kompania rezulton të ketë paguar një rentë prej 2.7 milionë eurosh në 2013-n, sipas bilancit të saj dhe kishte 407 punonjës, nga 435 në 2012-n.

**Grafiku 4. Qarkullimi vjetor i STREAM OIL & GAS LTD ( miliard lekë ) :**



**Burimi:** Manuali Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Republika e Shqipërisë 2015

**Interesi i rritur për naftën shqiptare dhe marrëveshjet e ardhshme;** Pasi kompania Petromanas, së bashku me Shell (që ka 75% të të drejtave) raportoi për zbulim të suksesshëm të gazit dhe naftës në Shpirag-2, në fund të vitit 2013, interesi i kompanive të huaja për të hyrë në këtë sektor në Shqipëri u rrit ndjeshëm. Brenda këtij viti pritet të hapet ankandi për blloqet e lira të naftës dhe gazit në vend. Me miratimin e projektligjit për kalimin e blloqeve të lira nga Albpetrol, në Agjencine Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), i hapet rruga fillimit të procedurave për dhënien me konkurrim të këtyre blloqeve. Paralelisht po përgatitet edhe një set rregullash mbi të cilat do të zhvillohet procedura konkurruese. Duke qenë se shteti dhe qytetarët shqiptarë rezultojnë të kenë dalë dukshëm humbës nga marrëveshjet e deritanishme për koncesionin e pasurive natyrore, për atë pjesë të konsiderueshme të naftës të

pashfrytëzuar, që pritet të jepet sërish në koncesion, institucionet përgjegjëse shtetërore duhet të negociojnë fort që kontratat e nënshkruara të mos jenë me përfitim të njëanshëm.

### **3.3. Historiku i privatizimit të shoqërisë ARMO sh.a**

Shoqëria publike ARMO sha, u privatizua në vitin 2008 me shitjen e 85 % të aksioneve që ishin në pronësi të shtetit shqiptar. Furnizimi i ekonomisë me nënprodukte naftë dhe gaz realizohet nga prodhimi vendas dhe importi. Megjithatë prodhimi vendas i nënprodukteve të naftës e gazit plotëson rreth 37-38% të nevojave të ekonomisë, ai luan një rol të rëndësishëm jo vetëm për vendosjen e ekuilibrave të drejta në furnizimin e sektorëve, por dhe për të ndikuar që luhatjet e çmimeve të mos dalin jashtë kontrollit. Në këto kushte shteti, ka stimuluar vazhdimisht rritjen e prodhimit nga shoqëritë “Albpetrol Sh.a.” dhe “ARMO Sh.a.” duke mbështetur dhe reformat e marra për rritjen e efektivitetit të tyre. Kompania ARMO SH.A është krijuar në vitin 1999 me kapital 100% shtetëror. Është e vetmja kompani, që kryen përpunimin e naftës në Shqipëri nëpërmjet dy rafinerive: rafineria Ballsh dhe rafineria Fier. Kompania përpunon naftën e nxjerrë në vend nga kompanitë: Albpetrol (me kapital 100% shtetëror), Bankers Petroleum Albania dhe Streampetroleum.

Në vijim të ristrukturimit të shoqërisë ARMO, për përgatitjen e saj për privatizim në vitin 2008 një pjesë e aseteve ekzistuese të kësaj shoqërie (disa Degë të Shpërndarjes së Karburanteve në rrethe), me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës u shkëputën nga kapitali i kësaj shoqërie. Me këtë pjesë të kapitalit në

formën e aseteve, të shkëputura nga shoqëria ARMO u krijua shoqëria PETROL ALBA sh.a, me seli në Tiranë. Shoqëria “PETROL ALBA” sh.a, Tiranë, është krijuar me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, nr.296, datë 29.04.2008 “Për krijimin e shoqërisë “PETROL ALBA” sh.a, Tiranë, me kapital të nënshkruar 1.166.768.000 lekë, aksione me vlerë nominale 1.000 lekë, e cila krijohet me transferim kontributi nga aktivi nëpërmjet zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë “ARMO” sh.a, Tiranë. Me Ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, datë 03.06.2008, është regjistruar shoqëria “PETROL ALBA” sh.a, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (data e regjistrimit 06.05.2008), me kapital themeltar 1.166.768.000 lekë, me objekt veprimtarie: “Magazinimi, tregtimi me shumicë dhe pakicë i karburanteve dhe nënprodukteve të tyre”, mbështetur në të dhënat e bilancit raportues të shoqërisë PETROL ALBA sha, për vitin 2011 përshkruhet se : Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe 7 filiale ose Degët e Shpërndarjes së Karburanteve (D.SH.K.) në rrethet: Tiranë, Lac, Lushnjë, Elbasan, Pogradec, Gjirokastrë dhe Sarandë. Kjo shoqëri ka në përbërje të kapitalit të saj edhe ish Uzinën e Rafinerisë së Naftës Cërrik, e cila i është shtuar kapitalit të shoqërisë PETROL ALBA sh.a sipas Urdhrit nr. 854 datë 31.10.2011 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Gjithashtu me urdhrin nr.756 datë 11.10.2011 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës janë kaluar në administrim të shoqërisë PETROL ALBA sh.a TEC-t Tiranë, Korçë, Maliq, Cërrik, Kuçovë dhe Vlorë ku vlera e AQT-ve të tyre dhe e gjendjes së magazinës është pasqyruar si llogari jashtë bilancit. Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi, statutit dhe aktit të themelimit të kësaj shoqërie. Organet drejtuese të shoqërisë janë: Këshilli mbikëqyrës: dhe Likuidatori i shoqërisë:


Shoqëria anonime “ARMO” Sh.a. do të ruajë të gjitha të drejtat mbi asetet, që i përgjigjen aktivitetit të pikave të tregtimit me pakicë, të cilat do të operojnë në kuadër të “Armo” sh.a, deri në momentin e privatizimit të tyre.

**Tabela 8.** Treguesit kryesorë financiarë në milion lekë

|            | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004  | 2005  | 2006  |
|------------|------|------|------|------|-------|-------|-------|
| Të ardhura | 8267 | 8280 | 8202 | 9723 | 11635 | 11515 | 14651 |
| Shpenzime  | 7901 | 7862 | 8358 | 9488 | 11270 | 11274 | 12762 |
| Rezultati  | 366  | 418  | -156 | 235  | 365   | 241   | 1889  |

**Burimi:**Manuali Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Republika e Shqipërisë 2016

**Grafiku 5:** Të ardhurat, shpenzimet dhe rezultati v.2000-2006 (milionë lekë):



**Burimi:**Manuali Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Republika e Shqipërisë 2016

Ishte përzgjedhur shoqëria e konsulencës “Patton Boggs” e cila deri në fund të muajit tetor 2007 do realizonte përgatitjen e dokumentacionit me informacionin e

nevojshëm për investitorët të cilët do të shfaqin interes dhe që janë potencialisht të mundshëm që të marrin pjesë në privatizimin e kompanisë.

### **3.4. Organizimi i Sektorit të Naftës dhe Gazit në Shqipëri.**

Organizimi i Sektorit Hidrokarbur realizohet në linjë horizontale, ku përfshihen disa Drejtori të Përgjithshme si Drejtoria e Përgjithshme e Politikave, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatorë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare, të cilat sipas objektit të tyre, synojnë të realizojnë një furnizimin të rregullt të konsumatorëve me burime energjetike hidrokarbure, duke qenë një mbështetje e sigurtë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social të vendit. Në mbështetje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi, njësitë administrative në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave (DPP), si strukturë në përbërje të Ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, është ngarkuar për të kryer formulimin dhe zbatimin e politikave të Qeverisë për zhvillimin e industrisë së naftës, kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, sigurimin e furnizimit të tregut me naftë, gaz dhe nënproduktet e tyre, përcaktimin dhe formulimin e masave dhe rregullave për realizimin e rolit rregullator të shtetit në tregun e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe vlerësimin dhe sigurimin e rezervës së sigurisë me këto produkte. Njësitë që mbulojnë aktivitetin hidrokarbur në përbërje të DPP organizojnë dhe drejojnë planifikimin në lidhje me studimin dhe kërkimin në fushën e hidrokarbureve të lënget apo të gaztë, si dhe për garantimin e furnizimit dhe diversifikimin e burimeve të furnizimit me naftë, gaz dhe nënproduktet e tyre; marrin pjesë në formulimin e politikave dhe akteve juridike për ruajtjen dhe rehabilitimin e

mjedisit në zonat dhe instalimet ku shoqëritë e sektorit hidrokarbur kryejnë aktivitetin e tyre, në mbështetje dhe zbatim të kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve Ndërkombëtare.

Megjithatë përfshirjen e operatoreve privatë në të gjitha aktivitetet e sektorit të hidrokarbureve, qofshin ato në kërkim, prodhim, transport apo tregtim, shoqëritë publike vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm sidomos në prodhimin dhe rafinimin e naftës. Vitet e fundit për të gjitha këto shoqëri (me përjashtim të ALBPETROL sh.a) është miratuar kuadri përkatës ligjor për privatizimin e tyre. Liberalizimi i aktiviteteve në sektorin e hidrokarbureve ka qenë një hap i rëndësishëm që u shoqërua me një përfshirje më të madhe të investitorëve privatë. Në shoqëritë të cilat funksionojnë aktualisht në vendin tonë në sektorin e hidrokarbureve, shteti vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në këtë sektor, sidomos në atë të prodhimit të naftës dhe gazit natyror dhe përpunimit e tregtimit të naftës të prodhuar në vend.

Aktualisht, në sektorin publik të naftës dhe gazit operon shoqëria ALBPETROL sh.a përgjegjëse për aktivitetin e kërkimit, prodhimit, shërbimeve në shpim, shërbime gjeofizike të puseve, infrastrukturë, etj. Në fushën e marketingut dhe tregtimit mbizotërojnë shoqëritë private të tregtimit, duke mbuluar rreth 60 % të nevojave të tregut. Në aktivitetin e kërkimeve mbizotërojnë shoqëritë e huaja të cilat operojnë mbi bazën e marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura me shtetin shqiptar.

***Organizimi i shoqërive publike në sektorin e hidrokarbureve;*** Aktualisht në sektorin publik të naftës dhe gazit operojnë 3 shoqëri publike:

- ALBPETROL sh.a që kryen aktivitete në fushën e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve dhe shërbimit.
- Uzina Mekanike e Naftës (UMN) ShPK. Kuçovë ofron prodhime dhe shërbime mekanike për industrinë e naftës.

- Uzina Mekanike (UM) ShPK Patos, gjithashtu ofron prodhime dhe shërbime mekanike për industrinë e naftës.

Megjithëse të gjitha këto shoqëri janë planifikuar që të privatizohen në funksion të kësaj detyre është përgatitur dhe kuadri i nevojshëm ligjor, deri tani ky proces nuk ka qenë i suksesshëm. Menaxhimi i kujdesshëm dhe ri-përgatitja e këtyre shoqërive për privatizim do të mbetën objektivat kryesore lidhur me këto shoqëri.

Ashtu si sektori elektroenergjetik, edhe për sektorin hidrokarbur është punuar për privatizimin e tij, duke ndjekur drejtimit e zhvillimit strategjik në procesin e privatizimit të pronës publike.

Në vlerësimin e bërë për transformimin e pronës publike në sektorin hidrokarbur mendojmë se pavarësisht nga specifika që paraqesin shoqëritë tregtare të veçanta të këtij sektori, për një privatizim të suksesshëm është e nevojshme që në thelb të strategjive, kuadrit ligjor dhe procedurave të privatizimit për secilën shoqëri duhet të vendoset domosdoshmëria e zhvillimit të harmonizuar të këtij sektori në të gjithë komponentët përbërës të tij dhe specifika që e dallon atë. Institucionet shtetërore përkatëse që merren me privatizimet në sektorin strategjik dhe aktorët e tjerë që janë të lidhur me këtë proces, paraprakisht dhe gjatë procesit të privatizimit të shoqërisë ARMO sh.a. duhet të kishin marrë në konsideratë faktin që rafineritë e saj janë të projektuara me një teknologji të veçantë që i përshtatet karakteristikave tepër të dallueshme të naftave të vendburimeve tona (të rënda, asfalto-rreshinore e squfurore) aq më tepër që bota po i kushton vëmendje të veçantë nxitjes për zhvillimin dhe prodhimin e naftave jo-



konvencionale. Nga ana tjetër kërkohet që procesi i privatizimit të ARMO-s të paraprihet nga një fushatë agresive për të tërhequr interesimin e shoqërive strategjike.

Pavarësisht nga analiza dhe vlerësimi që i ka bërë konsulenti Ndërkombëtar IMI, konsiderojmë se shoqëria anonime e kërkim-prodhimit të naftës e gazit “Albpetrol” (ku në të janë përfshirë kompania Sercom dhe Transnafta ShPK) paraqet një seri veçorish specifike që karakterizojnë në përmbajtje aktivitetin e kësaj shoqërie dhe që determinojnë efektivitetin e privatizimit të shoqërisë së kërkim-prodhimit të naftës Albpetrol sh.a. Kuadri ligjor dhe mënyra se si do të procedohet në procesin e privatizimit të saj duhet të ndikohen nga këto veçori:

- Në procesin e privatizimit të shoqërisë Albpetrol sh.a. (kërkim-prodhim) duhet mbajtur parasysh që vlerësimi i asetëve të kësaj shoqërie për efekt privatizimi duhet të dominohet nga vlera e rezervave të naftës dhe gazit që zotëron apo administron ajo (sikurse bëhet për çdo kompani kërkim-prodhimi. Rezervat në thelb përbëjnë objektin kryesor për investitorët strategjike, mbi bazën e të cilit ata do të kërkojnë të privatizojnë asetet që ka shoqëria për nxjerrjen e rezervave nga nëntoka në sipërfaqe. Në rastin tonë kjo bëhet më e evidente po të kemi parasysh se zhvillimi i rezervave të naftës e gazit nga vendburimet tona ekzistuese bëhet me një teknikë e teknologji larg standardeve aktuale që aplikohen sot në botë.

- Për të orientuar më mirë zgjedhjen e formës më efektive të privatizimit të asetëve të Albpetrol sh.a. duhet të mbahet parasysh praktika e deritanishme ku interesi dhe përfshirja e kompanive të huaja (investitorëve strategjike) ka qenë për formën e Marrëveshjeve Hidrokarbure (MH). Marrëveshjet Hidrokarbure të lidhura janë derivate të formës së koncesionit, pra në thelb shprehin një formë privatizimi. Nga pikëpamjet e

shprehura prej tyre, gjykojmë se forma e koncesionit (me derivatet e saj) mbetet forma me atraktive për investorët strategjike të huaj.

Aktualisht Albpetroli ka një Marrëveshje Hidrokarbure për zhvillimin e vendburimit të naftës të Patos-Marinës me kompaninë kanadeze “Saxon International Energy”, Ltd, e shtrirë në kohë për 25 vjet, dhe mundësitë e lidhjes në periudhë afatshkurtër të marrëveshjeve të tilla për vendburime të tjera bën të nevojshme që në legjislacionin për privatizimin e kësaj kompanie të merret në konsideratë ky fakt.

Nuk mund të konceptohet privatizimi i Albpetrol sh.a. pa marrë në konsideratë situatën konkrete të shfrytëzimit të vendburimeve ekzistuese të naftës dhe gazit dhe nacionalitetin e investimeve që duhen kryer për zhvillimin e tyre në për udhën afatshkurtër deri afatmesme. Në këtë kontekst duhet marrë në konsideratë edhe fakti që transformimi i pronës në sektorin hidrokarbur nga pronë publike në plotësisht privatë, i jep të drejtën investorëve strategjike të formulojnë një strategji të re të shoqërive sipas misionit dhe vizionit të menaxherëve kryesore të tyre. Pas kësaj, roli i shtetit në zhvillimin e këtyre shoqërive do të dobësohet ndjeshëm. Pikërisht, për këtë arsye kemi vënë në themel të vlerësimeve të bëra nga ne domosdoshmërinë e ruajtjes së aktivitetit në tërësi të shoqërive të sektorit hidrokarbur në funksion të zhvillimit kompleks të tij, me qëllim që të arrihet maksimumi i mundshëm i furnizimit me energji të vendit me burimet e brendshme hidrokarbure.

#### *3.4.1. Sektori Hidrokarbur, Nafta e Gazi natyror*

Historia e naftës shqiptare nis gjatë pushtimit Osman, mesi i viteve 1800. Kjo është koha kur në Shqipëri nisin ekspeditat e para kërkimore mbi vendburimet naftës. Sipas të dhënave studimore, në vitin 1885 perandoria Osmane i jep të drejtën një shoqërie

franceze për të shfrytëzuar resurset e Selenicës në afërsi të Vlorës. Në vitin 1918 stafetën e kërkimit për naftë e morën kompanitë italiane. Qeveria italiane dërgoi në Shqipëri ekipet e saj më të mira dhe në vitin 1918 vendoset të testohet pusi i parë i naftës. Zona më premtuese ishte Drashovica e Vlorës.

Pusi i parë dha rezultate pozitive dhe jehona e zbulimit të naftës në Shqipëri zgjoi interesin e kompanive më të mëdha të kohës. *Pusi i Drashovicës në vitin 1918 është guri kyçi i industrisë së naftës shqiptare.* Një vit më vonë në vendin tonë zbarkon një kompani e huaj me aksionarë anglezë e iranienë. Sot kjo kompani është kolosi global i naftës: British Petroleum.

Në vitet pasardhëse kompanitë italiane hapën puse të tjera në zonën e Kuçovës, Dumre-Pekisht-Parmëz-Rasë, Biçakaj etj. Një tjetër kompani angleze kishte fokusuar kërkimet e saj në zonën e Vlorës e Fierit. Në vitin 1930 emri i Patosit si një vendburim naftë në shkallë industriale ishte i njohur në të gjithë Evropën.


Në vitin 1945 e gjithë nëntoka shqiptare u shtetëzua dhe këtu nis epoka e re e historisë së naftës në Shqipëri. Në vitet që pasojnë, qeveria shqiptare e rriti interesin në industrinë e naftës si një katalizator në zhvillimin ekonomik të vendit. Brenda viteve 1949-1952 krijohen 11 ndërmarrje naftë dhe në të njëjtën kohë i jepet një rëndësi e veçantë kualifikimit dhe specializimit të punonjësve. Kjo konkludoi me hapjen në 1950 të shkollës së mesme teknike në Kuçovë, me profil specifik në gjeologji, shpim, nxjerrje e përpunim të naftës. Pas prishjes me Jugosllavë, qeveria e kohës u orientua drejt Bashkimit Sovjetik, influenca e së cilës preku dhe sektorin e naftës në Shqipëri. Në vitin 1950 grupe ekspeditash ruse vizituan disa herë Shqipërinë. Një vit më pas u krijua Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Vitet që pasuan sollën hapjen e degës së gjeologjisë në Fakultetin e Inxhinierisë në Tiranë; ngritjen e uzinës mekanike në Kuçovë si dhe të

qendrës së riparimit të instrumenteve të shpimit në Patos. Operacionet e shpimit dhe kërkimit në naftës kulmuan në vitin 1957 me zbulimin e vendburimit në Marinzë. Brenda një viti prodhimi i naftës thuajse u dyfishua. Në periudhën 1956-1960 punimet e shpimit dhe të kërkimit u rritën me intensitet të lartë, prodhimi i naftës në vitin 1960 arriti në shifrën 727 519 tonë. Prishja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik në vitin 1960 solli edhe izolimin e industrisë së naftës, por jo uljen e rezultateve. Edhe pse në atë kohë gjithçka u krye nga inxhinierët shqiptarë, prodhimi i naftës në vitin 1965 kapi shifrën 822 405 tonë. Në këtë kohë u zbuluan vendburimet e gazit në Divjakë dhe të naftës në Visokë. Në vitet 1968–1970 nisin eksperimentet pilot përmes injektimit të ujit në Marinzë dhe Kuçovë. Përforcimi i masave dhe ngritja e një sërë strukturash të posaçme bëri që nga viti 1972 deri në vitin 1987 të zbuloheshin disa vendburime të rëndësishme nafte dhe gazi natyror, si ai në Frakull, në Finiq, Arrëz, Gorisht-Kaçul, Cakran-Mollaj, Povelça, Durrës, Delvmë etj. Moment i rëndësishëm në industrinë e naftës shqiptare është nisja nga puna e nxjerrjes së naftës në Ballsh, me aftësi përpunuese vjetore rreth 1 250 000 ton në vit. Deri në fillim të viteve 1990 industria shqiptare e naftës ishte në eficiencë të plotë jo vetëm në pjesën e kërkimit dhe prodhimit, por edhe në përpunimin e naftës dhe nxjerrjen e produktit final për popullsinë. Në mes të viteve 1990 në Shqipëri erdhën kompani botërore të naftës, të cilat morën me koncesion fushat naftëmbajtëse të administruara nga Albpetrol. Kjo solli dhe një ndryshim në rolin e kompanisë, e cila sot është jo vetëm prodhuese e naftës, por funksionon edhe si ent rregullator dhe kontrollues i marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura mes shtetit shqiptar dhe kompanive të huaja. Industria e Naftës dhe e Gazit do të vazhdojë që të ketë një rol parësor në ekonominë e vendit tonë, jo vetëm për faktin që

punëson një numër të konsiderueshëm punonjësish, por edhe për të ardhurat që përfiton shteti nga kjo industri dobiprurëse.

Shqipëria ka rezerva të konsiderueshme të naftës dhe gazit, si në tokë dhe në det të cilat kanë inkurajuar investitorët e huaj, për të filluar gërmimin dhe kërkimin për zona të pazbuluara të naftës dhe gazit. Akumulimet hidrokarbure janë burime të papërsëritshme nëntokësore natyrore, nëpërmjet të cilave Shqipëria ka gjeneruar vazhdimisht fonde të rëndësishme financiare. Kërkimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1918. Që nga ajo kohë, u zbuluan fusha naftë-mbajtëse në 11 zona tokësore duke përfshirë: Drashovicë (1918), Patos (1927), Kuçovë (1928), Marinzë (1957), Visoka (1963), Gorisht-Kaçul (1965), Ballsh-Hekal (1966), Finiq-Kranë (1973), Çakran-Mollaj (1977), Delvinë (1989) dhe Sqepur (2001). Kërkimi i gazit në Shqipëri filloi në vitin 1955. Fusha e parë gaz-mbajtëse u zbulua në Divjakë (1963), e ndjekur nga Frakulla (1965), Ballaj-Kryevidhi (1983), Povelça (1987), Panaja (1988), dhe Ad-4 (në det – 1994).

**Grafiku 6: Prodhimi i naftes bruto ne v. 2011.**



**Burimi:** Manuali Ekonomik, Ministria e Ekonomisë, Republika e Shqipërisë 2016

Në 2011, AKBN raportoi se prodhimi i naftës bruto ishte 894, 500 tonë me një vlerë prej 456.5 milionë USD. Ky prodhim është nxjerrë kryesisht nga fusha e Patos-Marinzës (85% e prodhimit), nga Bankers Petroleum. Eksporti i naftës së papërpunuar në vitin 2011 ishte 69.4% e naftës së prodhuar gjithsej, me një vlerë prej 317 milion USD. Të dhënat nga Dogana rendisin Italinë si destinacionin kryesor, të ndjekur nga Spanja dhe Malta. Prodhimi i përgjithshëm i gazit u raportua 15 milion Nm.

**Tabela 9. Fushat e naftës dhe gazit në Shqipëri**

|                |             |             |             |
|----------------|-------------|-------------|-------------|
| Cakran –Mollaj | 16.1        | 8.1         | 4.2         |
| Ballsh-Hekal   | 19.7        | 6.5         | 5.1         |
| Gorisht –Kocul | 30.5        | 14.7        | 11.9        |
| Amonice        | 2.8         | 1.5         | 0.7         |
| Visoke         | 28.4        | 6.8         | 6.2         |
| Delvinë        | 0.3         | 0.1         | -           |
| Finiq –Kranë   | 1           | 0.2         | -           |
| Drashovica     | 0.1         | -           | -           |
| <b>Total</b>   | <b>98.9</b> | <b>37.9</b> | <b>28.1</b> |


*Burimi: Departamenti i Energjive Të Rinovueshme, Strategjia sektoriale e energjisë 2006-2020, 2007, Tiranë*

**Tabela 10. Marrëveshjet e hidrokarbureve, si më poshtë, ishin në fazën e prodhimit gjatë vitit 2012:**

| Grupi                  | Shoqëria e liçensuar                                                                     | Data e marrëveshjes hidrokarbure | Zona e operimit (tokësore)                                            |
|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|
| Bankers Petroleum Ltd. | Bankers Petroleum Albania Ltd                                                            | Korrik 2004                      | ▪ Patos-Marinëz,                                                      |
|                        | Sherwood International Petroleum Ltd                                                     | Shtator 2007                     | ▪ Kuçovë                                                              |
| Stream Oil & Gas Ltd.  | Dega ne Shqiperi e Stream Oil & Gas Ltd<br>( <i>tashmë Transatlantic Petroleum Ltd</i> ) | Gusht 2007                       | ▪ Gorisht-Kocul,<br>▪ Cakran-Mollaj,<br>▪ Ballsh-Hekalit<br>▪ Delvinë |
| Transoilgroup AG       | Transoil Group -Dega ne Shqiperi                                                         | Shkurt 2012                      | ▪ Visokë                                                              |

*Departamenti i Energjive Të Rinovueshme, Strategjia sektoriale e energjisë 2006-2020, 2007, Tiranë,*


Figura 1. Fushat e gazit dhe Naftës në Shqipëri



Burimi: Departamenti i Energjiave të Rinovueshme, Strategjia sektoriale e energjisë 2006-2020, 2007, Tiranë




**Tabela 11 Prodhimi i naftës nga Albpetrol dhe sektori privat në vitet 1992-2013 Në mijë ton**



*Departamenti i Energjive të Rinovueshme, Strategjia sektoriale e energjisë 2006-2020, 2007, Tiranë*

Prodhimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1929, me 750 tonë naftë bruto në vit. Pas Luftës së Dytë Botërore prodhimi u rrit në mënyrë të qëndrueshme dhe arriti pikun në vitin 1974 me një prodhim prej 2.25 milionë tonë në vit. Në vitet '80 prodhimi i naftës ra nën 1 milion ton në vit dhe arriti përsëri në mbi 1 milion ton në vitin 2012.

**Tabela 12 Nafta e prodhuar në vitin 2012 nga të licencuarit**



*Departamenti i Energjive të Rinovueshme, Strategjia sektoriale e energjisë 2006-2020, 2007, Tiranë*

**Tabela 13. Lista e blloqeve te kerkimit**

| Nr. | Vendodhja | Blloqet            | Operuar nga / I Lirë             | Liçensa e administruar nga |
|-----|-----------|--------------------|----------------------------------|----------------------------|
| 1   | Në det    | Blloku Rodoni Veri | I lirë                           | Albpetrol                  |
| 2   | Në det    | Blloku Adriatiku 2 | Emanuelle Energy                 | AKBN                       |
| 3   | Në det    | Blloku Adriatiku 3 | Emanuelle Energy                 | AKBN                       |
| 4   | Në det    | Blloku Adriatiku 4 | Emanuelle Energy                 | AKBN                       |
| 5   | Në det    | Blloku Joni 5      | Capricorn Albania & Dyas Albania | AKBN                       |
| 6   | Në tokë   | Blloku 1           | I lirë                           | Albpetrol                  |
| 7   | Në tokë   | Blloku 2           | Petromanas & Shell               | AKBN                       |
| 8   | Në tokë   | Blloku 3           | Petromanas & Shell               | AKBN                       |
| 9   | Në tokë   | Blloku 4           | I lirë                           | Albpetrol                  |
| 10  | Në tokë   | Blloku 5           | I lirë                           | Albpetrol                  |
| 11  | Në tokë   | Blloku 6           | I lirë                           | Albpetrol                  |
| 12  | Në tokë   | Blloku 7           | I lirë                           | Albpetrol                  |
| 13  | Në tokë   | Blloku 8           | Albanides Energy                 | AKBN                       |
| 14  | Në tokë   | Blloku A           | I lirë                           | Albpetrol                  |
| 15  | Në tokë   | Blloku B           | I lirë                           | Albpetrol                  |
| 16  | Në tokë   | Blloku C           | I lirë                           | Albpetrol                  |
| 17  | Në tokë   | Blloku D           | Petromanas                       | AKBN                       |
| 18  | Në tokë   | Blloku E           | Petromanas                       | AKBN                       |
| 19  | Në tokë   | Blloku F           | Bankers Petroleum                | AKBN                       |
| 20  | Në tokë   | Blloku Dumre       | I lire                           | Albpetrol                  |
| 21  | Në tokë   | Blloku Panaja      | I lire                           | Albpetrol                  |
| 22  | Në tokë   | Blloku Velca       | I lire                           | Albpetrol                  |

*Departamenti i Energjive të Rinovueshme, Strategjia sektoriale e energjisë 2006-2020, 2007, Tiranë,*

The map illustrates the distribution of oil and gas blocks in Albania, categorized by licensing status and location. The legend indicates four types of blocks:

- OFFSHORE LICENSED BLOCKS (Blue):** Includes Adriatiku 2, Adriatiku 3, Adriatiku 4, San Leon Energy, Joni 5, and Capricorn Albania & Dyas Albania.
- ONSHORE LICENSED BLOCKS (Orange):** Includes Albanides Energy, Rodoni North, Petroman, Dumre, and Petroman & Shell.
- FREE ONSHORE BLOCKS (Light Orange):** Includes blocks 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, and 8.
- FREE OFFSHORE BLOCKS (Light Green):** Includes Rodoni North.

Other labels on the map include 'Durrës', 'Panaja', 'Vetë', and 'Durrës'.

### 3.4.2. Shoqëria e naftës e zotëruar nga shteti – Albpetrol

Për zonat nën administrim, ku Albpetrol Sh.a. ka të drejtat e kërkimit dhe prodhimit, si licencë primare, në mënyrë që të arrihet një efikasitet më i mirë në kërkim

dhe prodhim, ligji i lejon Albpetrolit t'i transferoi të drejtat në kërkim dhe prodhim, duke nën-licencuar shoqëritë të naftës dhe gazit, pas miratimit nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.


#### *Shoqëria Albpetrol sh.a*

**Shoqëria Albpetrol sh.a** ka zhvilluar analizën e punës së saj për 9 mujin e vitit 2014, nga e cila rezulton një shifër rekord faturimesh dhe kontributesh në buxhetin e shtetit. Për herë të parë pas shumë vitesh shoqëria Albpetrol sh.a është kthyer në një nga financuesit më të mëdhenj në buxhetin e shtetit. Gjatë 9 muajve të parë të vitit 2014 shoqëria Albpetrol sh.a ka faturuar për shitje dhe shpenzime më tepër se **9 miliardë lekë të reja**. Kjo është një rritje e ndjeshme në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë kur shifra e faturimeve ishte **4 miliardë lekë të reja**, ose **46 milionë USD më pak**. Rritja e faturimeve dhe të ardhurave të shoqërisë Albpetrol sh.a ka ndikuar drejt për drejtë në rritjen e kontributeve që shoqëria ka derdhur në buxhetin e shtetit. Gjatë kësaj periudhe Albpetrol sh.a ka derdhur në buxhetin e shtetit rreth **35 milionë USD, ose 12 milionë USD** më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Kjo rritje e faturimeve dhe të ardhurave i ka mundësuar shoqërisë Albpetrol sh.a që përveçse të rrisë kontributët në buxhetin e shtetit, të arrijë të shlyejë edhe të gjitha borxhet e grumbulluara gjatë viteve të kaluar. Vlen të theksohet se Albpetrol sh.a vetëm ndaj **OSHE ka shlyer gjatë vitit 2014 më shumë se 10 milionë USD** detyrime dhe kamatë vonesa të krijuara nga viti 2008 deri në vitin 2013.

Një tjetër tregues i përmirësuar ndjeshëm gjatë 9 muajve të parë të vitit 2014 nga shoqëria Albpetrol sh.a është edhe ulja e humbjeve fizike në ton. Rezultati i 9 muajve të parë, por edhe rezultati i pritshëm i fundvitit është rezultati më i mirë i 24 viteve të


fundit (nga viti 1991 e deri më sot). Në fund të vitit shoqëria Albpetrol sh.a parashikon që niveli i humbjeve fizike të jetë **650 tonë naftë në një kohë kur në vitin 2013 humbjet fizike arritën shifrën e frikshme prej 7259 tonëve naftë** me një vlerë prej më tepër se 4 milionë USD ( marrë nga faqja zyrtare në internet e kompanisë).

**Figura 3 : Humbjet fizike nafte ALBETROL sh.a (në ton) nga v.1991-2014:**



Burimi: Albpetrol sh.a

**Figura 4 : Faturimet 9- mujori 2014, shoqëria ALBPETROL sh.a :**



Burimi: **Albpétrol sh.a**

#### *3.4.3. Rezervat e naftës dhe gazit natyror*

Potencialet naftë gazmbajtëse të nëntokës së vendit tonë, të zhvilluara e prognozuara gjenden në rezervuarët ranore e gëlqerore, të cilët janë të dallueshëm nga vetë natyra e rezervuarit, karakteristikat kolektorale, veçoritë e grumbullimit dhe ruajtjes së fluideve, energjinë natyrale të prerjeve produktive si dhe të regjimit të përpunimit tyre. Për rrjedhojë, këto veçori të natyrës gjeologjike të rezervuarëve përcaktojnë anën hidrodinamike të zhvillimit (përpunimit) të vendburimeve dhe karakteristikat teknologjike të shfrytëzimit të puseve në tëresi.

**Rezervat e naftës** në vendburimet e njohura janë llogaritur në kohë të ndryshme në përputhje me zbulimin dhe zhvillimin e tyre. Në ecuri janë bërë edhe llogaritje operative dhe rivlerësime të rezervave, për të pasqyruar ndryshimet në vlerën e tyre, në përputhje me stadin e zhvillimit dhe vlerësimit të rezervave perspektive të prospektëve të prognozuara në ecuri nga punimet komplekse gjeologo-gjeofizike dhe të dhënat e puseve në kuadrin e marrëveshjeve hidrokarbure. Në këndvështrimin e një strategjie

zhvillimi merr kuptim të veçantë marrja parasysh e vlerës dinamike të rezervave si rezultat i përmirësimit në kohë të vlerës së rezervave. Duke patur parasysh se vlera e rezervave të llogaritura tek ne ka marrë në konsideratë kryesisht shkallën e njohjes gjeologjike të vendburimeve ose shtratimeve dhe nxjerrjen e tyre me *teknikën disponuese* në vendburimet e njohura, kjo vlerë duhet të pranohet si një vlerë minimale, e cila në të ardhmen do të jetë më e përmirësuar falë zhvillimeve teknologjike në të ardhmen dhe nivelit të lartë të çmimit të naftës e gazit në tregun botëror. Në total sasia e naftës e grumbulluar fillimisht në rezervuarët nëntokësorë të vendburimeve të njohura të vendit tonë ka qenë 437 milionë tonë naftë. Në varësi të natyrës së rezervuarit natyror të vendburimeve të naftës rezulton se, në vendburimet ranore kanë qenë depozituar 77, 75 % të rezervave totale gjeologjike (pak më shumë se 22 % të totalit). Deri tani janë nxjerrë rreth 50.2 milionë tonë dhe ndodhen ende nëntoke edhe rreth 386.4 milionë tonë naftë (rezerva gjeologjike).

Duke analizuar rezervat në funksion të strategjisë së zhvillimit dhe duke parë vlerën e këtyre rezervave në këndvështrimin që përpunimi i vendburimeve të naftës duhet të sigurohet një nxjerrje e sasive maksimale të rezervave gjeologjike (ose të naftës fillestare në shtresë-OOIP), me tempe të marrjes (nxjerrjes) së tyre në një kohë sa më të shkurtër dhe brenda kufijve të leverdishmerisë ekonomike. Për këtë arsye duhen mbajtur në konsideratë treguesit e mëposhtëm:

- Në këndvështrimin e një strategjie zhvillimi të sektorit hidrokarbur merr kuptim të veçantë marrja parasysh e vlerës dinamike të rezervave si rezultat i përmirësimit në kohë të vlerës së rezervave. Gati gjysma e rritjes së rezervave në vendet kryesore prodhuese të naftës ka ardhur nga rivlerësimi i tyre duke marrë në konsideratë

zhvillimet teknologjike, kostot e zhvillimit dhe gjetjes se rezervave si dhe çmimet e tregut;

- Në total sasia e naftës e grumbulluar fillimisht në rezervuarët nëntokësorë të vendburimeve të njohura të vendit tonë ka qenë 436.7 milionë tonë naftë. Në varësi të natyrës së rezervuarit natyror të vendburimeve të naftës rezulton se, në vendburimet ranore kanë qenë depozituar **77, 75 %** të rezervave totale gjeologjike-OOIP (338.7 milion ton), ndërsa në rezervuarët karbonatike (gëlqeroret) pak mbi 22 %.

- Kushtëzuar objektivisht nga natyra e vendburimeve të naftës (modeli i rezervuarit natyror, vetitë e fluideve, energjia e shtresës, etj) dhe përcaktuar nga niveli i teknologjisë disponuese në vend është llogaritur një vlerë e rezervave të nxjerrshme fillestare të naftës prej 80.5 milionë tonë naftë dhe deri tani është nxjerrë 62.44% të tyre (me këtë teknologji mbeten për t'u nxjerrë edhe 37, 5% e tyre).

- Ritmet vjetore të marrjes së rezervave në kohë nga vendburimet e njohura ndaj vlerës korrentë të rezervave të nxjerrshme (përqindja që ze prodhimi i naftës ndaj rezervave të provuara), për vendburimet tona janë ndjeshëm më të ulta se ato që realizohen në të gjitha kategoritë e vendburimeve të naftës në botë. Gjikuar nga zhvillimet botërore që do të këtë naftë jo konvencionale, kjo situatë në vendburimet tona përben një potencial të konsiderueshem të mundësisë së rritjes së prodhimit.

- Për të intensifikuar nxjerrjen e naftës nga vendburimet ekzistuese duhet të realizohet një studim kompleks për të thelluar njohjen e dukurive gjeologjike të rezervuareve e të kushteve të ndodhjes se naftës në to, për të përcaktuar nivelin teknologjik bashkëkohor të përshtatshëm për kushtet e vendburimeve tona dhe për të bërë një vlerësim të ndërthurur me kriteret ekonomike, me qëllim që të arrihet



përmirësimi i vlerës së rezervave të nxjerrshme nga ndikimi i zhvillimeve bashkëkohore teknologjike, kostot e zhvillimit dhe të gjetjes së rezervave me çmimet e tregut.

- Në këtë strukturë rezervash të vendburimeve të naftës duhet të mbahet në konsideratë fakti që vendburimi i Patos Marinzës përfaqeson vendburimin më të madh të naftës në vendin tonë, me gjysmën e rezervave gjeologjike (OOIP) të zbuluara, rreth 36 % të sasisë kumulative të naftës së prodhuar deri tani në vendin tonë dhe afro 40 % të rezervave totale të mbetura për t'u nxjerrë në vendburimet ekzistuese (të llogaritura me teknologjinë që ka aktualisht Albpetroli). Për këtë arsye, ecuria e prodhimit të naftës në kuadrin e Marrëveshjes së re Hidrokarbure për këtë vendburim do të jetë determinuese në prognozimin e ecurisë së prodhimit të naftës për periudhën afatgjatë të kësaj strategjie, si dhe për vlerën e investimeve për zhvillimin e vendburimeve të naftës në vendin tonë.

Nisur nga këto përfundime, duhet theksuar se megjithë materialin e gjerë që disponohet nga shfrytëzimi i vendburimeve, për problemet energjitike për periudhën pas viteve nëntëdhjetë të dhënat janë shumë të pakta për të mos thënë se mungojnë fare. Nuk janë analizuar asnjëherë gjithë vendburimet sëbashku për të parë ecurinë e fenomeneve që shfaqin për periudha të njëjta shfrytëzimi e në përputhje me sasinë e prodhimit të marrë, që përbëjnë objekte për punime në të ardhmen.

**Rezervat e gazit** në vendburimet e njohura të naftës e të gazit natyror të vendit tonë me 01.01.2005 rezultuan se ndodhen si rezerva të nxjerrshme të gazit me se 3 miliardë e 630 milionë m<sup>3</sup>N. Nga keto vetëm afro 22 milionë m<sup>3</sup>N gaz i përkasin vendburimeve të gazit natyror, Ndërsa 3 miliardë e 610 milionë m<sup>3</sup>N gaz i përkasin vendburimeve të naftës e gazokondensatit në trajtën e gazit të tretur në naftë apo të kondensuar dhe të gazit të lire në kapelet gazore të disa vendburimeve. Rezervat e gazit

të zbuluara e të zhvilluara në vendin tonë i përkasin vendburimeve që janë klasifikuar si:

1. Vendburime të gazit natyror ose të gazit të thatë, me përmbajtje mbi 90% të gazit metan (Divjaka, Ballaj, Frakulla, Povelça, Panajaja),

2. Vendburime të gazit kondensat (Delvina dhe fillimisht Cakrani, suita Bubullima).

3. Vendburime të gazit shoqerues të ndodhur në trajtën e gazit të tretur në naftë ose të kapeleve gazore në vendburimet e naftës (Kuçove, Patos Marinëz, Visoke, Ballsh-Hekal, Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Amonice, Finiq-Kranë),

Po t'i referohesh nxjerrjes (marrjes) vjetore të rezervave të gazit nga vendburimet e gazit natyror në raport me rezervat korrente të mbetura (në vitin përkatës), rezultojnë tempe shumë here më të larta se në vendburimet e naftës (nga venia e tyre në shfrytëzim të plotë e në vazhdim). Është kjo arsyeja që sot kemi një bilanc të varfër të rezervave të gazit nga vendburimet e gazit natyror.

Të ndodhur para një realiteti të tillë vendi aktualisht është në krize për burime të furnizimit me gaz, ku edhe kërkesa minimale për plotësimin e nevojave të domosdoshme më të pakta të UPTHN Ballsh ka pak siguri të garantohet.

Bazuar në vlerësimet e rezervave të gazit arrihet në konkluzionin se: Kriza për burime të furnizimit me gaz në vendin tonë, ku edhe kërkesa minimale për plotësimin e nevojave të domosdoshme më të pakta të UPTHN Ballsh garantohet vetëm për dy vjet; Ndërsa nga ana tjetër bilanci i rezervave të nxjerrshme të mbetura të gazit në vendburimet e naftës dhe ato të gazokondensatit është mbi 3.6 miliard Nm<sup>3</sup>. Pra një vlerë rezervash me potencial të konsiderueshem nxjerr në plan të parë kryerjen e një studimi të thelluar për të bërë një vlerësim të diferencuar të rezervave të mbetura të

gazit për vendburimet e gazit natyror, rezervat e gazit në kapelet gazore të vendburimeve të naftës (suja Marinze, Ballsh, Finiq- Kranë), rezervat e gazit të vendburimeve të gazokondensatit (Cakran, Delvinë, suja Bubullima), rezervat e gazit shoqërues të naftës të vendburimeve ranore e gëlqerore.

Vendburimi i Cakranit përbën një tjetër objekt të rëndësishëm studimi, në bashkëpunim me specialistë të huaj e me përvojë, për të gjetur e aplikuar teknologjitë e favorshme të intensifikimit të nxjerrjes së gazit të kurtuar në matriks pas fontanës së hapur të Ca-37, për të cilën mendimi i specialistëve të zhvillimit të vendburimeve të naftës është optimist. Si një zgjidhje për periudhën afatshkurtër-afatmesme për rezerva të reja në gaz, merr përparësi vlerësimi dhe zhvillimi i vendburimit të Delvinës, ku nevoja e shpimit të pusit të ri është në plan të parë dhe kërkon sigurimin e investimeve të nevojshme dhe konkretizimin e shpimit të pusit sa më shpejt.

Në bilancin e rezervave janë raportuar për vendburimin e Finiq-Kranëse një vlerë e konsiderueshme rezervash gazi të nxjerrshme prej rreth 600 milion m<sup>3</sup>N, për të cilin është gjykuar nga specialistë të fushës që të bëhet një rivlerësim mbi bazën e të dhënave kantierale për vertetësinë e tyre dhe mandej të gjykohet për rikthimin në punime.

Është konsideruar si një objekt parësor të një studimi kompleks gjeologo-inxhinierik e të fizibilitetit ekonomik, vlerësimi i mundësive të rritjes së nxjerrjes së gazit nga kapelet gazore, në mënyrë që të disponohen vlera dhe afate kohore për t'i patur parasysh në planin e zhvillimit perspektiv në variantet alternative që do të paraqiten.

Për një gjykim e vlerësim më të drejtë të mundësive të rritjes së prodhimit të gazit nga bilanci ekzistues (i mbetur) i rezervave, do të ishte me interes të trajtoheshin me vete:


- Rezervat e gazit në vendburimet e gazit natyror;
- Rezervat e gazit në kapelet gazore të vendburimeve të naftës (suita Marinza, vendburimi i Ballshit, vendburimi i Finiq-Kranëse);
- Rezervat e gazit të vendburimeve të gazokondensatit (Cakran, Delvinë, suita Bubullima);
- Rezervat e gazit shoqërues të naftës të vendburimeve ranore e gëlqerore.

#### *3.4.4. Parashikimi i nevojave për hidrokarbure dhe produkteve të tyre sipas skenarit pasiv*


Prodhimi i naftës në skenarin pasiv bazohet në situatën aktuale të prodhimit të naftës dhe të produkteve të saj në vendburimet ekzistuese të naftës dhe të gazit. Në këto kushte objektivi kryesor për periudhën deri në vitin 2020 do të jetë ecuria e nxjerrjes së naftës dhe gazit si dhe zhvillimi i mëtejshëm i vendburimeve ekzistuese të naftës për të siguruar nivel të lartë e të qëndrueshëm të prodhimit. Tregu i nënprodukteve të naftës deri në vitin 1992, për shkak të mungesës së sektorit privat, ishte i konceptuar vetëm për konsumatorin industrial dhe atë të prodhimit të energjisë elektrike. Pas vitit 1992 si pasojë e ndryshimeve, kërkesa për nënprodukte naftë pësoi ndryshime drastike, ku sektorët industrialë dhe ai i prodhimit të energjisë elektrike ishin humbës të mëdhej duke marrë një rritje të menjëhershme kërkesa e sektorit privat, që përbehet nga sektorët e transportit, bujqësisë dhe shërbimeve. Në këto kushte, bilanci i tregut të nënprodukteve ndryshoi në drejtim të nënprodukteve të rënda përkundrejt atyre të lehta. Në skenarin pasiv industria e naftës dhe e gazit do të vazhdojë të ketë të njëjtën gjendje, duke ruajtur ecurinë aktuale. Prodhimi i naftës do të ketë ecuri bazuar në treguesit e paraqitur nga kompania e naftës dhe e gazit Albpetrol përfshirë edhe marrëveshjen

hidrokarbure me një maksimum prodhimi, që sipas vlerësimeve aktuale nuk do të arrijë më shumë se 0.6 milion ton në vit.

Në ndërtimin e skenarëve, informacioni i tregut të nënprodukteve të naftës për vitet 1999-2020 është bazuar në bilancet energjitike të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Energjisë, ku janë paraqitur jo pak probleme në lidhje me kërkesën e tregut të karburantëve. Sidoqoftë keto të dhëna kanë qenë objekt i një pune të kujdesshme dhe të përqendruar, kryesisht në: furnizimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj dhe vlerësimin e konsumit të nënprodukteve të naftës sipas llojeve të nënprodukteve në secilin sektor. Vlerësimet paraqesin që nënproduktet e naftës kanë një rritje progresive me një mesatare rreth 7-9 % në vit, ku konsumi aktual sot paraqitet rreth 1320 ktoe. Duhet thenë se konsumi për banor i nënprodukteve të naftës paraqitet relativisht i ulët, po të krahasohet me normat e vendeve analoge evropiane ai rezulton gati 5 herë më i ulët se i vendeve të zhvilluara evropiane dhe 2.5 herë më i ulët se i vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore. Në figurën 5 dhe 6 tregohet ecuria e kërkesës të nënprodukteve të naftës si dhe raporti i tyre me produktet e tjera energjetike për periudhën 1999-2020.




**Figura 5. Ecuria e Kërkeses për produktet hidrokarbure (ktoe)**




**Figura 6. Raporti i hidrokarbureve me lëndet e tjera energjitike (%)**

Kërkesa për produkte është parashikuar të shkojë për vitin 2020 në 2597 ktoe, ku peshën kryesore për këto produkte do ta ketë dizeli me 40 %, benzina me 12 % dhe GLN me 10 %. Ndërsa raporti i produkteve të naftës me lëndët e tjera energjitike do të ketë një ecuri 58 % me 42 %. Parashikimi i nevojave për nënprodukte naftë në sektorët e industrisë, shërbimeve dhe bujqësisë është bërë duke patur parasysh të njëjtët faktorë udhëzues, të cilët u përshkruan gjerësisht gjatë analizës së parashikimit të nevojave për secilin sektor. Sektori dominues për produkte naftë do të jetë sektori i transportit me 45 %, industria me 21 % dhe më pas bujqësia me 15 %. Figurat 7 dhe 8 japin parashikimin e kërkesës së produkteve të naftës sipas sektoreve si dhe kontributin e tyre në raport me njëra -tjetrën. Sektori i transportit është një nga sektorët me një rritje shumë të shpejtë të konsumit të lëndëve energjitike dhe kryesisht të gazoilit (dizelit) dhe të benzinës. Po të krahasojmë këtë nivel të sotëm me vendet e zhvilluara të Evropës Perëndimore vendi ynë është mjaft larg në zhvillimin e këtij sektori. Niveli i ulët i transportit në vend, krahasuar me vendet Europiane, është i lidhur me zhvillimin e ulët ekonomik të vendit. Greqia, që paraqitet në nivel më të ulët se vendet e tjera Europiane, e ka nivelin 6 here më të lartë se vendi ynë, kurse Italia gati 11 herë. Sidoqoftë ky skenar nuk ka marrë parasysh masat në lidhje me eficiencën e përdorimit të produkteve të naftës. Importi i produkteve të naftës do të ketë peshën kryesore, ku raportet e tij me prodhimin vendas do të shkojnë nga 63 % me 37 % për vitin 2003 në 87 % me 13 % për vitin 2020, kjo do të thotë një fluks i fuqishëm i parave për produktet e naftës. Skenari aktiv në analizen e tij me masat që do të parashikojë ka për qëllim një minimizim të këtij fluksi. Skenari pasiv nuk parashikon zhvillim të veçantë për sektorin e rafinerive, ai bazohet në gjendjen aktuale duke ruajtur të njëjtat karakteristika.



**Figura 7. Parashikimi i kërkeses së nënprodukteve të naftës sipas sektorëve (ktoe)**



**Figura 8. Ecuria e raporteve sipas sektorëve (ktoe)**

#### 3.4.5. Parashikimi i prodhimit të naftës deri në vitin 2020

Llogaritjet e ecurisë së prodhimit të naftës në këtë strategji mbështeten në vendburimet ekzistuese të cilat aktualisht kanë një përmirësim të mirë të prodhimit si rezultat i shfrytëzimit të naftës së rende e viskoze me teknologji bashkohore të avancuar. SKE analizon skenarët e parashikimit për besueshmerinë e prodhimit të naftës. Skenari me propabilitet 50% dhe ai me propabilitet 90%. Ecuria e prodhimit të naftës është mbështetur në vendburimet ekzistuese ku operon kompania Albpetrol si dhe Projektit të Zhvillimit të Marrëveshjes Hidrokarbure në zonën Patos-Marinzes. Në skenarin aktiv, janë studiuar tre variante, për përcaktimin e ecurisë së prodhimit të naftës nga vendburimet ekzistuese, duke marrë në konsideratë dhe planin e zhvillimit që kompanitë e huaja kanë në veprim në vendburimin ranor Patos Marinze si dhe planin e kompanisë Albpetrol i cili bazohet në informacionin e kompanisë Albpetrol, si dhe në ecurmë në vite të vendburimeve tona. Nga studimet e bëra janë paraqitur tre variantet e ecurisë së prodhimit për vitet 1999-2020, të cilat janë mbështetur në analiza të ecurisë

normale, mbi normale dhe maksimale të prodhimit bazuar në teknologjitë e shfrytëzimit të vendburimeve ranore.

Në programin e përgatitur të Projektit të Zhvillimit të Marrveshjes Hidrokarbure në zonën Patos- Marinza e të miratuar, për pe riudhen deri në vitin 2025, parashikohen dy skenare besueshmerie për prodhimin e naftës, ai me propabilitet 50 % dhe skenari me propabilitet 90 %, të paraqitur në variantin 2 dhe 3, Ndërsa varianti 1 është vlerësuar nisur nga ecuria aktuale e prodhimit në zonën e Patos Marinzes si variant baze i cili merr parasysh një prirje normale të shfrytëzimit të vendburimit. Në tabelen e me poshtme jepen të dhenat e ketyre varianteve:

**Tabela 14. Parashikimi i prodhimit të naftës nga shoqeria ALBPETROL dhe MH**

| Viti | Prodhimi<br>Albpetrol sh.a<br>(Ktoe) | Prodhimi i naftës nga<br>MH (Ktoe) |     |     | Total (Ktoe) |     |      |
|------|--------------------------------------|------------------------------------|-----|-----|--------------|-----|------|
|      | A                                    | V1                                 | V2  | V3  | V1           | V2  | V3   |
| 2007 | 277                                  | 314                                | 403 | 480 | 591          | 680 | 757  |
| 2010 | 185                                  | 375                                | 574 | 887 | 560          | 759 | 1072 |
| 2015 | 157                                  | 331                                | 413 | 923 | 488          | 570 | 1080 |
| 2020 | 149                                  | 195                                | 254 | 714 | 344          | 403 | 863  |

**Varianti 3 optimist**, parashikon rezultate të suksesshme të teknologjise se nxjerrjes intensive të fluidit nga vendburimi ranor Patos-Marinz me grupe pusesh të përqendruar, që po përdorin kompanitë e huaja. Po ti referohemi grafikut, rezultatet e ketij varianti pritet të arrije 757 Ktoe në vit për vitin 2007. Me pas parashikohet një rritje e prodhimit të naftës deri në vitin 2010 me 1072 Ktoe duke ruajtur një normalitet deri në vitin 2015 me 1080 Ktoe dhe me pas fillon zbritja e prodhimit për të arritur në vitin 2020 në 863 Ktoe.



**Varianti 2 mbi normal,** parashikon rezultatet e prodhimit duke respektuar Planin e Marreveshjes Hidrokarbure e cila parashikon prodhimin në vitin 2007 në 680 Ktoe në vit, me një maksimum në vitin 2010 në 759 Ktoe dhe me pas vendburimi kontribuon me rënie natyrale 5 %, duke arritur prodhimin në vitin 2015 në 570 Ktoe dhe në 2020 në 403 Ktoe.

**Varianti 1 me ecuri normale,** rekomandohet nga Strategjia Kombetare e Energjise, parashikon një ecuri të prodhimit të naftës si të dy variantet deri në vitin 2006, me pas rritja e prodhimit nuk do të jetë me shumë se 600 Ktoe në vit deri në vitin 2010, për të arritur në 488 Ktoe në vitin 2015 dhe 344 Ktoe në vitin 2020. Në analizen e skenarit aktiv, kjo alternative do të merret në konsideratë, pasi ruan një ecuri normale të shfrytëzimit të vendburimit. Prodhimi i Albpetrolit është marrë i njëjtë në të tre variantet.

## **KAPITULLI IV:**

### **METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

#### **4.1. Metodologjia e hulumtimit**

Me synim për të njohur nga së afërmi funksionimin, organizimin dhe konsideratat publike ndaj Aspekteve të vlerësimit, privatizimit dhe menaxhimit të shitjes së pasurisë publike në sektorin e hidrokarbureve në Shqipëri, kam bërë edhe një hulumtim. Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave në terren është mbështetur në **zhvillimin e intervistave** me disa subjekte: qytetarë si blerës apo konsumator, me drejtues & menaxherë të ndërmarrjeve që merren me hidrokarburet. Kriteri i përzgjedhjes të të intervistuarëve në cilësinë si blerës apo si konsumatore ka qenë që ato të jenë me arsim të mesëm dhe të lartë.

Pas analizimit të të dhënave sekondare; pra materialeve editoriale ka filluar procesi i hulumtimit, ku fillimisht është identifikuar gjendja nga terreni përmes matjes së variablave, kjo përmes realizimit të intervistave të cilat kanë synuar vërtetimin e hipotezave.

Gjatë punimit është përdorur **metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave**, gjerësisht është **përdorur pyetësi** për mbledhjen e të dhënave. Kjo na ka ndihmuar që më lehtë të bëjmë krahasimin e variablave të ndryshme të përdorura për të

testuar hipotezat e parashtruara. Metodë tjetër e përdorur në këtë punim është **metoda përshkruese**,përmes së cilës janë përshkruar strategjitë e marketingut nga autorë të ndryshëm, të përmendur në pjesën e rishikimit të literaturës dhe njëkohësisht është përshkruar edhe strategjia që zbatohet nga ndërmarrjet prodhuese te sektorit te hidrokarbureve në Shqipëri.

**Ky punim synon që të jap përgjigje në disa pyetje kërkimore** të cilat lidhen me Aspekte të vlerësimit, privatizimit dhe menaxhimit të shitjes së pasurisë publike nësektorinehidrokarbureve në Shqipëri.

Për të realizuar këtë punim është bërë **rishikimi i literaturës së autorëve të ndryshëm ndërkombëtare dhe atyre shqiptarë** lidhur me Aspekte të vlerësimit, privatizimit dhe menaxhimit të shitjes së pasurisë publike në sektorin e hidrokarbureve në Shqipëri dhe në bazë të tyre është punuar në analizën e strategjive që zbatohen sot në Shqipëri nga ndërmarrjet që janë pjesë e këtij studimi. Rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe formulimit të mirë të strategjisë, meqenëse “Nxitja e shitjes e formuluar mirë si strategji, pa marrë parasysh llojin, është një strategji e cila kërkon të ndërtojë një kompetencë dalluese në disa aktivitete kyçe dhe pastaj duke shfytëzuar të njëjtën, të krijojë një përparësi konkurruese në treg përballe ndërmarrjeve tjera” (Ritson N. 2008). Kjo më së miri tregon se sa është e rëndësishme të formulohet një strategji e mirë e më pastaj të punohen planet e hollësishme për zbatimin sa më të mirë dhe më të lehtë të saj në praktikë.

**Metodologjia** praktikisht na ka ndihmuar që më lehtë të bëjmë krahasimin e variablave të ndryshme për të testuar hipotezat e parashtruara.

### **Zgjedhja e kampionit;**

Metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave përmban në vete analizën e të dhënave primare të mbledhura përmes pyetësorëve. “Madhësia e kampionit prej së paku 30 e më së shumti 500 konsiderohet e përshtatshme për të kryer shumicën e hulumtimeve.” (Sekaran U.2003).

Sipas Field (2005) ekzistojnë shumë rregulla për sa i përket vëllimit të zgjedhjes së kampionit, por si rregull i përgjithshëm duhen 10-15 përgjigje për variabël. Duke tentuar shtrirjen dhe gjithëpërfshirjen pjesëmarrësit në këtë pyetësorë janë përzgjedhur sipas një kampioni ku është kërkuar që të jetë sa më gjithëpërfshirës në mënyrë që rezultatët të jenë gjithëpërfshirëse.

Kampioni përfaqësues i popullimit për këtë studim, është 32 ndërmarrje prodhuese në sektorin hidrokarbureve në Shqipëri .

Për mbledhjen e të dhënave, janë shpërndarë pyetësorët në ndërmarrjet e ndryshme prodhuese në tërë Shqipërinë dhe për të njohur kompleksitetin e çështjes, unë kam ndërtuar disa pyetësorë:

- Pyetësori për performancën e ndërmarrjeve nga sektori i hidrokarbureve, 32 pjesëmarrës
- Pyetësori për blerës & konsumatorë, 380 pjesëmarrës

**Pas aplikimit të pyetësorëve**, dhe përshkrimit të popullatës sipas pikëpamjes statistikore, të dhënat janë përpunuar në **programin SPSS** për të nxjerre, korrelacionet, devijimin standard dhe mesataren për secilin pyetësor. Më pas, të dhënat përshkruese të pyetjeve mblidhen dhe shohim se si korrelojnë me njëra-tjetrën. Më tej këto të dhëna shërbyen për t'i ndërtuar grafikët dhe tabela të nevojshme për vizualizimin e rezultateve, se si korrelojnë të dhënat e pyetjeve me njëra - tjetrën.

Pasi është identifikuar terreni më i përshtatshëm për sjelljen e pyetësorëve, nga qytetarët është kërkuar që të përgjigjen me sinqeritet në pyetësor i cili është anonim.

Afati kohore për plotësimin e pyetësorit ka qenë i paraparë 25 minuta.

Intervista ishte e planifikuar të zgjaste rreth 35-40 minuta ku janë marrë në shënim të dhënat dhe bisedat.

Duke njohur natyrën vendore, anketat janë zhvilluar me mundësi anonimiteti, kjo për arsye edhe të supozimit të marrjes të sa më shumë përgjigjeve të sakta.

Intervistat janë realizuar me persona eminent ku njihet arsimi, profesioni i tyre dhe eksperiencia, përpos të dhënave bazike si mosha, gjinia, vendbanimi etj., ku në punim do të paraqiten si intervista I, II, kjo për të ruajtur privatësinë.

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar përmes EXCEL (mënyra e parë) dhe mënyra e dytë - katërt, tabelat e kryqëzuara, përmes paketës statistikore për shkenca shoqërore SPSS (Statistical Package for the Social Sciences).

## KAPITULLI V

### REZULTATE DHE DISKUTIME

#### 5.1. Pjesa e përgjithshme

Tashmë për interes të kuptimit më të qëndrueshëm të materies kam nxjerrë disa të dhëna nga burimet zyrtare; të cilat janë:

**Tabela 15. Privatizimi përmes shitjes direkte si dhe ankande /tendera e shprehur në milion lekë**

| Viti           | Nr objekteve | Lekë     | Lekë nga privatizimi | Bono të privatizimit | Vlera totale |
|----------------|--------------|----------|----------------------|----------------------|--------------|
| 1991-1992      |              | 537.9    |                      |                      | 537.9        |
| 1993           | 3, 268       | 4, 477.0 |                      |                      | 4, 477.0     |
| 1994           | 2, 775       | 1, 838.0 | 344.1                |                      | 2, 182.1     |
| 1995           | 2, 924       | 597.2    | 2, 704.3             | 828.0                | 4, 129.5     |
| 1996           | 2, 248       | 314.5    | 784.1                | 2, 407.3             | 3, 505.9     |
| 1997           | 717          | 185.1    | 69.6                 | 747.8                | 1, 002.5     |
| 1998*          |              | 258.8    | 13.2                 | 358.8                | 630.8        |
| 1999           |              | 1, 027.4 |                      |                      | 1, 027.4     |
| 2000           |              | 2, 168.4 |                      |                      | 2, 168.4     |
| 2001(9 mujori) |              | 844.4    |                      |                      | 844.4        |

*Burimi: Ministria e Ekonomisë*

\* Për privatizimet vitet 1998-2001 me shitje me ankand vetëm me lekë, dhe në strukturën e shitjeve përfshihen objekte, makineri, kuota dhe paketa shtetërore. Për periudhën 1998-2001 vlerësohen të shitura 179 objekte tërësore dhe 183 objekte pjesore. Privatizimi me Tender të Hapur është përdorur për 3 shoqëri dhe 1 ndërmarrje shtetërore.

**Tabela 16. Rezultatet e arritura përmes Programi i Privatizimit Masiv e shprehur në milionë lekë**

| Viti      | Nr. objekteve | Lekë | Lekë privatizimi | Bono privatizimi | Vlera gjithsej |
|-----------|---------------|------|------------------|------------------|----------------|
| 1991-1992 |               |      |                  |                  |                |
| 1993      |               |      |                  |                  |                |
| 1994      |               |      |                  |                  |                |
| 1995      | 50            | -    | 450.0            | 1, 703.0         | 2, 153.0       |
| 1996      | 47            | -    | 311.7            | 2, 873.2         | 3, 184.9       |

Burimi: Agjencia Kombëtare e Privatizimit

Për t'i dhënë një vlerësim me shifra efektivitetit të privatizimit deri 1997, mund ta shprehim nëpërmjet treguesit të GDP sipas viteve, në raport me GDP e vitit 1990:

**Tabela 17. Rritja e GDP sipas viteve**

| Viti | Rritja e GDP (në %) |
|------|---------------------|
| 1992 | 66, 8               |
| 1993 | 73, 2               |
| 1994 | 79, 3               |
| 1995 | 89, 8               |
| 1996 | 98, 0               |
| 1997 | 91, 1               |

Burimi: Ministria e Financave

**Tabela 18. Përmbledhje Për Pese Paketat**

| PAKETAT            | PERIUDHA E PUBLIKIMIT | VLERA E ANKANDIT NË 000/ LEKË | KAPITALI I SHITUR NË 000 / LEKË | VL.ANK/ KAP.SHITUR NË % |
|--------------------|-----------------------|-------------------------------|---------------------------------|-------------------------|
| Paketa I           | 1995                  | 738805                        |                                 |                         |
| Paketa II          | 1995                  | 1413909                       |                                 |                         |
| Pak.I I I + Pak IV | 1996                  | 1923714                       |                                 |                         |
| Paketa V           | 1996                  | 1218552                       |                                 |                         |
| Paketa VI          | 1997                  | 2652374                       |                                 |                         |
| Totali             |                       | 7947354                       |                                 |                         |

Burimi: Ministria e Financave

**Tabela 19. Rritja e GDP**

| Viti | Rritja e GDP (në %) |
|------|---------------------|
| 1998 | 122, 8              |
| 1999 | 134, 9              |
| 2000 | 143, 0              |

Burimi: Ministria e Financave

**Tabela 20. Numri i aseteve apo objekteve sipas formave të shitjes**

|                                            | Forma e shitjes                                                               | Vlera e shitjes (në 000/lekë) |
|--------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|
| 123 objekte apo makineri                   | Shitje me ankand                                                              | 116 498                       |
| 14 objekte apo makineri                    | Shitje me reserve                                                             | 40 880                        |
| 47 objekte apo makineri                    | Shitje me ankand pa vlerë fillestare                                          | 8 633                         |
| 204 objekte (sip. 306 890 m <sup>2</sup> ) | Truall objektesh                                                              | 181 014                       |
| 10 objekte                                 | Shitje me ankand dhe tender të paketeve shtetërore anonime dhe të përbashkëta | 589 695                       |
| Objekte dhe makineri                       | Totali                                                                        | 936 730                       |

Burimi: Agjencia Kombëtare Shqiptare e Privatizimit dhe Ministria e Ekonomisë

Në këtë pjesë do trajtohet në përgjithësi analiza e pyetësorëve sipas pyetjeve përkatëse që ato përmbajnë.

Përmes pyetësorit unë kam analizuar rezultatet e përgjithshme sa i takon materies në fjalë dhe për qëllime analizimi, të gjithë respondentët do t'i ndërthuri në disa nga pyetjet bazike:


Pjesmarrës në pyetësorë ishin 378 qytetarë të cilët ishin të gjinisë mashkullore 45.7% dhe 54.3% femra, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga pesë qendrat kryesore të Shqipërisë ku Tirana prin me 35% të respondentëve e pasuar nga



Durrësi me 13.7% pastaj nga Vlora ku pjesëmarrës ishin 27% si dhe nga Elbasani kishte 24.3%.

Drejtuar qytetarëve ishin edhe 6 pyetje tematike të cilat ndërlidhen drejtpërsëdrejti me përshtypjet e tyre përkitazi me privatizimin dhe vlerësimin e pronës publike në Shqipëri.

**Tabela 21. Ju si qytetar, a jeni të kënaqur me institucionet e privatizimit/ vlerësimit të ndërmarrjeve publike?**



*Burimi: Pyetësor për qytetarë*


**Tabela 22. Tests of Between-Subjects Effects Dependent Variable: Sa rëndësi ka për ty si qytetar promovimi i aktiviteteve të privatizimit/ vlerësimit të ndërmarrjeve publike në luftimin e informalitetit dhe zhvillimin ekonomik të vendit?**

| Source     | Type III Sum of Squares | df | Mean Square | F | Sig. |
|------------|-------------------------|----|-------------|---|------|
| Intercept  |                         |    |             |   |      |
| Hypothesis | ,000                    | 0  | .           | . | .    |
| Error      | .                       | .  | .a          |   |      |
| o6         |                         |    |             |   |      |
| Hypothesis | ,000                    | 0  | .           | . | .    |
| Error      | .                       | .  | .a          |   |      |
| o5         |                         |    |             |   |      |
| Hypothesis | 136,491                 | 2  | .           | . | .    |
| Error      | .                       | .  | .a          |   |      |
| o5 * o3    |                         |    |             |   |      |
| Hypothesis | ,000                    | 0  | .           | . | .    |
| Error      | .                       | .  | .a          |   |      |

a. nuk ka llogatije si rezultat i mungesës së metodës Sattertheaite's.

*Burimi: Pyetësori me qytetarë*

**Tabela 23. Normal P-P Plot e Nga sasia e përgjithshme të aktiviteteve privatizuese, ç'përqindje zë grupi i aktiviteteve me nevojë bashkëpunimin ndërkombëtar në funksion të zhvillimit ekonomik?**



*Burimi: Pyetësi me qytetarë*

**Tabela 24. Crosstabulation i kërkesave na jep shumë të qartë ndërlidhjen ndërmjet këtyre kërkesave: Privatizimi / vlerësimi i ndërmarrjeve publike që ti i shikon si aktivitete a kanë ndonjë ndërlidhje me aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar? \* Sa rëndësi ka për ty si qytetar promovimi i aktiviteteve të Privatizimit / vlerësimi i ndërmarrjeve publike në zhvillimin ekonomik të vendit? \* Në sasinë e përgjithshme të aktiviteteve privatizuese, ç'përqindje zë grupi i aktiviteteve me nevojë bashkëpunimin ndërkombëtar në funksion të zhvillimit ekonomik?**

| Në sasië e përgjithshme të aktiviteteve privatizuese, ç'përqindje zë grupi i aktiviteteve me nevojë bashkëpunimin ndërkombëtar në funksion të zhvillimit ekonomik? |                                                                                                                                                   | Sa rëndësi ka për ty si qytetar promovimi i aktiviteteve të Privatizimi / vlerësimi i ndërmarrjeve publike në zhvillimin ekonomik të vendit? |                               |                         | Total |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------|-------|
|                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                   | është gjëja më e rëndësishme                                                                                                                 | është gjë shumë e rëndësishme | është gjë e rëndësishme |       |
| midis 16%-30%                                                                                                                                                      | Privatizimi / vlerësimi i ndërmarrjeve publike që ti i shikon si aktivitete a kanë ndonjë ndërlidhje me aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar? | Po                                                                                                                                           | 42                            | 205                     | 247   |
|                                                                                                                                                                    | Total                                                                                                                                             | 42                                                                                                                                           | 205                           |                         | 247   |
| midis 31%-50%                                                                                                                                                      | Privatizimi / vlerësimi i ndërmarrjeve publike që ti i shikon si aktivitete a kanë ndonjë ndërlidhje me aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar? | Po                                                                                                                                           |                               | 3                       | 68    |
|                                                                                                                                                                    | Total                                                                                                                                             |                                                                                                                                              | 3                             | 68                      | 71    |
| më shumë se 50%                                                                                                                                                    | Privatizimi / vlerësimi i ndërmarrjeve publike që ti i shikon si aktivitete a kanë ndonjë ndërlidhje me aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar? | Po                                                                                                                                           | 69                            |                         | 69    |
|                                                                                                                                                                    | Total                                                                                                                                             | 69                                                                                                                                           |                               |                         | 69    |
| Total                                                                                                                                                              | Privatizimi / vlerësimi i ndërmarrjeve publike që ti i shikon si aktivitete a kanë ndonjë ndërlidhje me aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar? | Po                                                                                                                                           | 111                           | 208                     | 68    |
|                                                                                                                                                                    | Total                                                                                                                                             | 111                                                                                                                                          | 208                           | 68                      | 387   |

*Burimi: Pyetësi me qytetarë*

|                                                                                                                                                   |       | Value Label     | N   |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|-----------------|-----|
| Në sasinë e përgjithshme të aktiviteteve                                                                                                          | 2, 00 | midis 16%-30%   | 247 |
| privatizuese, ç'përqindje zë grupi i aktiviteteve                                                                                                 | 3, 00 | midis 31%-50%   | 71  |
| me nevojë bashkëpunimin ndërkombëtar në funksion të zhvillimit ekonomik                                                                           | 4, 00 | më shumë se 50% | 69  |
| Privatizimi / vlerësimi i ndërmarrjeve publike që ti i shikon si aktivitete a kanë ndonjë ndërlidhje me aktivitete të bashkëpunimit ndërkombëtar? | 1, 00 | Po              | 378 |

*Burimi: Pyetësi me qytetarë*

Në vitin 2013, nafta bruto e prodhuar përbënte 98% të kërkesës së brendshme për konsum matur në naftë bruto. Në vitin 2014, ky raport u rrit në 108%, duke tejkaluar më 8% kërkesën e brendshme për konsum matur në naftë bruto. Bazuar në këto të dhëna, mund të supozohet se në qoftë se prodhimi vendas i naftës bruto do të përpunohej në Shqipëri, prodhimi vendas do të ishte shumë pranë përmbushjes së kërkesës së brendshme për konsum.

Nafta e prodhuar në vend kryesisht është eksportuar për t'u rafinuar jashtë vendit. Konsumi i brendshëm për nënproduktet e naftës përmbushet përmes importit. Bazuar në të dhënat e raportuara nga Administrata Doganore Shqiptare, eksportet e naftës bruto ishin rreth 104% të naftës së prodhuar në vitin 2013. Ky raport ra në 77% të naftës së prodhuar në vitin 2014, kur nafta bruto e përpunuar përmes rafinerive vendase arriti në 22%.

